



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 675 Akti

Nr. 785 Vendimi
Tiranë, më 18.7.2024

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Genta Tafa (Bungo)	Kryesuese
Etleda Çiftja	Relatore
Roland Ilia	Anëtar

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Resilda Bilaj, në prezencë edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, në datën 17.7.2024, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mbylli seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Irena Çunoti**, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë** dhe nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT

pasi dëgjoji arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisioneren Etleda Çiftja, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, dëgjoji subjektin e rivlerësimit Irena Çunoti, pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, e cila në seancën dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT PROCEDURALE

1. Znj. Irena Çunoti është subjekt rivlerësimi për shkak të funksionit si prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016).
2. Znj. Irena Çunoti, bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016, i është nënshtuar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar në datën 15.12.2020 me trupin gjykues të përbërë nga komisionerët Genta Tafa (Bungo), Suela Zhegu dhe Roland Ilia.
3. Trupi gjykues i shortuar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni), me vendimin e datës 15.1.2021, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi të caktojë kryesuese të trupit gjykues komisioneren Genta Tafa (Bungo), të gjithë anëtarët të deklarojnë mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit, si dhe të fillojë hetimi administrativ i thellë dhe i gjithanshëm, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit.
4. Menjëherë pas hedhjes së shortit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016; Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK), ish-DSIK, sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016; Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP), sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016.
5. Në datën 27.1.2021, përmes postës elektronike¹, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit për fillimin e procesit të rivlerësimit, mbi përbërjen e trupit gjykues, si dhe i kërkoi të deklaronte nëse gjendej në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues. Gjithashtu, Komisioni i kërkoi subjektit informacion shtesë, sipas pyetësorit standard.
6. Në përgjigje, përmes postës elektronike², subjekti i rivlerësimit paraqiti në Komision dokumentet provuese lidhur me procesin e rivlerësimit dhe nuk ka deklaruar kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.
7. Komisioni, me vendimin e datës 23.6.2023, ka rishortuar çështjet, me qëllim shpërndarjen në mënyrë të barabartë të ngarkesës midis komisionerëve dhe anëtarja Suela Zhegu u zëvendësua me anëtarën tjetër, znj. Etleda Çiftja.
8. Më pas, përmes postës elektronike³, Komisioni njoftoi subjektin për ndryshimin e njërit prej anëtarëve të trupit gjykues për shkak të rishortimit të çështjeve, me qëllim shpërndarjen në mënyrë të barabartë të ngarkesës midis komisionerëve, duke ndryshuar anëtarën Suela Zhegu me anëtarën tjetër, znj. Etleda Çiftja, si dhe i kërkoi të deklaronte nëse gjendej në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarën e re të trupit gjykues.

¹ Email, datë 27.1.2021.

² Email datë 11.2.2021.

³ Email datë 14.9.2023.

9. Në përgjigje, përmes postës elektronike⁴, subjekti i rivlerësimit konfirmoi marrjen e njoftimit për ndryshimin në përbërjen e trupit gjykues, duke bërë me dije se nuk ka asnjë konflikt interesi me anëtarin e trupit gjykues, znj. Etleda Çiftja.

10. Trupi gjykues, me vendimin e datës 3.7.2024, vendosi: (i) të përfundojë hetimin paraprak për subjektin e rivlerësimit Irena Çunoti, bazuar në relatimin mbi rezultatet e hetimit të paraqitur nga relatorja e çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht, sipas ligjit nr. 84/2016 dhe të drejtën për të paraqitur prova/shpjegime me shkrim në lidhje me rezultatet e hetimit; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 45 - 47 e 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si dhe me afatin brenda të cilit mund t'i ushtrojë këto të drejta.

11. Në datën 3.7.2024, përmes postës elektronike⁵, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe të sjellë prova për të provuar të kundërtën; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 45 - 47 e 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative. Në këtë njoftim, subjektit të rivlerësimit iu kërkua të paraqiste edhe shpjegime brenda datës 30.11.2023.

12. Në datën 15.7.2024, subjekti i rivlerësimit, përmes postës elektronike⁶, paraqiti shpjegimet me shkrim në lidhje me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe dokumentacionin provues.

13. Më tej, Komisioni, me anë të postës elektronike⁷, njoftoi subjektin e rivlerësimit se trupi gjykues vendosi ta ftojë për t'u dëgjuar në seancë dëgjimore lidhur me rezultatet e hetimit për vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, në datën 17.7.2024, ora 10:00, bazuar në nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", si dhe në Kodin e Procedurave Administrative.

14. Bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Irena Çunoti, bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës; vlerësimi i aftësive profesionale.

II. SEANCA DËGJIMORE

15. Në datën 17.7.2024 u zhvillua seanca dëgjimore në prezencë të subjektit të rivlerësimit, si dhe vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht në seancë.

16. Relatorja e çështjes paraqiti rezultatet e arritura nga Komisioni përgjatë fazës së hetimit administrativ, të kryer mbi të tria kriteret e rivlerësimit dhe të kaluara si barrë prove apo për shpjegime.

⁴ Email datë 14.9.2023.

⁵ Email datë 3.7.2024, "Komisioni – Njoftim mbi përfundimin e hetimit kryesisht lidhur me procesin tuaj të rivlerësimit".

⁶ Email datë 15.7.2024.

⁷ Email datë 15.7.2024, "Komisioni-Ftesë për t'u dëgjuar lidhur me procesin tuaj të rivlerësimit".

17. Znj. Irena Çunoti, pasi dëgjoji relacionin, shprehu qëndrimin e saj, duke parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me gjetjet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj.

18. Në përfundim të seancës dëgjimore të datës 17.7.2023, subjekti i rivlerësimit Irena Çunoti kërkoi konfirmimin në detyrë.

19. Seanca dëgjimore e datës 17.7.2024 u ndërpre, për të rifilluar në datën 18.7.2024 për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

20. Subjekti i rivlerësimit Irena Çunoti ka qenë bashkëpunuese gjatë gjithë procesit, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

21. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016.

22. Sipas krerëve IV, V dhe VI të ligjit nr. 84/2016: (i) ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror; (ii) AKSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit; (iii) KLP-ja është organi ndihmës për vlerësimin profesional, i cili në përfundim të shqyrtimit të dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të pesë dokumenteve të përzgjedhura sipas një sistem objektiv dhe rastësor, përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar.

23. Referuar vendimit nr. 2/2017⁸ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. RIVLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

24. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Irena Çunoti, i cili është bërë subjekt deklarues në këtë institucion në vitin 2003

⁸ Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5 të nenit 179/b të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

25. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratat e interesave privatë për periudhën 2003 – 2016 dhe në datën 26.1.2017, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting* 2017. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, është konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

26. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting* 2017; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratat vjetore të deklarimit të pasurisë në ILDKPKI për vitet 2003 – 2016; (ç) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (d) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (dh) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit e, në vijim, shpjegimet në seancë dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

27. Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

Pasuritë dhe likuiditetet e deklaruar në deklaratën e pasurisë *Vetting* të vitit 2017 nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur

1. Shtëpi banimi 2 kat + bodrum me vlerë 12.600.000 lekë, në Korçë

1.1 Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Një shtëpi banimi ndodhur në Lagjen Nr. ***, rruga “***” nr. ***, Korçë, në bashkëpronësi me mamanë time A. Q.. Ndërtimi i kësaj shtëpie ka filluar në vitin 2007 sipas lejes së ndërtimit nr. ***, datë 24.8.2007. Vlera e kësaj shtëpie sipas preventivit përfundimtar të punimeve është 8.251.800 lekë. Trualli gjithsej kap një sipërfaqe prej 272 m², ndërsa ndërtimi kap sipërfaqen 121 m² të këtij trualli, e ndarë respektivisht në bodrumet 100 m² në katin e parë 120 m² dhe në katin e dytë 80 m². E shtrirë ndër vite deri në momentin e deklarimit, janë kryer dhe punime të tjera*

shtesë, plus arredimit të shtëpisë, në një vlerë të përgjithshme 12.600.000 lekë”. Si burim krijimi deklaroi çeljen e trashëgimisë së babait të saj S. Q., i cili ka ndërruar jetë në datën 25.4.2007⁹, të ardhurat e krijuara ndër vite nga puna e saj dhe e bashkëshortit, depozitën e babait fituar nga dëshmia e trashëgimisë në vlerën 38.128 USD, si dhe kredinë e marrë në vlerën 30.000 euro nga NBG Bank. Për vërtetimin e deklarimeve, ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues¹⁰.

1.2 ASHK Korçë¹¹ informon se në emër të subjektit dhe nënës së saj figuron e regjistruar në bashkëpronësi pasuria nr. ***, vol. ***, faqe ***, z. k. ***, e llojit truall me sipërfaqe totale 272 m², nga të cilat 121 m² ndërtesë.

1.3 Rezulton se origjina e regjistrimit të pasurisë nr. ***, z. k. ***, Korçë vjen nga nota e transkriptimit nr. ***, datë 10.9.1954, ku pasqyrohet pjesëtim i 2 pasurive¹² nga kontrata e dhurimit datë 7.4.1980¹³, si dhe nga kontrata e dhurimit nr. ***, datë 21.6.1991¹⁴.

1.4 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. ***, datë 8.5.2007, ka lëshuar dëshminë e trashëgimisë ligjore të të ndjerit S. Q., i cili ka ndërruar jetë në datën 25.4.2007, duke njohur si trashëgimtarë ligjorë të tij bashkëshorten A. Q. dhe vajzën e tij Irena Çunoti (Qelesi), të cilët trashëgojnë 1/2 pjesë të pasurisë së tij.

1.5 Në vijim, konstatohet se ish-KRRT Bashka Korçë me vendimin e datës 24.8.2007 ka miratuar lejen për prishjen e banesës në pronësi të shtetaseve A. Q. dhe Irena Çunoti, si dhe në të njëjtën datë ka miratuar sheshin e ndërtimit, ku në formularin e lejes së sheshit pasqyrohet sipërfaqja ndërtimore 121 m², numri i kateve mbi tokë 2 dhe numri i kateve nën tokë 1. Gjithashtu, po në datën 24.8.2007 është miratuar edhe leja e ndërtimit për objektin “Banesë 2 kat me bodrum”, rruga “****”, me subjekt ndërtues shoqëria “****” sh.p.k., në favor të shtetaseve A. Q. dhe Irena Çunoti.

1.6 Referuar procesverbalit të kolaudimit nr. ***, datë 17.6.2010, projekti është miratuar nga zyra e urbanistikës e Bashkisë Korçë me 3 kate, nga të cilat 1 kat nën tokë, ku sipërfaqja e bodrumit është 121 m², e katit përdhe është 121 m² dhe e katit të parë është 101 m².

1.7 Bazuar në situacionin e punimeve, të hartuar nga shoqëria “****” sh.p.k., si dhe në procesverbalin e kolaudimit nr. ***, datë 27.6.2010¹⁵, vlera totale e punimeve ka qenë 8.251.800 lekë.

⁹ Subjekti ka deklaruar datën 25.4.2006, çka duket lapsus, pasi nga dokumentacioni rezulton se babai i saj ka ndërruar jetë në datën 25.4.2007.

¹⁰ Certifikatë për vërtetim pronësie datë 15.9.2010, e pasurisë nr. ***, z. k. ***, bashkë me kartelën e pasurisë së paluajtshme; leje ndërtimi datë 14.9.2007 për A. Q. e Irena Çunoti; situacion punimesh nga shoqëria “****” sh.p.k., Korçë; vendim nr. ***, datë 8.5.2007, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore; lëvizjet e depozitës (USD) në emër të shtetasit S. Q., pranë Raiffeisen Bank, gjatë periudhës 14.4.2005 – 16.4.2007 dhe tabela përmbledhëse e veprimeve të kryera; vërtetim nr. *** prot., datë 22.2.2016, nga Raiffeisen Bank; mandat tërheqjeje depozite me vendim gjyqi datë 17.4.2008 pranë Raiffeisen Bank nga shtetasja Irena Çunoti në llogarinë e shtetasit S. Q.; kontratë hipoteke nr. ***, datë 18.12.2007; kontratë kredie nr. ***, datë 18.12.2007; deklaratë noteriale nr. ***, datë 29.12.2014, nga NBG Bank.

¹¹ Shkresë nr. *** prot., datë 31.7.2023.

¹² Ku: (i) pasuria arë me sip. 246 m², mbi të cilën është ndërtuar një godinë 2-katëshe, ka kaluar në pronësi të shtetasve P. Q., N. T. Q. dhe S. T. Q.; (ii) pasuria “shtëpi me dy kate” e përbërë nga dy dhoma lart dhe dy poshtë, me oborr, ka kaluar në pronësi të shtetasit S. T. Q..

¹³ Me anë të së cilës shtetasja P. Q. i ka dhuruar 1/3 pjesë të pandarë të shtëpisë me sip. 107 m² djalit të saj, S. Q..

¹⁴ Me anë të së cilës shtetasi N. Q. i ka dhuruar vëllait të tij S. Q. 1/3 pjesë. Për pasojë, shtetasi S. Q. është bërë pronar i vetëm i banesës 2-katëshe.

¹⁵ Administruar edhe nga Bashkia Korçë me shkresën nr. *** prot., datë 21.2.2024.

1.8 Gjithashtu, konstatohet se Bashkia Korçë ka miratuar lejen e shfrytëzimit nr. *** prot., datë 8.9.2010.

1.9 Objekti i mësipërm pasqyrohet i regjistruar në kartelën e pasurisë së paluajtshme me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, fq. ***, me adresë rruga “****”, Korçë, e llojit truall me sip. 272 m², nga të cilat 121 m² ndërtim.

1.10 Lidhur me momentin e fillimit të banimit në këtë banesë, Komisioni konstaton se subjekti e ka deklaruar këtë adresë banimi në DIPP-në e vitit 2010 e në vijim. Po kështu, në pyetësonin standard subjekti ka deklaruar se ka banuar në këtë banesë që prej fundit të vitit 2010 apo fillimi i vitit 2011 e në vijim.

1.11 FSHU-ja¹⁶ informon se me gjeneralitetet Irena S. Çunoti identifikohet 1 abonent me kontratë furnizimi nr. *** në instancën Korçë dhe në printimin e sistemit elektronik pasqyrohet adresa Rruga ***, si dhe shënimi “Emri nga S. Q. në A. datë 4.5.2015...”.

1.12 UK Korçë¹⁷ informon se shtetasi K. P. Ç. është klient pranë kësaj shoqërie me nr. kontrate ***, me adresë Lagjja Nr. ***, rruga “****”, objekti ***, Korçë, duke bashkëlidhur kopje të kartës së identitetit të këtij shtetasi dhe certifikatës së pronësisë së datës 15.9.2010, të pasurisë nr. ***, z. k. ***, Korçë, në pronësi të shtetaseve A. Q. dhe Irena (Qeleshi) Çunoti.

1.13 Komisioni hetoi lidhur me konfliktin e interesit të subjektit me shoqërinë “****” sh.p.k.¹⁸, ortakët dhe administratorët e saj, dhe nuk rezultoi që subjekti të ishte në kushtet e konfliktit të interesit¹⁹.

1.14 Nga analizimi i deklarimeve të subjektit dhe dokumentacionit të administruar, u konstatua se në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar që trualli gjithsej kap një sipërfaqe prej 272 m², ndërtimi kap sipërfaqen 121 m² të këtij trualli, e ndarë respektivisht në bodrumet 100 m², katin e parë 120 m² dhe katin e dytë 80 m², ndërsa sipas procesverbalit të kolaudimit nr. ***, datë 17.6.2010, sipërfaqja e bodrumit është 121 m², sipërfaqja e katit përdhe është 121 m² dhe sipërfaqja e katit të parë është 101 m².

1.15 Sa më lart, si dhe në kushtet ku në kartelën e pasurisë së paluajtshme nuk pasqyrohet sipërfaqja e secilit kat, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit me anë të pyetësonit nr.1²⁰.

1.16 Në përgjigje²¹, subjekti shpjegon se diferenca e evidentuar është rrjedhojë e ndryshimeve të vogla që ka pësuar ndërtimi i banesës në terren në bodrumin e shtëpisë. Konkretisht, vijon subjekti, ndonëse në projekt bodrumi figuron me sipërfaqe 121 m², gjatë ndërtimit në anën perëndimore dhe veriore të banesës sipërfaqja e bodrumit është zvogëluar për shkak të banesave të fqinjëve, të cilat ishin shumë të vjetra dhe mund të rrëzoheshin nga hapja e gropës së bodrumit dhe, për këtë arsye, kanë zvogëluar sipërfaqen e ndërtimit të bodrumit dhe mbi të në katin përdhes kanë dalë *konsol* për të zgjeruar sipërfaqen e këtij kati pa dëmtuar shtëpitë e fqinjëve. Nëse matet sipërfaqja nën *konsol*, pra boshllëku i mbetur, atëherë sipërfaqja e bodrumit është 121 m². Subjekti paraqiti 2 foto për të mbështetur deklaratimet e saj. Gjithashtu, shpjegon se në

¹⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 26.7.2021.

¹⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 21.7.2021.

¹⁸ Ndryshuar emri në “****” sh.p.k.

¹⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 8.3.2024.

²⁰ Email datë 3.5.2024.

²¹ Email datë 13.5.2024.

deklaratën *Vetting* ka deklaruar për katin e parë sipërfaqen e ndërtimit 80 m², e rezultuar nga matjet e bëra vetë, pa marrë parasysh sipërfaqen e ballkoneve dhe trashësinë e mureve.

1.17 Në përfundim, subjekti deklaroi se procesverbali i kolaudimit nr. ***, datë 17.6.2010, pasqyron sipërfaqet e sakta të çdo kati të banesës.

1.18 Nga analizimi i deklaramëve të subjektit – të paraqitura në tabelën vijuese – konstatohet se shuma totale e deklaruar në DIPP-të vjetore (12.622.301 lekë) është pothuajse e barabartë me deklaramin në deklaratën *Vetting* (12.600.000 lekë)²².

Tabela nr. 1 – Deklarimet në DIPP lidhur me ndërtimin dhe mobilimin

Viti	Deklaruar në DIPP	Shuma e shpenzuar për banesën sipas monedhave			Totali në LEK	Ndërtimi / mobilimi
		USD	EUR	LEK		
2007	Gjatë fillimit të ndërtimeve janë harxhuar deri në datën 31.12.2007, 5.000 USD, <i>cash</i> që ishin gjendje (nga viti 2006), si dhe të ardhurat vjetore nga pagat në masën 1.100.000 lekë	\$5,000		1,100,000	1,552,150	Periudha 2007 – 2008 – 2009: - për ndërtimin, Shuma totale 8.876.541 lekë
2008	1) Tërheqje dhe mbyllje e depozitës në Raiffeisen Bank, trashëguar nga vdekja e babait dhe pakësuar komplet kjo shumë, pasi u përdor për ndërtimin e shtëpisë së re të deklaruar më parë, në shumën 36.630 USD. 2) Pakësuar sasia komplet e kredisë së marrë për ndërtimin e shtëpisë së re në shumën 20.000 euro.	\$36,630	20,000 €		5,528,891	
2009	1) Mbyllja e depozitës së bashku me interesin në Raiffeisen Bank në vlerën 36.720 \$ dhe çelja e dy depozitave të tjera, respektivisht në vlerat 5.000 \$ dhe 20.000 \$ në NBB Bank, na la një diferencë prej 11.720 \$ plus 331 \$ interesa. Harxhuar për ndërtimin e shtëpisë së re vlerën prej 5.000 USD. 2) Gjendja <i>cash</i> prej 10.000 euro e kështit të fundit të kredisë e mbetur nga viti 2008 u harxhua për ndërtimin e shtëpisë së re	\$5,000	10,000 €		1,795,500	
2010	Harxhuar për mobilimin e shtëpisë së re në vlerën prej 4.000 USD (të deklaruar si gjendje në fund të vitit 2009)	\$4,000			415,760	Periudha 2010, 2015, 2016: - Për mobilimin dhe punime të tjera, shuma totale 3.745.760 lekë
2015	Shpenzime për arredimin dhe punime të tjera të shtëpisë së re			2,200,000	2,200,000	
2016	Shpenzime të tjera shtesë për shtëpinë e re			1,130,000	1,130,000	
	Total	\$50,630	30,000 €	4,430,000	12,622,301	

1.19 Sa më lart, Komisioni konstaton se subjekti ka deklaruar në DIPP-të e viteve 2007 – 2009 shpenzime për ndërtimin e objektit, në shumën totale 8.876.541 lekë.

²² Diferenca prej 22.301 lekësh mund të vijë si rezultat i kurseve të këmbimit. Konvertimi është kryer sipas kursit mesatar vjetor të këmbimit në vitin në të cilin është deklaruar shpenzimi (konkretisht për vitin 2007: 1 USD = 90,43 lekë; për vitin 2008: 1 USD = 83,89 lekë dhe 1 euro = 122,80 lekë; për vitin 2009: 1 USD = 94,98 lekë dhe 1 euro = 132,06 lekë; për vitin 2010: 1 USD = 103,94 lekë).

1.20 Në procesverbalin e kolaudimit nr. ***, datë 17.6.2010, citohet se deri në datën 17.6.2010 sipërmarrësit i janë likuiduar 8.251.800 lekë.

1.21 Komisioni, me anë të pyetësorit nr. 2²³, i kërkoi subjektit të deklarojë nëse pagesat për sipërmarrësin, pra shoqërinë “****” sh.p.k., janë kryer *cash* apo nëpërmjet sistemit bankar, si dhe të paraqesë dokumentacion ligjor për të provuar pagesat e kryera.

1.22 Në përgjigje²⁴, subjekti deklaroi se: “*Të gjitha pagesat e sipërmarrësit, pra shoqërisë “****” sh.p.k., i janë kryer në cash, në vijim të ndërtimeve të kryera. Dokumentacion ligjor për të provuar këtë fakt nuk disponoj, pasi nuk kemi mbajtur një dokumentacion të tillë*”.

1.23 Në vijim, Komisioni kërkoi informacion pranë shoqërisë “****” sh.p.k. (sot “****” sh.p.k.), e cila nuk iu përgjigj kërkesës së Komisionit. Referuar faqes zyrtare të QKB-së, kjo shoqëri aktualisht është me status “pezulluar”.

1.24 Në kushtet që subjekti deklaroi se nuk disponon dokumentacion për pagesat e kryera, Komisioni, për efekt të analizës financiare, iu referua deklarimeve të kryera në DIPP-të vjetore.

1.25 Komisioni verifikoi të dhënat lidhur me koston mesatare të ndërtimit në qytetin e Korçës për vitet 2007, 2008 dhe 2009, nga ku rezultoi një kosto mesatare prej 26.866 lekë²⁵/m².

1.26 Komisioni kreu përlllogaritjet për të përcaktuar koston e objektit bazuar në çmimet referuese, duke konsideruar sipërfaqet e pasqyruara në procesverbalin e kolaudimit, si edhe duke iu referuar jurisprudencës së Kolegjit, sipas së cilës kostoja e një ndërtimi të tipit garazh orientohet të jetë në masën 50% të çmimit referues²⁶.

1.27 Nga këto përlllogaritje rezultoi një shumë totale prej 7.589.645 lekësh²⁷, pra më e ulët se shuma e deklaruar nga subjekti.

Burimet e krijimit

1.28 Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar si burim: (i) të ardhurat e krijuara ndër vite nga puna e saj dhe e bashkëshortit; (ii) depozitën e babait/S. Q., fituar nga dëshmia e trashëgimisë në vlerën 38.128 USD, (iii) kredinë e marrë në vlerën 30.000 euro nga NBG Bank.

i) Të ardhurat e krijuara ndër vite nga puna e saj dhe e bashkëshortit

1.29 Në deklaratën *Vetting*, subjekti paraqiti dokumentacion për: (i) të ardhurat nga punësimi i saj²⁸ dhe i bashkëshortit²⁹; (ii) të ardhurat e bashkëshortit nga aktiviteti tregtar; (iii) të ardhurat e bashkëshortit si ekspert mekanik³⁰.

²³ Email datë 20.5.2024.

²⁴ Email datë 26.5.2024.

²⁵ (i) Sipas Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 4.4.2007, kostoja është 25.317 lekë/m²; (ii) sipas Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 20.8.2008, për vitet 2008 – 2009, kostoja është 27.640 lekë/m². Kostoja mesatare për tri vite (2007, 2008, 2009) rezulton 26.866 lekë (25.317 + 27.640 + 27.640)/3.

²⁶ Vendim nr. 34, datë 21.9.2022.

²⁷ Bodrumi 121 m² x 26.866 lekë x 50% = 1.625.393 lekë; kati i parë 121 m² x 26.866 lekë = 3.250.786 lekë; kati i dytë 101 m² x 26.866 lekë = 2.713.466 lekë.

²⁸ Vërtetim datë 11.1.2017 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

²⁹ Vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare të shtetasit K. Ç. – përlllogaritur paga neto, në përputhje me legjislacionin e kohës.

³⁰ (i) Vërtetim datë 21.10.2016 dhe shkresë nr. *** prot., datë 17.5.2024, Zyra e Përmbarrimit Korçë; (ii) vërtetim page datë 10.3.2015 nga shoqëria “****” sh.p.k. me NUIS ***, (iii) vërtetim datë 25.12.2013 nga eksperti vlerësues J. S., (iv) urdhër pune datë 16.5.2016 nga shoqëria “****” sh.p.k., (v) urdhër pune datë 15.6.2016 nga subjekti “V. M.”, person fizik.

ii) Depozita e babait të subjektit/S. Q. në vlerën 38.128 USD

1.30 Në DIPP/2007, subjekti ka deklaruar: *“Trashëgim nga vdekja e babait së bashku me mamanë një depozitë në Raiffeisen Bank prej 36.630 USD”*.

1.31 Në DIPP/2008, subjekti ka deklaruar: *“Tërheqje dhe mbyllje e depozitës në Raiffeisen Bank, trashëguar nga vdekja e babait dhe pakësuar komplet kjo shumë, pasi u përdor për ndërtimin e shtëpisë së re të deklaruar më parë, në shumën 36.630 USD”*.

1.32 Në kushtet që në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar se si burim për investimin e kryer ka shërbyer shuma 38.128 USD, ndërsa në DIPP/2008 ka deklaruar shumën 36.630 USD, me anë të pyetësorit nr. 1 subjektit iu kërkua të saktësojë shumën e përdorur.

1.33 Në përgjigje³¹, subjekti konfirmoi se nga depozita në shumën 38.128,51 USD për shtëpinë e re u përdorën 36.630 USD.

1.34 *Lidhur me origjinën e krijimit të kësaj shume*, referuar dokumentacionit të administruar nga Raiffeisen Bank³², u konstatua se në llogarinë bankare të babait të subjektit në datën 14.4.2005 është depozituar shuma 30.000 USD, me përshkrimin *“Cash deposit”*, për krijimin e një depozite me afat 24 muaj.

1.35 Pas maturimit të depozitës, babai i subjektit ka tërhequr shumën 31.630 USD³³ në datën 16.4.2007 dhe po në të njëjtën datë ka depozituar në një llogari tjetër në emër të tij shumën 36.630 USD, me përshkrimin *“S. Q. sa derdhur depozitë kalim dhe derdhje”*.

1.36 Kjo depozitë është maturuar në datën 17.4.2008 dhe në të njëjtën datë subjekti ka tërhequr shumën 38.128 USD³⁴ (sipas dëshmisë së trashëgimisë ligjore i ndjeri S. Q. ka ndërruar jetë në datën 25.4.2007³⁵).

1.37 Sa më lart, Komisioni konstaton se shuma përfundimtare e tërhequr nga subjekti pas lëshimit të trashëgimisë është krijuar nga: (i) depozitimi i shumës 30.000 USD në datën 14.4.2005; (ii) shtesa prej 5.000 USD në datën 16.4.2007; (iii) interesat neto në shumën 3.128 USD.

1.38 Me anë të pyetësorit nr. 1, Komisioni i kërkoi subjektit të paraqesë dokumentacion ligjor justifikues për të ardhurat që kanë shërbyer për krijimin e kësaj depozite bankare.

1.39 Në përgjigje³⁶, subjekti shpjegoi se është në pamundësi për t’u marrë deklaratë prindërve, pasi ata nuk jetojnë më, por sqaron Komisionin se: *“Unë faktikisht në atë kohë kisha dijeni për një depozitë bankare të babait tim, por vlerën reale se sa ishte nuk e dija, pasi unë jam ndarë nga prindërit e mi që në momentin e martesës, datë 11.8.1988, dhe kam jetuar në banesën e prindërve të bashkëshortit tim. Aktualisht të dy prindërit e mi kanë vdekur, por në dijeninë time kjo shumë është krijuar midis te tjerash nga: (i) kursimet familjare të prindërve të mi, si dhe nga kursimet nga puna e vëllait tim Dh. Q., i cili ka vdekur më 25.4.1996. Ai ishte mjek dhe ka punuar rreth 12 vite. Ai vuante nga një sëmundje dhe po përgatitej të shkonte në Turqi për t’u kuruar, por nuk arriti dot, sepse ndërroi jetë. Këto kursime ishin ekstreme, pasi do të*

³¹ Email datë 13.5.2024.

³² (i) Vërtetim nr. *** prot., datë 22.2.2016 (paraqitur në deklaratën *Vetting*), (ii) lëvizje llogarie nr. *** dhe nr. ***, në emër të shtetasit S. Q. (paraqitur në deklaratën *Vetting*); (iii) shkresë nr. *** prot., datë 27.3.2021, e Raiffeisen Bank.

³³ E përbërë nga shuma e depozituar (30.000 USD) dhe interesat neto (1.630 USD).

³⁴ E përbërë nga shuma e depozituar (36.630 USD) dhe interesat neto (1.508 USD).

³⁵ Trashëgimtarë ligjor të tij figurojnë bashkëshortja A. Q. dhe vajza e tij Irena Çunoti (Qeleshi), të cilët trashëgojnë 1/2 pjesë të pasurisë së tij.

³⁶ Email datë 13.5.2024.

*përdoreshin për operacionin e tij në Turqi; (ii) babai im ishte në profesion tornitor dhe në gjendje të mirë shëndetësore, pasi doli në pension herë pas here shkante në Greqi, ku jetonte në shtëpinë e nipit të tij (djalit të vëllait) Dh. Q. në S., ku punonte sezonal si tornitor, ku dhe u pajis me dokumente greke. Nga shteti grek ai ka marrë edhe pensione, dokumentet e të cilave unë munda t'i siguroj dhe po jua vë në dispozicion; (iii) mamaja, motra e saj M. G. dhe dy vëllezërit e saj, V. dhe G. C., kanë shitur dhe një dyqan në tregun e Korçës, sipas kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.2.2002. Mamaja dhe dy vëllezërit e saj përfituan dhe pjesën e motrës së tyre M. G. (banuese në SHBA), e cila jua la atyre; (iv) kam dijeni që prindërit e mi dispononin edhe letra me vlerë, të cilat i konvertuan në lekë, por unë nuk e di vlerën e tyre; (v) mamaja ishte bashkëpronare me vëllezërit e saj (sot jam unë sipas dëshmisë së trashëgimisë) e disa tokave, brenda vijës së verdhë me sipërfaqe 2.678 m² dhe 3.840 m², të cilat i menaxhonte babai; (vi) po kështu dhe babai i babait tim, T. Q. (gjyshi im), ka emigruar në SHBA, ku atje dhe ka vdekur”.*

1.40 Bashkëlidhur subjekti ka paraqitur: (i) dokument grek në emër të babait S. Q. (t.); (ii) dy dokumente në gjuhën greke të përkthyer në shqip për pensionet e përfituara nga babai i subjektit; (iii) dokument në gjuhën greke të shtetasit Dh. Q. (nipi i babait të subjektit); (iv) kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 27.2.2002.

1.41 Komisioni analizoi dokumentacionin e paraqitur dhe konstatoi si në vijim:

- *Lidhur me të ardhurat nga pensioni grek, rezultoi se i ndjeri/babai i subjektit ka përfituar shumën 7.401,92 euro gjatë vitit 2006 (ku përfshihen edhe pensionet e prapambetura për vitet 2004 – 2005) dhe 1.472,08 euro gjatë vitit 2007, në total shumën 8.874 euro.*

- *Lidhur me të ardhurat nga kontrata e shitblerjes nr. ***, datë 27.2.2002, konstatohet se shtetasit A. M. Q., V. C., G. C. dhe M. G. i kanë shitur shtetasit B. H. një dyqan të ndodhur në tregun e Korçës përkundrejt çmimit 500.000 lekë.*

Subjekti ka deklaruar se shtetasja M. G. ia ka falur pjesën takuese nënës së subjektit dhe vëllezërve, por në kushtet e mungesës së dokumentacionit për të provuar këtë deklaram, për efekt të analizës financiare, përlllogariti si të ardhura $\frac{1}{4}$ e çmimit, pra 125.000 lekë.

1.42 Sa më lart, Komisioni kreu analizën financiare për të verifikuar burimet e ligjshme të depozitimit të shumës 30.000 USD në datën 14.4.2005, paraqitur në tabelën vijuese:

Tabela nr. 2 – Analiza financiare e prindërve të subjektit (depozitimi 30.000 USD, periudha 1.9.1991³⁷ – mars 2005)

Përshkrimi	Shuma
Të ardhura nga pensioni, babai ³⁸	1,030,263
Të ardhura nga pensioni, nëna ³⁹	737,076
Të ardhura nga shitja e dyqanit	125,000
Total të ardhura	1,892,339
Shpenzime jetese ⁴⁰	1,464,745
Depozitim 30.000 USD, datë 14.4.2005 ⁴¹	2,996,100
Total shpenzime dhe pasuri	4,460,845
Diferenca	-2,568,506

1.43 Referuar analizës financiare, duket se i ndjeri/babai i subjektit ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën -2.568.506 lekë për depozitimin e shumës 30.000 USD, në datën 14.4.2005.

1.44 Lidhur me shtesën prej 5.000 USD të depozitës, datë 16.4.2007, konstatohet se i ndjeri/babai i subjektit ka pasur burime të ligjshme financiare për këtë shtesë, pasi të ardhurat nga pensioni grek kanë qenë në shumën 8.874 euro.

1.45 Në përfundim, duket se i ndjeri/babai i subjektit ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën -2.568.506 lekë për kryerjen e depozitimit prej 30.000 USD, në datën 14.4.2005. Për rrjedhojë, në analizën financiare të vitit 2008, në zërin e të ardhurave “Të ardhura subjekti të trashëguara nga babai (depozita Raiffeisen)”, u paraqit si e ardhur vetëm shuma 5.000 USD (shtesa e depozitës në vitin 2007).

iii) Kredi në vlerën 30.000 euro nga NBG Bank

1.46 Referuar dokumentacionit të paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting*, rezulton se ndërmjet Bankës Kombëtare të Greqisë në cilësinë e kredidhënësit dhe shtetasve Irena Çunoti e K. Ç. në cilësinë e kredimarrësve dhe shtetas A. Q., në cilësinë e dorëzanësit, është lidhur kontrata e kredisë nr. ***, datë 18.12.2007, me objekt dhënien e një kredie në shumën 30.000 euro, me qëllim blerjen/rikonstruktimit e një banese me adresë rruga “****”, Korçë.

1.47 Gjithashtu, ndërmjet palëve të mësipërme është lidhur kontrata e hipotekës nr. ***, datë 18.12.2007, me anë të së cilës është bërë sigurimi i kredisë në vlerën 30.000 euro, duke hipotekuar pasurinë nr. ***, z. k. ***, me vendndodhje në Korçë. Kjo kontratë ka përfunduar

³⁷ Lidhur me të ardhurat përpara kësaj periudhe, Komisioni iu referua vendimit nr. 15-2021 (JR), datë 18.6.2021, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i cili në funksion të një qëndrimi orientues, sipas parashikimit të nenit 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, parashtron: “[...] periudha kohore para ndryshimeve demokratike në vend që përkon me vitet 1991 – 1992, nuk mund të jetë si rregull një periudhë e cila mund të llogaritet në funksion të përcaktimit të ndonjë vlere të kursyer, për shkak të një realiteti të jetuar që ka provuar se monedha zyrtare, leku, në këtë periudhë pësoi një inflacion në nivele shumë të larta e të jashtëzakonshëm, produkt i ndryshimeve politike, sociale dhe ekonomike në vend që e bën të pabesueshme dhe të palogjikshme mundësinë potenciale të kursimit nga të ardhurat nga puna në këto periudha. Për pasojë, pasi monedha vendase hyri në një fazë stabiliteti, pas viteve 1992-1993, mundësia për të kursyer mund të konsiderohet si opsion.. [...]”. Për rrjedhojë, për efekt të analizës financiare, Komisioni mori në konsideratë të ardhurat nga paga e subjektit duke filluar nga viti 1.9.1991 e në vijim.

³⁷ 27 muaj x 4.842 lekë.

³⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 26.2.2024, e DRSSH-së Korçë.

³⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 26.2.2024, e DRSSH-së Korçë.

⁴⁰ Shpenzimet e jetesës u përlogariten: (i) për periudhën 1991 – 1999, në kuadër të arsyetimit të përdorur nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit (vendimi nr. 11-2019 (JR), datë 22.5.2019) 66% të të ardhurave për pagë vjetore nën 800 USD; (ii) bazuar në shkresën e ILDKPKI-së nr. *** prot., datë 4.3.2019, për periudhën 2000 – 2005.

⁴¹ Vlerësuar me kursin zyrtar të këmbimit në datën e depozitimit, 1 USD = 99,87 lekë.

me deklaratën noteriale nr. ***, datë 29.12.2014, të NBG Bank për zhbllokimin nga hipoteka të pasurisë së mësipërme⁴².

1.48 Në përgjigje të pyetësorit standard⁴³, subjekti ka deklaruar se *...ka marrë vetëm një kredi në shumën 30.000 euro tek Banka Kombëtare e Greqisë... sipas kontratës së kredisë nr. ***, datë 18.12.2007. Vlera monetare e kësaj kredie u përdor për ndërtimin e shtëpisë së re në adresën: Lagjja Nr. ***, rruga “****”, nr. ***, Korçë. Në vitin 2014 ka përfunduar plotësisht shlyerja e kësaj kredie... çka vërtetohet me deklaratën noteriale nr. ***, datë 29.12.2014”*.

1.49 Nga analizimi i dokumentacionit të përcjellë nga ABI Bank⁴⁴ konstatohet se kredia është lëvruar në datën 19.12.2007 në shumën 9.000 euro, në datën 31.3.2008 në shumën 10.500 euro dhe në datën 8.10.2008 në shumën 10.500 euro, në total 30.000 euro.

1.50 Shumat e lëvruara nga kredia janë tërhequr *cash* nga subjekti, konkretisht në datën 21.12.2007 janë tërhequr 8.870 euro, në datën 2.4.2008 janë tërhequr 10.353 euro dhe në datën 8.10.2008 janë tërhequr 10.000 euro.

1.51 Lidhur me përdorimin e kredisë për shpenzimet e ndërtimit, Komisioni vëren se në deklaratimet periodike vjetore subjekti ka bërë këto deklarime:

- Në DIPP/2007 ka deklaruar: *“Me kontratën e kredisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.12.2007, të Bankës Kombëtare të Greqisë, u aprovua kredia 30.000 euro, prej së cilës u tërhoq kësti i parë në vlerë 9.000 euro...”*.
- Në DIPP/2008 ka deklaruar: *“Pakësuar sasia komplet e kredisë së marrë për ndërtimin e shtëpisë së re në shumën 20.000 euro”*. Në seksionin “Detyrimet financiare...”, deklaroi: *“Tërheqje e dy kësteve të tjera të kredisë së deklaruar në vitin 2007 në shumën 21.000 euro”*.
- Në DIPP/2009 subjekti ka deklaruar: *“Gjendja cash prej 10.000 euro e këstit të fundit të kredisë e mbetur nga viti 2008 u harxhua për ndërtimin e shtëpisë së re”*.

1.52 Në përgjigje të pyetësorit nr. 1⁴⁵, subjekti shpjegoi se kësti i parë i kredisë në shumën 9.000 euro është tërhequr në dhjetor të vitit 2007 dhe është harxhuar për ndërtimin e shtëpisë së re në vitin 2008; dy këstet e tjera janë tërhequr në vitin 2008 dhe janë harxhuar për ndërtimin e shtëpisë së re, ku kësti i dytë është harxhuar për këtë qëllim në vitin 2008, kurse kësti i tretë i tërhequr në tetor të vitit 2008 u harxhua në vitin 2009.

1.53 Referuar këtij shpjegimi, duket se subjekti e ka pasur në gjendje *cash* në fund të vitit 2007 shumën e kredisë së tërhequr nga lëvrimi i këstit të parë, por nuk e ka deklaruar në DIPP/2007.

1.54 Në përgjigje të pyetësorit nr. 2⁴⁶, subjekti shpjegon se: *“...është e vërtetë që unë nuk kam deklaruar gjendjen cash shumën prej 9.000 euro të këstit të parë të kredisë në fund të vitit 2007, por duke qenë se këtë këst kredie unë e kam deklaruar që e kam tërhequr në datën 21.12.2007 dhe këto ditë ishin afër festave të fundvitit, që nuk punohej, kam menduar se ka qenë e mjaftueshme për të kuptuar se kjo shumë ka qenë gjendje cash”*.

1.55 Sa më lart, në kushtet që: (i) kësti i parë i kredisë (shuma 8.870 euro) është tërhequr nga llogaria bankare në datën 21.12.2007, pra në fund të vitit; (ii) subjekti ka deklaruar pakësimin

⁴² Të dorëzuar nga subjekti në procesverbalin e datës 24.2.2016 të ILDKPKI-së.

⁴³ Email datë 11.2.2021.

⁴⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 2.8.2021.

⁴⁵ Email datë 13.5.2024.

⁴⁶ Email datë 26.5.2024.

e kredisë në shumën 20.000 euro në DIPP/2008, shumë e cila, sipas shpjegimit të subjektit, i përket tërheqjes në datat 21.12.2007 dhe 2.4.2008⁴⁷; (iii) burimi i shumës së tërhequr është i ligjshëm, pasi ka si burim kredinë – Komisioni e konsideroi shpjegimin e subjektit se shuma e tërhequr në vitin 2007 ka qenë gjendje *cash* në fund të këtij viti dhe është përdorur për ndërtimin e shtëpisë gjatë vitit 2008.

Analiza financiare

1.56 Në vijim të fakteve të analizuar më lart, Komisioni kreu analizën financiare për subjektin dhe personat e lidhur, për vitet 2007, 2008 dhe 2009 – periudha gjatë së cilës janë kryer shpenzimet për ndërtimin – ku u konsideruan: (i) shumat e shpenzuara për ndërtimin; (ii) ndryshimi i likuiditeteve *cash*; (iii) ndryshimi i likuiditeteve në bankë⁴⁸; (iv) të ardhurat e subjektit nga pagat⁴⁹ dhe mësimdhënia⁵⁰; (v) të ardhurat e bashkëshortit të subjektit nga aktiviteti tregtar si person fizik⁵¹ dhe ekspert mekanik⁵²; (vi) të ardhurat e trashëguara nga babai⁵³; (vii) të ardhurat nga interesat bankarë; (viii) shpenzimet e jetesës sipas ILDKPKI – INSTAT⁵⁴; (ix) shpenzimet për pagesën e kredisë⁵⁵; (x) shpenzimet e shkollimit për vajzën⁵⁶; (xi) shpenzimet për udhëtime nga sistemi TIMS.

Tabela nr. 3 – Analiza financiare për vitet 2007, 2008 dhe 2009

Përshkrimi	Ndërtimi		
	Viti 2007	Viti 2008	Viti 2009
Shtëpi banimi 2 kate dhe bodrum, Korçë	1,552,150	5,528,891	1,795,500
Shtim/pakësim likuiditete <i>cash</i>	86,150	165,950	-758,172
Shtim/pakësim likuiditete në bankë	624,927	220,873	-1,357,117
Total pasuri	2,263,227	5,915,714	-319,789
Kredi ABI Bank, 30.000 euro	1,082,790	2,589,510	0
Total detyrime	1,082,790	2,589,510	0
Të ardhura subjekti nga pagat	952,953	892,898	1,204,806
Të ardhura të subjektit nga mësimdhënia	50,220	0	0
Të ardhura të bashkëshortit nga aktiviteti tregtar	883,344	400,000	444,000
Të ardhura të bashkëshortit si ekspert mekanik	130,000	20,000	85,000
Të ardhura të subjektit të trashëguara nga babai	0	419,450	0
Të ardhura nga interesat bankarë	0	146,660	32,842
Total të ardhura	2,016,517	1,879,008	1,766,648
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI - INSTAT	522,216	409,860	409,860
Shpenzime për pagesën e kredisë	15,576	447,204	722,595
Shpenzime shkollimi për vajzën	50,000	61,400	264,120

⁴⁷ Totali i këtyre dy tërheqjeve është 19.223 euro.

⁴⁸ Diferenca midis gjendjes së likuiditeteve bankare në fund të vitit me atë në fillimi të vitit.

⁴⁹ Vërtetim datë 11.1.2017 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

⁵⁰ Vërtetim datë 24.10.2016 nga universiteti “****”, kredituar në Raiffeisen Bank datë 24.7.2007.

⁵¹ Trajtuar në paragrafët 2.14 - 2.22 të relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht.

⁵² Shkresë nr. *** prot., datë 17.5.2024, e Zyrës së Përmbarrimit Korçë.

⁵³ Shuma 5.000 USD e vlerësuar me të njëjtin kurs këmbimi që është vlerësuar shpenzimi i kryer (kursi mesatar vjetor për vitin 2008, 1 USD = 83,89 lekë).

⁵⁴ Bazuar në shkresën e ILDKPKI-së nr. ***, datë 4.3.2019.

⁵⁵ Bazuar në shumat e debituar në llogaritë bankare për pagesën e principalit, interesave dhe shpenzimeve të ndryshme për kredinë.

⁵⁶ Vërtetim nr. *** prot., datë 21.12.2020, kolegji “****” (paraqitur në pyetësin standard); shkresë nr. *** prot., datë 2.5.2024, ***.

Shpenzime për udhëtime nga sistemi TIMS	39,558	26,402	35,479
Total shpenzime	627,351	944,866	1,432,054
Balanca e fondeve (Të ardhura + detyrime - pasuri - shpenzime)	208,730	-2,392,062	654,383

1.57 Sa më lart, nga analiza financiare duket se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën -2.392.062 lekë për ndërtimin e banesës në Korçë.

1.58 Më tej, Komisioni kreu analizën financiare për subjektin dhe personat e lidhur, për vitet 2010, 2015 dhe 2016, periudha gjatë së cilës janë kryer shpenzimet për mobilimin dhe punime të tjera – ku u konsideruan: (i) shumat e shpenzuara për mobilimin dhe punime të tjera; (ii) ndryshimi i likuiditeteve *cash*; (iii) ndryshimi i likuiditeteve në bankë⁵⁷; (iv) të ardhurat e subjektit nga pagat⁵⁸; (v) të ardhurat e bashkëshortit të subjektit nga aktiviteti tregtar si person fizik⁵⁹ dhe si ekspert mekanik⁶⁰; (vi) të ardhurat nga interesat bankarë; (vii) shpenzimet e jetesës sipas ILDKPKI - INSTAT⁶¹; (viii) shpenzimet për pagesën e kredisë⁶²; (ix) shpenzimet e shkollimit për vajzën⁶³; (x) shpenzimet për udhëtime nga sistemi TIMS.

Tabela nr. 4 – Analiza financiare për vitet 2010, 2015 dhe 2016

Përshkrimi	Mobilimi dhe punime të tjera		
	Viti 2010	Viti 2015	Viti 2016
Shtëpi banimi 2 kate dhe bodrum, Korçë	415,760	2,200,000	1,130,000
Shtim/pakësim likuiditete <i>cash</i>	2,493,322	-1,000,000	124,140
Shtim/pakësim likuiditete në bankë	-3,003,592	41,145	-91,253
Total pasuri	-94,510	1,241,145	1,162,887
Kredi ABI Bank, 30.000 euro (2007 – 2008)	0	0	0
Total detyrime	0	0	0
Të ardhura të subjektit nga pagat	1,370,814	1,553,297	1,541,403
Të ardhura të bashkëshortit nga aktiviteti tregtar	444,004	432,433	545,125
Të ardhura të bashkëshortit nga punësimi	0	39,072	0
Të ardhura të bashkëshortit si ekspert mekanik	25,000	0	58,200
Të ardhura nga interesat bankarë	42,787	3,766	23,277
Total të ardhura	1,882,604	2,028,568	2,168,005
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI - INSTAT	409,860	448,552	470,184
Shpenzime për pagesën e kredisë	750,366	0	0
Shpenzime shkollimi për vajzën	344,475	0	0
Shpenzime për udhëtime nga sistemi TIMS	54,316	0	38,464
Total shpenzime	1,559,016	448,552	508,648
Balanca e fondeve (të ardhura + detyrime - pasuri - shpenzime)	418,098	338,871	496,471

⁵⁷ Diferenca midis gjendjes së likuiditeteve bankare në fund të vitit me atë në fillimi të vitit.

⁵⁸ Vërtetim datë 11.1.2017 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

⁵⁹ Trajtuar në paragrafët 2.14 - 2.22 të relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht.

⁶⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 17.5.2024, e Zyrës së Përmbarimit Korçë.

⁶¹ Bazuar në shkresën e ILDKPKI-së nr. ***, datë 4.3.2019.

⁶² Bazuar në shumat e debituar në llogaritë bankare për pagesën e principalit, interesave dhe shpenzimeve të ndryshme për kredinë.

⁶³ Shkresë nr. *** prot., datë 2.5.2024, A. U..

1.59 Sa më lart, nga analiza financiare duket se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme financiare për mobilimin dhe kryerjen e punimeve të ndryshme në banesën në Korçë.

1.60 Nga faktet e analizuara më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: *Subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën -2.392.062 lekë për ndërtimin e banesës në Korçë, pasi nuk provohen burimet e ligjshme financiare të krijimit të depozitës së trashëguar nga babai (depozitë e krijuar në datën 14.4.2005, shuma 30.000 USD).*

1.61 Në përgjigje të rezultateve të hetimit⁶⁴, subjekti shpjegon se në bazë të pikave 13 e 14 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, në kushtet e përfitimit të pasurisë së babait të saj me dëshmi trashëgimie, ky i fundit nuk është person i lidhur dhe subjekti nuk ka detyrimin për të deklaruar burimin e të ardhurave të pasurisë së tij.

1.62 Subjekti vijon duke shpjeguar se, pavarësisht sa më lart, nga dokumentacioni që ka arritur të grumbullojë, është mundur të bëjë një analizë në lidhje me të ardhurat.

1.63 Më tej, subjekti shpjegon se është në pamundësi për t'ju marrë deklaratë prindërve apo për t'i kërkuar dokumentacion justifikues dhe deklaroi se nuk kishte dijeni për vlerën e kësaj pasurie, pasi është ndarë nga prindërit që momentin e martesës, datë 11.8.1988, dhe ka jetuar në banesën e prindërve të bashkëshortit të saj.

1.64 Subjekti shpjegon se prindërit e saj kanë punuar prej shumë vitesh dhe se të ardhurat e tyre nuk janë vetëm prej datës 1.9.1991, moment nga i cili është marrë në konsideratë burimi i të ardhurave.

1.65 Konkretisht, subjekti parashtron pretendimet e saj, si në vijim:

1.65.1 *Së pari*, subjekti kërkon që të përfshihen në analizën financiare të ardhurat nga paga e vëllait Dh. Q., për periudhën 1.12.1984 – 25.4.1996.

Subjekti shpjegon se, sipas librezës së punës⁶⁵, i ndjeri/vëllai i saj ka filluar punë në datën 1.12.1984 si mjek i përgjithshëm, me pagë 650 lekë/muaj. Në datën 1.12.1986 ka pasur rritje page në 680 lekë/muaj. Po ashtu, në datën 1.1.1991, përsëri si mjek i përgjithshëm, me pagë 715 lekë/muaj.

Subjekti sqaron se nuk disponon të dhëna në lidhje me pagën e vëllait për periudhën shkurt 1991 – korrik 1995, por për referencë page për vitet 1994 – 1995 ka paraqitur një vërtetim për bazën e vlerësuar të mjekut N. Th.⁶⁶, i cili referuar shpjegimeve të subjektit ka qenë student në të njëjtën kohë me vëllain e subjektit, kanë mbaruar shkollën së bashku dhe kanë filluar punë në të njëjtën kohë.

Më tej, subjekti sqaron se sipas akt-verifikimit të vjetërsisë në punë para vitit 1994⁶⁷, vëllai ka punuar si mjek në KFB ***, por ky institucion nuk disponon dokumentacion në lidhje me

⁶⁴ E-mail datë 15.7.2024.

⁶⁵ Paraqitur nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të rezultateve të hetimit.

⁶⁶ Vërtetim datë 9.7.2024, punëdhënës Spitali Elbasan.

⁶⁷ Vërtetim nr. ***, datë 12.7.2024, lëshuar nga DRSSH Korçë.

pagën. Gjithashtu, referuar dokumentacionit të paraqitur, nuk disponohen listëpagesa për periudhën janar 1994 – korrik 1995⁶⁸.

Po kështu, për periudhën gusht 1995 – dhjetor 1995 ka përfituar të ardhura nga paga në vlerën 42.145 lekë⁶⁹, ndërsa për periudhën janar 1996 – 25 prill 1996 ka përfituar të ardhura në vlerën 39.100 lekë⁷⁰, shpjegon subjekti.

Subjekti pretendon që mungesa e dokumentacionit pranë DRFSDKSH-së nuk mund të privojë apo zerojë të ardhurat e realizuara për periudhën përpara datës 1.1.1994 dhe, për këtë arsye, paga për këtë periudhë mund të llogaritet bazuar në VKM-në nr. 561, datë 12.8.2005, “Për përcaktimin e pagave referuese për llogaritjen e pensioneve”, sipas së cilës paga për specialist të lartë është 4.192 lekë.

Më tej, subjekti shpjegon se të gjitha kursimet e familjes ktheheshin në dollar për t’i shërbyer qëllimit të kurimit të vëllait. Referuar përlllogaritjeve të subjektit, të ardhurat e vëllait kanë qenë në shumën 319.001 lekë, ndërsa shpenzimet në shumën 95.730 lekë.

Në përfundim, subjekti deklaron se kursimet e vëllait Dh. Q. për periudhën 1.12.1984 – 25.4.1996 kanë qenë në shumën 5.525 USD⁷¹.

1.65.2 Së dyti, subjekti kërkon që të përfshihen në analizën financiare edhe të ardhurat e realizuara nga nëna dhe babai për periudhën 1.12.1984 – 31.8.1991. Referuar përlllogaritjeve të subjektit, në zërin e të ardhurave të babait duhet të pasqyrohet edhe një shtesë prej 54.004 lekësh. Më tej, subjekti ka kryer konvertimin e kursimeve bazuar në kursin e këmbimit në vitin që janë realizuar të ardhurat. Në përfundim, subjekti deklaron që shuma e kursyer nga babai deri në fund të 1996 ka qenë 3.249 USD.

Për sa i përket të ardhurave të nënës, subjekti pretendon që në zërin e të ardhurave duhet të pasqyrohet edhe një shtesë prej 50.250 lekësh. Më tej, subjekti ka kryer konvertimin e kursimeve bazuar në kursin e këmbimit në vitin që janë realizuar të ardhurat. Në përfundim, subjekti deklaron që shuma e kursyer nga nëna deri në fund të 1996 ka qenë 3.886 USD.

1.65.3 Së treti, subjekti kërkon që të përfshihen në analizën financiare edhe të ardhurat e përfituara nga babai në shumën totale 390.000 lekë, për shpërblimin e marrë për të dy vëllezërit dëshmorë gjatë periudhës 1.1.2002 – 30.3.2007⁷².

1.65.4 Së katërti, subjekti kërkon që të ardhurat e nënës nga shitja e tokës të pasqyrohen në shumën 166.667 lekë, përkundrejt shumës 125.000 lekë të përlllogaritur nga Komisioni, pasi nëna e saj ka përfituar 1/3 e çmimit të shitjes. Për të provuar deklaratimet e saj, subjekti ka paraqitur prokurën e posaçme datë 17.11.2001 të shtetases M. G. (C.).

⁶⁸ Referuar vërtetimit për bazën e vlerësuar nr. ***, datë 12.7.2024, lëshuar nga DRSSH Korçë.

⁶⁹ Vërtetim nr. *** prot., datë 5.7.2024, lëshuar nga DRFSDKSH Korçë.

⁷⁰ Vërtetim nr. *** prot., datë 5.7.2024, lëshuar nga DRFSDKSH Korçë.

⁷¹ (i) Për periudhën 1.12.1984 – 1.1.1991, kursimet kanë qenë në shumën 34.244 lekë (konvertuar në 3.424 USD, me kurs këmbimi 1 USD = 10 lekë); (ii) për vitin 1991, kursimet kanë qenë në shumën 6.006 lekë (konvertuar në 240 USD, me kursin mesatar 1 USD = 25 lekë sipas raportit vjetor të Bankës së Shqipërisë të vitit 1993); (iii) për periudhën 1992 – 31.7.1995 kursimet kanë qenë në shumën 1.276 USD (të konvertuara me kursin 1 USD = 98.88 lekë); (iv) për periudhën 1.8.1995 – 31.12.1995, kursimet kanë qenë në shumën 310 USD (të konvertuara me kursin 1 USD = 94,95 lekë); (v) për periudhën 1.1.1996 – 25.4.1996 kursimet kanë qenë 274 USD (të konvertuara me kursin 1 USD = 100 lekë).

⁷² Subjekti paraqiti vërtetimin nr. *** prot., datë 9.7.2024, lëshuar nga DRSSH Korçë.

1.66 Referuar përlllogaritjeve të kryera nga subjekti, kursimet totale kanë qenë 1.200.603 lekë, nga të cilat 363.667 lekë janë konvertuar ndër vite në 12.660 USD, ndërsa pjesa tjetër, pra shuma 836.936 lekë, është konvertuar në 8.380 USD.

1.67 Më tej, subjekti pretendon se sipas dokumentacionit që ka mundur të mbledhë totali i shumës së kursyer deri në datën 14.4.2005 ka qenë 21.040 USD⁷³ (përkundrejt shumës së depozituar prej 30.000 USD).

1.68 Gjithashtu, subjekti kërkoi të konsiderohen edhe këto rrethana: (i) babai ka qenë me profesion tornitor dhe në gjendje të mirë shëndetësore dhe se, pasi doli në pension, herë pas here shkante në Greqi, ku punonte sezonalisht; (ii) prindërit e subjektit dispononin letra me vlerë, të cilat i konvertuan në lekë; (iii) nëna e subjektit kanë qenë bashkëpronare me vëllezërit e saj të disa tokave, brenda vijës së verdhë, me sipërfaqe 2.678 m² dhe 3.840 m²; (iv) gjyshi i subjektit ka emigruar në SHBA, ku edhe ka ndërruar jetë.

1.69 Subjekti sqaron se për këto të ardhura nuk disponon dokumentacion për të vërtetuar vlerën e plotë të derdhjes në bankë, për shkak se prindërit dhe vëllai kanë ndërruar jetë.

1.70 Në përfundim, referuar analizës së kursimeve, si dhe arsyetimit për të ardhurat nga burime të tjera, subjekti deklaron se provohet se burimet për ndërtimin e shtëpisë së re kanë qenë të ligjshme dhe se prindërit kanë pasur mundësi financiare për të krijuar depozitën 30.000 USD.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

1.71 Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore – arsyeton si vijon:

1.72 *Së pari*, lidhur me pretendimit e subjektit për të ardhurat e realizuara nga vëllai, pas analizimit të dokumentacionit të realizuar, Komisioni kreu përlllogaritjet e pagave për periudhën 1991 – prill 1996, në shumën totale 254.829 lekë, si vijon:

1.72.1 *Për periudhën 1991 – 1993*, të ardhurat u përlllogaritën referuar pagës së pasqyruar në librezën e punës, konkretisht 36 muaj me pagë mujore 715 lekë, në total 25.740 lekë.

1.72.2 *Për periudhën janar 1994 – korrik 1995*, të ardhurat u përlllogaritën në shumën 147.744 lekë⁷⁴, duke përdorur si pagë referuese pagën e muajit gusht 1995⁷⁵, në masën 7.776 lekë/muaj.

1.72.3 *Për periudhën gusht 1995 – prill 1996*, të ardhurat u përlllogaritën në shumën 81.345 lekë, bazuar në vërtetimin datë 9.7.2024, paraqitur nga subjekti në përgjigje të prapësimeve.

1.72.4 Për sa i përket pretendimit të subjektit se shumet e kursyera janë konvertuar në monedhën dollar në vitin në të cilin janë krijuar, Komisioni vlerëson se ky pretendim është i

⁷³ (i) Shuma 5.525 USD e kursyer nga vëllai; (ii) shuma 3.249 USD e kursyer nga babai; (iii) shuma 3.886 USD e kursyer nga nëna; (iv) shuma 8.380 USD (836.926 lekë si rezultat i diferencës së kursimeve totale prej 1.200.603 lekësh me kursimet prej 363.667 lekësh – ekuivalenti i 12.660 USD të konvertuar ndër vite).

⁷⁴ 19 muaj x 7.776 lekë/muaj.

⁷⁵ Vërtetim datë 9.7.2024, paraqitur nga subjekti në përgjigje të prapësimeve.

pabazuar dhe nuk mund të merret në konsideratë, për sa kohë që nuk provohet me dokumentacion justifikues dhe mbetet në nivel deklarativ.

1.73 *Së dyti*, lidhur me pretendimin e subjektit për të përfshirë në analizën financiare të ardhurat e realizuara që nga data 1.12.1984, Komisioni e konsideroi të pabazuar këtë pretendim, duke iu referuar vendimit nr. 15-2021 (JR), datë 18.6.2021, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i cili, në funksion të një qëndrimi orientues sipas parashikimit të nenit 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, parashtron: “[...] *periudha kohore para ndryshimeve demokratike në vend që përkon me vitet 1991 – 1992, nuk mund të jetë si rregull një periudhë e cila mund të llogaritet në funksion të përcaktimit të ndonjë vlere të kursyer, për shkak të një realiteti të jetuar që ka provuar se monedha zyrtare, leku, në këtë periudhë pësoi një inflacion në nivele shumë të larta e të jashtëzakonshëm, produkt i ndryshimeve politike, sociale dhe ekonomike në vend që e bën të pabesueshme dhe të palogjikshme mundësinë potenciale të kursimit nga të ardhurat nga puna në këto periudha. Për pasojë, pasi monedha vendase hyri në një fazë stabiliteti, pas viteve 1992 – 1993, mundësia për të kursyer mund të konsiderohet si opsion [...]*”. Për rrjedhojë, shuma e të ardhurave të nënës dhe babait të subjektit mbeten të pandryshuara në analizën financiare.

1.74 *Së treti*, lidhur të ardhurat e përfituara nga babai si shpërblim për vëllezërit dëshmorë, Komisioni, pas verifikimit të të dhënave të vërtetimit⁷⁶ të paraqitur nga subjekti gjatë prapësimeve, çmon se ky pretendim është i bazuar dhe duhet marrë në konsideratë, duke paraqitur në analizën financiare shumën 396.500 lekë⁷⁷.

1.75 *Së katërti*, lidhur me shumën e të ardhurave të përfituara nga nëna nga shitja e tokës, Komisioni konstaton se në prokurën e posaçme datë 17.11.2001, nënshkruar nga noteri publik në shtetin e *** në datën 21.1.2005, shtetasja M. G. (C.) ka deklaruar: “*Pjesën time trashëgimore në gjitha pronat që ndodhen të regjistruara në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të qytetit Korçë apo dhe të tjerave që më vijnë në trashëgim prej trashëgimlënësve M. dhe L. C., si dhe nga xhaxhallarët G. dhe N. M. që ndodhen në qytetin e Korçës, kam dëshirë që ta kaloj në pronësi të vëllezërve V. C., G. C. dhe motrës sime A. Q.(C.)*”. Për rrjedhojë, provohet se nëna e subjektit ka përfituar 1/3 e çmimit të shitjes së tokës, pra 166.667 lekë⁷⁸, shumë e cila u paraqit në analizën financiare të rishikuar.

1.76 Në vijim, Komisioni hartoi analizën financiare të rishikuar të paraqitur në tabelën vijuese, ku konstatohet se prindërit dhe vëllai i subjektit kanë disponuar burime të ligjshme financiare vetëm në shumën 1.044.141 lekë për krijimin e depozitës në dollar, në datën 14.4.2005.

⁷⁶ Vërtetim nr. *** prot., datë 9.7.2024, lëshuar nga DRSSH Korçë.

⁷⁷ Sipas të dhënave të paraqitur në kolonën “dëshmor”, shumëzuar me muajt gjatë të cilëve është përfituar ky shpërblim.

⁷⁸ Shuma 500.000 lekë pjesëtuar me 3.

Tabela nr. 5 – Kursimet e prindërve dhe vëllait të subjektit të rivlerësimit

Përshkrimi	Shuma
Të ardhura nga pensioni i babait 1.9.1991 – mars 2005	1,030,263
Të ardhura të babait si shpërblim për vëllezërit dëshmorë 1.1.2002 – 30.4.2005	396,500
Të ardhura nga pensioni i nënës 1.9.1991 – mars 2005	737,076
Të ardhura nga pagat e vëllait 1991 – prill 1996	254,829
Të ardhura të nënës nga shitja e dyqanit	166,667
a) Total të ardhura	2,585,335
Shpenzime jetese, prindërit	1,464,745
Shpenzime jetese, vëllai	76,449
b) Total shpenzime dhe pasuri	1,541,194
Diferenca (a-b)	1,044,141

1.77 Sa më lart, Komisioni paraqiti në analizën financiare të vitit 2008, në zërin “Të ardhura subjekti të trashëguara nga babai”, një shumë totale prej 1.728.551 lekësh, të përbërë nga: (i) shuma 1.044.141 lekë, burimet e ligjshme financiare të rezultuara nga analiza financiare e rishikuar për depozitim të shumës 30.000 USD; (ii) shuma 419.450 lekë, ekuivalenti i shtesës së depozitës prej 5.000 USD; (iii) shuma 264.960 lekë, interesat bankarë të depozitës (ekuivalenti i 3.158,42 USD)

1.78 Në përfundim të vlerësimit të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, nga analiza financiare e rishikuar rezulton se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme në shumën -1.082.962 lekë për kryerjen e investimit.

Tabela nr. 6 – Analiza financiare e vitit 2008

Përshkrimi	Viti 2008
Shtëpi banimi 2 kate dhe bodrum, rruga “****” nr.***	5,528,891
Shtim/pakësim likuiditete <i>cash</i>	165,950
Shtim/pakësim likuiditete bankë	220,873
Total pasuri	5,915,714
Kredi ABI Bank, 30.000 euro (2007 – 2008)	2,589,510
Total detyrime	2,589,510
Të ardhura të subjektit nga pagat	892,898
Të ardhura të bashkëshortit nga aktiviteti tregtar (person fizik)	400,000
Të ardhura të bashkëshortit si ekspert mekanik	20,000
Të ardhura të subjektit të trashëguara nga babai (depozita Raiffeisen Bank)	1,728,551
Të ardhura nga interesat bankarë	146,660
Total të ardhura	3,188,108
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI - INSTAT	409,860
Shpenzime për pagesën e kredisë	447,204
Shpenzime shkollimi për vajzën	61,400
Shpenzime për udhëtime nga sistemi TIMS	26,402
Total shpenzime	944,866
Balanca e fondeve (të ardhura + detyrime - pasuri - shpenzime)	-1,082,962

1.79 Në kushtet që mungesa e burimeve të ligjshme në shumën -1.082.962 lekë për kryerjen e investimit është rezultat i drejtpërdrejtë i mosjustifikimit plotësisht me burime financiare të ligjshme nga ana e babit të depozitës bankare të trashëguar nga subjekti, Komisioni çmon të analizojë edhe rrethanat në vijim:

1.80 Nga hetimi administrativ rezulton se subjekti është shkëputur nga familja e saj e origjinës që në vitin 1988 kur është martuar dhe pas martesës figuron në përbërjen familjare të shtetasit P. Ç. (babai i bashkëshortit). Në vijim, në periudhën 26.12.1990 – 11.8.2014, subjekti figuron në përbërje familjare më vete bashkë me bashkëshortin dhe vajzën e saj⁷⁹.

1.81 Gjithashtu, rezulton se subjekti është bërë përfituese e ½ pjesë të shumës prej 38.128,51 USD – që babai i saj i kishte të depozituara në Raiffeisen Bank pas vdekjes së tij, nëpërmjet dëshmisë së trashëgimisë.

1.82 Më tej, nga hetimi administrativ nuk u konstatuan fakte apo rrethana që ngrenë dyshime të arsyeshme që depozitimi i shumës 30.000 USD nga babai i subjektit në datën 14.4.2005, shtesa prej 5.000 USD në datën 16.4.2007 dhe interesat neto në shumën 3.128 USD, janë pasuri e subjektit.

1.83 Në këto kushte, trupi gjykues i Komisionit çmon se mungesa e evidentuar gjatë hetimit administrativ e të ardhurave të ligjshme të babait të subjektit për kryerjen e depozitimit prej 30.000 USD në datën 14.4.2005, sipas standardit të përcaktuar nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, nuk mund t'i atribuohet subjektit si fakt determinues në favor të një konkluzioni për fshehje të pasurisë, në mungesë të gjetjeve të tjera për një marrëdhënie të subjektit të rivlerësimit me pasurinë objekt kontrolli, të atillë që të mund ta vendoste atë në pozitën e pronarit *de facto*.

1.84 Në përfundim, Komisioni vlerëson se deklarimi i subjektit për ndërtimin dhe mobilimin e banesës në Korçë është i saktë në përputhje me ligjin me burime të ligjshme financiare, duke u gjendur në kushtet e shkronjës “a” të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

2. Repart mekanik në bashkëpronësi të bashkëshortit të subjektit dhe vëllait të tij, me vlerë 10.000 USD

2.1 Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Një repart mekanik, axhusteri- ofiçinë në bashkëpronësi të bashkëshortit K. Ç. dhe vëllait të tij R. Ç., krijuar në vitin 2004, e ndodhur në një ambient marrë me qira në qytetin e Korçës, rruga “****” Lagjja Nr. ****, në vlerën 10.000 dollarë. Pjesa takuese: 50%*”. Si burim krijimi ka deklaruar të ardhurat në vite nga puna e saj dhe e bashkëshortit. Për vërtetimin e deklarimeve subjekti ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues⁸⁰.

2.2 Në DIPP/2004, subjekti ka deklaruar: “*Një repart mekanik i marrë me qira, në të cilin zotëron bashkëshorti makina metalprerëse. Me vlerë 10.000 USD. Pjesa 50%. Datë krijimi 11.2.2004*”. Në seksionin “Informacion konfidencial”, subjekti ka deklaruar: “*R. Ç.. Vëllai i bashkëshortit. Repart mekanik rr. “****”, Korçë*”. Subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të shumës 5.000 USD, sipas parashikimeve të nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003.

2.3 Në procesverbalin e datës 24.2.2016 të ILDKPKI-së, subjekti ka deklaruar: “*...bashkëshorti së bashku me vëllain e tij kanë aktivitet axhusteri, të cilin e kanë hapur në vitin 2004. Secili ka paguar 5.000 USD për blerjen e këtyre pajisjeve. Ky aktivitet ushtrohet në qytetin e Korçës.*”

⁷⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 22.5.2024, e DPGJC-së.

⁸⁰ Certifikatë regjistrimi pranë Bashkisë Korçë si biznes i vogël, lëshuar për shtetasit R. Ç. dhe K. Ç.; kontratë qiraje nr. ***, datë 12.2.2004; kontratë qiraje nr. ***, datë 3.2.2007; kontratë qiraje nr. ***, datë 18.3.2008; kontratë qiraje nr. ***, datë 5.3.2013; certifikatë për vërtetim pronësie datë 4.7.2008, e pasurisë nr. ***, lloji truall me sip. 990 m², nga kjo ndërtesë me sip. 437 m², ndodhur në Korçë, Ish-Ndërmarrja e Qilimave, në emër të shtetasit K. C..

Këtë aktivitet e ushtrojnë dhe aktualisht, pra që nga viti 2004 dhe në vazhdimësi. Burimi për pagesën e vlerës 5.000 \$ është nga pagat tona”.

2.4 Referuar dokumentacionit të paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting*, administruar nga faqja zyrtare e QKB-së⁸¹ dhe dokumentacioni i administruar nga DPT-ja⁸², rezulton se bashkëshorti i subjektit K. Ç. dhe shtetasi R. Ç. janë regjistruar në datën 13.2.2004 si person tregtar fizik me NUIS ***, me fushë veprimtarie “axhusteri”.

2.5 Me anë të pyetësorit nr. 1, subjektit iu kërkua që të paraqesë dokumentacion justifikues të blerjes së pajisjeve për ushtrimin e aktivitetit “axhusteri” në vitin 2004 nga bashkëshorti i saj dhe vëllai i tij. Në përgjigje⁸³, subjekti deklaroi se me kontratën e shitjes të datës 28.1.1997 shtetasi N. Gj. e R. Ç. kanë blerë nga ndërmarrja e Fabrikës së *** Korçë dhe AKP-ja repartin e ofiçinës së Fabrikës së *** në vlerën 1.990.460 lekë. Kjo ofiçinë, sqaroi subjekti, është ndarë me marrëveshje midis shtetasve N. Gj. dhe R. Ç., ku ky i fundit ka marrë makineritë dhe pajisjet në vlerën 1.018.560 lekë. Më pas, në vitin 2004, vijoi subjekti, shtetasi R. Ç. dhe vëllai i tij K. Ç. kanë bërë marrëveshje për të ngritur një repart axhusteri-ofiçinë me këto pajisje e makineri dhe shtetasi K. Ç. i ka dhënë shumën prej 5.000 USD vëllait të tij R. Ç.. Për vërtetimin e deklaramit subjekti ka paraqitur dokumentacionin justifikues⁸⁴.

2.6 Sa më lart, Komisioni konstaton se provohet blerja e pajisjeve nga ana e shtetasit R. Ç./vëllai i bashkëshortit të subjektit, por nuk konstatohet ndonjë dokument që vërteton deklaramin për dhënien e shumës 5.000 USD këtij shtetasi nga bashkëshorti i subjektit. Pavarësisht kësaj, duke marrë në konsideratë marrëdhënien e posaçme⁸⁵ ndërmjet vëllezërve, Komisioni pasqyroj në analizën financiare shumën 5.000 USD si shpenzim në vitin 2004, bazuar në deklaramin e subjektit.

2.7 Për sa i përket vendndodhjes së ushtrimit të aktivitetit tregtar, konstatohet se ndërmjet shtetasit K. C. dhe shtetasit K. Ç. është lidhur kontrata e qirasë nr. ***, datë 12.2.2004, ku pala qiradhënëse K. C. i ka dhënë me qira qiramarrësit K. Ç. një ambient për punime mekanike të ndodhur në rrugën “****” nr. ***, me sipërfaqe të ndërtuar 70 m², për ta përdorur për prodhime mekanike për një periudhë 3-vjeçare, me qira mujore 7.000 lekë. Në vijim, palët kanë rinovuar disa herë kontratën e qirasë⁸⁶.

2.8 Bashkëlidhur kontratave të qirasë gjendet certifikata e pronësisë së pasurisë nr. ***, z. k. ***, me sipërfaqe totale 990 m², nga të cilat 437 m² ndërtesë, në pronësi të shtetasit K. N. C..

2.9 Komisioni administroi nga ASHK Korçë⁸⁷ dokumentacionin e regjistrimit të pasurisë nr. ***, z. k. ***, Korçë, në pronësi të shtetasit K. C., dhe nuk rezultoi që bashkëshorti i subjektit të kishte apo të ketë pasur të drejta pronësie mbi këtë pasuri.

⁸¹ <https://qkb.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-tregtar/kerko-per-subjekt/>

⁸² Shkresë nr. *** prot., datë 29.7.2021.

⁸³ Email datë 13.5.2024.

⁸⁴ Kontratë shitblerjeje datë 28.1.1997; akt dorëzimi datë 28.1.1997; autorizim për blerje objekti datë 20.1.1997; gjendja faktike e mjeteve kryesore dhe vlerësimi i tyre në kohën e përfundimit të vlerësimit; fletë inventarizimi për mallrat e materialet.

⁸⁵ Kodi i Procedurës Civile, neni 233: “...lejohej prova me dëshmitarë: ç) kur për shkak të rrethanave në të cilat është kryer veprimi juridik ose të marrëdhënive të posaçme të palëve, nuk ka qenë e mundur të merrej prova me shkresë”.

⁸⁶ Konkretisht: (i) kontratë qiraje nr. ***, datë 3.2.2007, ku parashikohet dhënia me qira e pasurisë nr. ***, z. k. ***, rruga “****”, Korçë, me sip. 140 m², për një periudhë 3-vjeçare kundrejt shumës 7.000 lekë/muaj; (ii) kontratë qiraje nr. ***, datë 18.3.2008, ku parashikohet dhënia me qira e pasurisë së mësipërme për një periudhë 5-vjeçare kundrejt shumës 35.000 lekë/muaj; (iii) kontratë qiraje nr. ***, datë 5.3.2013, ku parashikohet dhënia me qira për një periudhë 5-vjeçare e pasurisë së mësipërme kundrejt shumës 35.000 lekë/muaj.

⁸⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 13.3.2024.

2.10 Komisioni hetoi lidhur me konfliktin e interesit të subjektit me shtetasin K. C. dhe rezultoi që subjekti nuk ishte në kushtet e konfliktit të interesit⁸⁸.

2.11 Sa më lart, Komisioni konstaton se aktiviteti tregtar është zhvilluar në ambient të marrë me qira.

2.12 Për sa i përket të ardhurave të realizuara nga ky aktivitet tregtar, në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar se për periudhën 2004 e në vazhdim shuma e të ardhurave neto nga reparti axhusteri-ofiçinë për bashkëshortin, pra 50% e tyre, ka qenë në total 7.435.183 lekë (për vitin 2004 në vlerën 1.000.000 lekë, vit i cili nuk deklarohet; për vitet 2005 – 2006 – 2007 të ardhurat kanë qenë 2.400.000 lekë; për vitet 2008 – 2016 në Drejtorinë e Tatimeve Korçë, sipas deklaramit të të ardhurave TABV – i cili ka filluar në vitin 2008 – të ardhurat kanë qenë në masën 4.035.183 lekë).

2.13 Nga analizimi i deklaratave periodike vjetore konstatohet se subjekti ka deklaruar të ardhura nga aktiviteti tregtar përgjatë periudhës 2004 – 2016, në një shumë totale prej 6.784.842 lekësh⁸⁹, e cila konfirmohet edhe nga deklarimi i subjektit në pyetësorin standard.

2.14 DRT Korçë⁹⁰ bën me dije se subjekti tregtar ka deklaruar xhiro në shumën 800.000 lekë gjatë vitit 2005 dhe në shumën 1.600.000 lekë gjatë vitit 2006. Ndërsa, më tej, ka deklaruar ndër vite fitim, konkretisht: në vitin 2008 shumën 800.000 lekë; në vitin 2009 shumën 888.000 lekë; në vitin 2010 shumën 888.007 lekë; në vitin 2011 shumën 905.904 lekë; në vitin 2012 shumën 914.866 lekë; në vitin 2013 shumën 937.889 lekë; në vitin 2014 shumën 780.585 lekë; në vitin 2015 shumën 864.865 lekë; në vitin 2016 shumën 1.100.250 lekë.

2.15 Gjithashtu, DRT Korçë⁹¹ konfirmon se për vitet 2004 – 2007 subjekti ka likuiduar tatimin e thjeshtuar të fitimit sipas llojit të veprimtarisë dhe xhiros së parashikuar.

2.16 Bashkia Korçë⁹² bën me dije se subjekti “R. Ç. & K. Ç.”, me NUIS ***, është i regjistruar dhe ka likuiduar taksat dhe tarifat lokale deri në vitin 2017.

2.17 Sa më lart, Komisioni konstaton se për vitin 2004 dhe 2007 nuk disponohet informacion për qarkullimin apo fitimin. Ndërsa për vitet 2005 dhe 2006 disponohet informacion vetëm mbi qarkullimin vjetor (dhe jo fitimin e realizuar).

2.18 Në përgjigje të pyetësorit nr. 1⁹³, subjekti shpjegoi dhe paraqiti dokumentacion për vitet 2004, 2005, 2006 dhe 2007, si në vijim:

2.18.1 Në lidhje me vitin 2004, subjekti deklaroi se për këtë vit qarkullimi ka qenë në shumën 2.146.100 lekë dhe shpenzimet në shumën 215.556 lekë dhe, për rrjedhojë, fitimi i realizuar ka qenë në shumën 1.930.544 lekë.

⁸⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 8.3.2024.

⁸⁹ DIPP/2004: të ardhura nga reparti mekanik nga puna e bashkëshortit, 1.000.000 lekë; DIPP/2005: të ardhura nga puna e bashkëshortit si bashkëpronar në repartin e axhusterisë Korçë, 400.000 lekë; DIPP/2006: të ardhura nga puna e bashkëshortit si bashkëpronar në repartin e axhusterisë Korçë, 800.000 lekë; DIPP/2007: të ardhura nga puna e bashkëshortit, 800.000 lekë; DIPP/2008: të ardhura nga puna e bashkëshortit, 400.000 lekë; DIPP/2009: të ardhura nga puna e bashkëshortit, 400.000 lekë; DIPP/2010: të ardhura nga puna e bashkëshortit, 400.000 lekë; DIPP/2011: të ardhura nga puna e bashkëshortit, 400.000 lekë; DIPP/2012: të ardhura nga puna e bashkëshortit, 407.500 lekë; DIPP/2013: të ardhura nga puna e bashkëshortit, 422.050 lekë; DIPP/2014: të ardhura nga puna e bashkëshortit, 390.292 lekë; DIPP/2015: të ardhura nga puna e bashkëshortit, 419.900 lekë; DIPP/2016: të ardhura nga puna e bashkëshortit, 545.100 lekë.

⁹⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 17.8.2017, drejtuar ILDKPKI-së.

⁹¹ Shkresë nr. ***, datë 16.1.2017, drejtuar subjektit (paraqitur në deklaratën *Vetting*).

⁹² Shkresë nr. datë 17.8.2017, drejtuar ILDKPKI-së.

⁹³ Përgjigje nr. *** prot., datë 14.5.2024.

Për të provuar deklaramet e saj, subjekti paraqiti: (i) kopje të faturave të thjeshta tatimore për periudhën 17.2.2004 – 17.12.2004, të pajisura me numër serial, shuma totale e të cilave rezulton të jetë 2.146.100 lekë; (ii) kopje të pagesave për tatimin e thjeshtuar të fitimit dhe taksave lokale (përfshirë komisionet bankare), në shumën totale 29.100 lekë⁹⁴; (iii) kopje të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore (përfshirë komisionet bankare), në shumën totale 102.456 lekë⁹⁵; (iv) kontratën e qirasë, sipas së cilës shpenzimi vjetor për pagesën e qirasë ka qenë 84.000 lekë⁹⁶.

2.18.2 Në lidhje me vitet 2005 dhe 2006, subjekti deklaroi se informacioni i DRT-së Korçë në lidhje me deklarin për vitin 2005 të shumës 800.000 lekë dhe deklarin për vitin 2006 të shumës 1.600.000 lekë, i përket fitimit dhe jo xhiros.

Për të provuar deklaramet e saj, subjekti paraqiti në formë tabelare listën e faturave të shitjes për vitin 2005, me një shumë totale prej 2.009.100 lekësh dhe listën e faturave të shitjes për vitin 2005, me një shumë totale prej 2.145.250 lekësh, por nuk paraqiti dokumentacion mbështetës.

2.18.3 Në lidhje me vitin 2007, subjekti deklaroi se për këtë vit qarkullimi ka qenë në shumën 1.986.000 lekë dhe shpenzimet në shumën 219.162 lekë e, për rrjedhojë, fitimi i realizuar ka qenë në shumën 1.786.838 lekë.

Për të provuar deklaramet e saj, subjekti paraqiti: (i) kopje të faturave të thjeshta tatimore për periudhën 4.1.2007 – 22.12.2007, të pajisura me numër serial, shuma totale e të cilave rezulton të jetë 1.986.000 lekë; (ii) njoftim-vlerësimin tatimor nga Bashkia Korçë, datë 6.4.2007, për përllogaritjen e detyrimeve tatimore për vitin 2007; (iii) kopje të pagesave për tatimin e thjeshtuar të fitimit dhe taksave lokale (përfshirë komisionet bankare), në shumën totale 29.100 lekë⁹⁷; (iv) kopje të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore (përfshirë komisionet bankare), në shumën totale 105.212 lekë⁹⁸; (v) kontratën e qirasë, sipas së cilës shpenzimi vjetor për pagesën e qirasë ka qenë 84.000 lekë⁹⁹; (vi) informacionin e përcjellë nga Bashkia Korçë¹⁰⁰, ku bëhet me dije se taksa vendore për vitin 2007 është llogaritur mbi qarkullimin vjetor të parashikuar 0-2.000.000 lekë dhe është paguar sipas kësteve respektive; (vii) kopje të pagesës për regjistrim në ISHP¹⁰¹.

2.19 Pas analizimit të dokumentacionit të paraqitur, Komisioni vëren se:

2.19.1 Lidhur me faturat e thjeshta tatimore të paraqitura për vitet 2004 dhe 2007, konstatohet se përdorimi i tyre është në përputhje me parashikimet e udhëzimit nr. 2, datë 11.2.2002, “Për tatimin mbi biznesin e vogël”: “[...] *Fatura e thjeshtë tatimore, e cila lëshohet vetëm nga tatimpaguesit e biznesit të vogël, të cilët shesin mallra, punime apo shërbime për klientë të cilët*

⁹⁴ (i) Kopje të pagesës së taksave lokale për vitin 2004, datë 12.2.2004, shuma 5.500 lekë; (ii) kopje të mandatit bankar për tatimin e thjeshtuar të fitimit, datë 4.3.2004, shuma 9.300 lekë, (iii) kopje të mandatit bankar për tatimin e thjeshtuar të fitimit, datë 14.9.2004, shuma 14.300 lekë.

⁹⁵ Kopje të mandateve bankare për pagesën e sigurimeve shoqërore për 4 tremujorë (datë 12.2.2004 – shuma 24.424 lekë; datë 11.5.2004 – shuma 24.424 lekë; datë 17.8.2004 – shuma 24.424 lekë; datë 6.12.2004 – shuma 29.184 lekë)

⁹⁶ Nr. ***, datë 3.2.2007.

⁹⁷ (i) Kopje të pagesës së taksave lokale për vitin 2007, në shumën 8.500 lekë, datë 11.3.2007, (ii) katër mandate bankare për pagesën e taksave vendore (datë 12.4.2007 – shuma 5.150 lekë; datë 11.7.2007 – shuma 5.150 lekë, datë 17.10.2007 – shuma 5.150 lekë; datë 6.12.2007 – shuma 5.150 lekë).

⁹⁸ Kopje të dokumentacionit për pagesën e sigurimeve shoqërore për 4 tremujorë (datë 12.4.2007 – shuma 26.328 lekë; datë 11.7.2007 – shuma 26.328 lekë; datë 17.10.2007 – shuma 26.178 lekë; datë 16.1.2008 – shuma 26.378 lekë).

⁹⁹ Nr. ***, datë 3.2.2007.

¹⁰⁰ Kthim përgjigjeje e Bashkisë Korçë nr. *** prot., datë 10.5.2024.

¹⁰¹ Mandatarkëtim nr. ***, datë 21.5.2007, shuma 1.000 lekë.

nuk janë konsumatorë finalë të mallit, punimit apo shërbimit, por i kryejnë këto blerje për qëllim përpunimi apo rishitje, pra janë subjekte të regjistruara për tatime. Në këto raste, tatimpaguesit e biznesit të vogël, krahas kuponit apo dëftesës tatimore, do të lëshojnë edhe faturë të thjeshtë tatimore, e cila ka përmbajtjen sipas modelit nr. 4, bashkëngjitur këtij udhëzimi. Prodhimi dhe sigurimi nga tatimpaguesit e biznesit të vogël të kësaj fature është i lirë. Çdo fillim viti tatimpaguesi duhet të validojë (vulosë dhe sekretojë) në degën e tatimeve të rrethit përkatës një numër faturash, të cilat të përmbushin nevojat vjetore të tatimpaguesit [...]”. Për rrjedhojë, për të përcaktuar nivelin e xhiros vjetore për vitet 2004 dhe 2007, Komisioni iu referua faturave të paraqitura nga subjekti.

2.19.2 Më tej, në kushtet që subjekti ka paraqitur dokumentacion për të provuar shpenzimet e kryera, Komisioni përllogariti fitimin nga aktiviteti tregtar për vitet 2004 dhe 2007, të paraqitur në tabelën vijuese.

Tabela nr. 7 – Përllogaritja e fitimit nga aktiviteti tregtar për vitet 2004 dhe 2007

Viti	Shitje	Shpenzime			Fitim
		Qira	Taksa dhe tatime	Sigurime	
2004	2,146,100	84,000	29,100	102,456	1,930,544
2007	1,986,000	84,000	30,100	105,212	1,766,688

2.19.3 Për sa i përket fitimit të realizuar në vitet 2005 dhe 2006, në kushtet që: (i) DRT Korçë, me shkresën nr. *** prot., datë 17.8.2017, i ka bërë me dije ILDKPKI-së se shumat 800.000 lekë dhe 1.600.000 lekë i përkasin xhiros dhe jo fitimit, sikurse deklaroi subjekti; (ii) subjekti nuk paraqiti dokumentacion justifikues për të mbështetur deklaratimet e saj lidhur me qarkullimin e viteve 2005 dhe 2006 – Komisioni përllogariti fitimin për vitet 2005 dhe 2006, duke u bazuar në marzhin e fitimit të vitit paraardhës dhe pasardhës, i cili rezultoi në masën rreth 90%¹⁰². Për rrjedhojë, për vitin 2005 përllogaritet një fitim prej 720.000 lekësh¹⁰³ dhe për vitin 2006 një fitim prej 1.440.000 lekësh¹⁰⁴.

2.20 Në përfundim të analizës së mësipërme, Komisioni paraqiti në analizën financiare të ardhura nga aktiviteti tregtar për pjesën takuese të subjektit prej 50%, si në tabelën vijuese:

Tabela nr. 8 – Të ardhura nga aktiviteti tregtar, periudha 2004 – 2016

Viti	Deklarime (për pjesën takuese 50%)			Fitimi total (100%)		Pjesa takuese e fitimit të bashkëshortit (50%) - AF
	DIPP	Vetting	Pyetësi standard	Sipas përllogaritjeve	Shkresë e DRT Korçë	
2004	1,000,000	1,000,000	1,000,000	1,930,544		965,272
2005	400,000	2,400,000	400,000	720,000		360,000
2006	800,000		800,000	1,440,000		720,000
2007	800,000		800,000	1,766,688		883,344
2008	400,000	4,035,183	400,000		800,000	400,000
2009	400,000		444,000		888,000	444,000
2010	400,000		444,003		888,007	444,004
2011	400,000		452,952		905,904	452,952
2012	407,500		457,433		914,866	457,433
2013	422,050		468,944		937,889	468,945

¹⁰² Viti 2004: 1.930.544 lekë (fitim)/2.146.100 lekë (xhiro) = 90%; viti 2007: 1.766.688 lekë (fitim)/1.986.000 lekë (xhiro) = 89%.

¹⁰³ Xhiro 800.000 lekë x 90%.

¹⁰⁴ Xhiro 1.600.000 lekë x 90%.

2014	390,292		390,292		780,585	390,293
2015	419,900		432,432		864,865	432,433
2016	545,100		545,125		1,090,250	545,125
Total	6,784,842	7,435,183	7,035,181			6,963,799

2.21 Në vijim, Komisioni kreu analizën financiare për pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur. Në kushtet që mungon dokumentacioni për të përcaktuar datën e saktë të pagesës së shumës 5.000 USD nga ana e bashkëshortit, si dhe në kushtet që subjekti ka deklaruar një gjendje *cash* prej 20.000 USD në fund të vitit 2003, Komisioni kreu analizën financiare për të gjithë vitin kalendarik 2004.

2.22 Në këtë analizë u konsideruan: (i) blerja e makinerive në shumën 5.000 USD¹⁰⁵; (ii) shtimi i kursimeve në shumën 7.000 USD¹⁰⁶; (iii) të ardhurat nga paga e subjektit¹⁰⁷; (iv) të ardhurat e bashkëshortit të subjektit nga aktiviteti tregtar si person fizik¹⁰⁸; (v) shpenzimet e jetese sipas ILDKPKI - INSTAT¹⁰⁹; (vi) shpenzimet e shkollimit për vajzën¹¹⁰; (vii) shpenzimet për udhëtime nga sistemi TIMS.

Tabela nr. 9 – Analiza financiare e vitit 2004

Përshkrimi	Shuma
Blerja e pajisjeve (5.000 USD)	513,900
Shtim likuiditete <i>cash</i> (7.000 USD)	719,460
Shtim/pakësim likuiditete në bankë	0
Total pasuri	1,233,360
Të ardhura të subjektit nga pagat	924,353
Të ardhura të bashkëshortit nga aktiviteti tregtar (person fizik)	965,272
Total të ardhura	1,889,625
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI - INSTAT	281,592
Shpenzime shkollimi për vajzën	35,000
Shpenzime për udhëtime nga sistemi TIMS	22,899
Total shpenzime	339,491
Balanca e fondeve (të ardhura - pasuri - shpenzime)	316,774

2.23 Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme financiare për blerjen e makinerive për repartin mekanik (5.000 USD), shtesën e kursimeve dhe kryerjen e shpenzimeve në vitin 2004 e, për pasojë, deklarimi i subjektit është i saktë në përputhje me ligjin me burime të ligjshme financiare, duke u gjendur në kushtet e shkronjës “a” të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

3. Depozitë në vlerën 20.000 USD në ABI Bank

3.1 Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Depozitë me vlerë 20.000 dollarë, aktualisht ndodhur në ABI Bank, në emrin tim dhe të bashkëshortit*”. Si burim krijimi

¹⁰⁵ Vlerësuar me kursin mesatar të këmbimit për vitin 2004, bazuar në të dhënat e Bankës së Shqipërisë.

¹⁰⁶ Vlerësuar me kursin mesatar të këmbimit për vitin 2004, bazuar në të dhënat e Bankës së Shqipërisë.

¹⁰⁷ Vërtetim datë 11.1.2017 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

¹⁰⁸ Trajtuar në paragrafët 2.14 - 2.22 të relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht.

¹⁰⁹ Bazuar në shkresën e ILDKPKI-së nr. *** prot., datë 4.3.2019.

¹¹⁰ Vërtetim nr. *** prot., datë 21.12.2020, kolegji “****” (paraqitur në pyetësin standard).

deklaron të ardhurat ndër vite nga puna e saj dhe e bashkëshortit. Për vërtetimin e deklarimeve, subjekti ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues¹¹¹.

Kronologjia e krijimit të depozitës

3.2 Bazuar në dokumentacionin e administruar nga hetimi, Komisioni analizoi kronologjinë e krijimit të kësaj depozite bankare, si dhe deklaratimet e subjektit në deklaratat periodike vjetore.

3.3 Viti 2005 – Nga hetimi¹¹² rezultoi se në datën 23.2.2005 subjekti dhe bashkëshorti kanë lidhur një kontratë depozite me afat me Raiffeisen Bank, në shumën 30.000 USD.

3.4 Nga analizimi i deklarimeve vjetore rezulton se shuma 30.000 USD është krijuar gjatë periudhës 1992 – 2005, si në vijim: (i) në DIPP/2003, subjekti ka deklaruar gjendje *cash* 20.000 USD, me burim shitjen e aksioneve të shoqërisë “****” sh.p.k., nga puna e bashkëshortit dhe kursime nga paga; (ii) në DIPP/2004, subjekti ka deklaruar gjendje *cash* 7.000 USD; (iii) në DIPP/2005, subjekti ka deklaruar dollarë *cash* për vitin 2005, të cilat së bashku me shumën e deklaruara në dy deklaratimet e viteve të mëparshme janë depozituar në Raiffeisen Bank, dega Korçë, në vlerën 3.000 USD.

3.5 Viti 2006 – Në datën 27.2.2006, pas maturimit të depozitës pranë Raiffeisen Bank, është kryer një tërheqje në shumën 30.660,69 USD¹¹³ dhe në të njëjtën datë janë krijuar pranë Intesa Sanpaolo Bank certifikatat e depozitave në shumën totale 28.852,56 USD dhe interesa në shumën 1.147,44 USD¹¹⁴.

3.6 Në DIPP/2006, subjekti ka deklaruar mbylljen dhe tërheqjen e depozitës pranë Raiffeisen Bank dhe çeljen e kësaj depozite në Bankën Amerikane¹¹⁵ (me certifikatë depozite), si dhe interesat e fituar nga kjo e fundit në shumën 1.148 USD.

3.7 Viti 2007 – Në datën 1.7.2007, subjekti dhe bashkëshorti kanë tërhequr secili shumën 15.000 USD nga certifikatat e depozitave¹¹⁶. Në të njëjtën datë, subjekti ka depozituar shumën 35.000 USD – pra 5.000 USD më shumë seç kanë tërhequr – në llogarinë pranë Intesa Sanpaolo Bank, me përshkrimin “Irena Cunoti dep. bn ****”.

3.8 Në DIPP/2007, subjekti ka deklaruar se nga 10.000 USD *cash* gjendje në vitin 2006, shuma prej 5.000 USD u kalua në depozitën në Bankën Amerikane, e cila ishte në certifikatë dhe u kalua në depozitën rrjedhëse (në emër të subjektit dhe të bashkëshortit).

3.9 Viti 2008 – Në datën 6.3.2008, bashkëshorti i subjektit ka tërhequr shumën 36.349,76 USD¹¹⁷ nga llogaria bankare pranë Intesa Sanpaolo Bank¹¹⁸ dhe në të njëjtën datë ka depozituar

¹¹¹ Dokument i Bankës Amerikane të Investimeve datë 16.3.2016; kontrata e kushteve të përgjithshme për depozitat me afat për individë.

¹¹² Kontratë depozitë me afat midis Raiffeisen Bank dhe Irena Çunoti dhe K. Ç., administruar në dokumentacionin e përcjellë nga ILDKPKI-ja me shkresën nr. *** prot., datë 5.2.2024.

¹¹³ E përbërë nga shuma e depozituar dhe interesat neto (minus komisionet).

¹¹⁴ Lëvizje llogarie me emërtimin “*Sundry crs – cd aba*”, ku evidentohen dy depozitime, secili në shumën 14.426,28 USD, me përshkrimin “*Cash deposit Irena Cunoti P/P CD 03 amount 5.000 usd for 360 days*” dhe “*Cash deposit K. C. P/P CD 03 amount 5.000 usd for 360 days*” (administruar në dokumentacionin e përcjellë nga ILDKPKI-ja me shkresën nr. *** prot., datë 5.2.2024).

¹¹⁵ Sot Intesa Sanpaolo Bank.

¹¹⁶ Mandat tërheqje datë 1.3.2007, shuma 15.000 USD, tërhequr nga Irena Çunoti; mandat tërheqje datë 1.3.2007, shuma 15.000 USD, tërhequr nga K. Ç. (administruar në dokumentacionin e përcjellë nga ILDKPKI-ja me shkresën nr. *** prot., datë 5.2.2024).

¹¹⁷ E përbërë nga shuma e depozituar prej 35.000 USD dhe interesa në shumën 1.349,76 USD.

¹¹⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 8.4.2024, nga Intesa Sanpaolo Bank.

shumën 36.000 USD në llogarinë në emër të tij pranë Raiffeisen Bank¹¹⁹, me përshkrimin “Të ardhura nga kursimet”.

3.10 Në DIPP/2008, subjekti ka deklaruar se ka tërhequr dhe mbyllur depozitën në Bankën Amerikane dhe çeljen e kësaj depozite, së bashku me interesin e fituar, në Raiffeisen Bank.

3.11 Viti 2009 – Në datën 26.3.2009, bashkëshorti i subjektit ka tërhequr shumën 36.729 USD¹²⁰ nga llogaria bankare pranë Raiffeisen Bank, me përshkrimin “K. Ç. sa tërhequr depozitë, profesioni inxhinier, arsyeja interesi i ulët”. Më tej, në datën 25.11.2009, bashkëshorti i subjektit ka depozituar shumën 25.000 USD në llogarinë e tij pranë NBG Bank (sot ABI Bank)¹²¹.

3.12 Në DIPP/2009, subjekti ka deklaruar mbylljen e depozitës së bashku me interesin në Raiffeisen Bank në vlerën 36.720 USD dhe çeljen e dy depozitave të tjera, përkatësisht në vlerat 5.000 USD dhe 20.000 USD në NBG Bank.

3.13 Viti 2010 – Bashkëshorti i subjektit ka tërhequr nga NBG Bank në datën 1.3.2010 shumën 5.021 USD dhe në datën 1.12.2010 shumat 20.000 USD dhe 390 USD.

3.14 Në DIPP/2010, subjekti ka deklaruar mbylljen e dy depozitave së bashku me interesat përkatës në NBG Bank (të deklaruara në vitin 2009), si dhe ka deklaruar se ka gjendje *cash* shumën 25.000 USD.

3.15 Viti 2011 – Në datën 13.4.2011, bashkëshorti i subjektit ka depozituar shumën 20.000 USD në llogarinë e tij pranë Raiffeisen Bank, me përshkrimin “Derdhje në llogari kursime” dhe në të njëjtën datë është krijuar një depozitë me afat me të njëjtën shumë.

3.16 Në DIPP/2011, subjekti ka deklaruar se nga gjendja *cash* e deklaruar në vitin 2011¹²² (25.000 USD) u çel një depozitë në Raiffeisen Bank në vlerën 20.000 USD.

3.17 Viti 2013 – Në datën 17.4.2013, pas maturimit të depozitës së krijuar në vitin 2011, bashkëshorti i subjektit ka tërhequr shumën 20.590 USD¹²³ dhe, më tej, në datën 10.7.2013 ka depozituar *cash* shumën 20.000 USD pranë NBG Bank. Në datën 11.7.2013, kjo shumë ka kaluar si depozitë me afat.

3.18 Në DIPP/2013, subjekti ka deklaruar kalimin e depozitës 20.000 USD në NBG Bank (sot ABI Bank).

3.19 Viti 2015 – Në datën 4.3.2015, pas maturimit të depozitës së krijuar në vitin 2013, bashkëshorti i subjektit ka tërhequr shumën 20.000 USD dhe, më tej, në datën 11.3.2015 ka depozituar *cash* shumën 20.000 USD pranë Credit Agricole Bank (sot ABI Bank). Në datën 11.3.2015, kjo shumë ka kaluar në depozitë me afat dhe pikërisht kjo depozitë bankare është deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting*.

3.20 Në DIPP/2015, subjekti ka deklaruar tërheqje të depozitës prej 20.000 USD nga NGB Bank dhe kalimin e kësaj shume në depozitë tek Credit Agricole Bank.

3.21 Në vijim të analizës së mësipërme, Komisioni kreu analizën financiare: (i) për periudhën 1992 – 2003, për kursimet në shumën 20.000 USD; (ii) për vitin 2004, për kursimet 7.000 USD;

¹¹⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 23.7.2021, nga Raiffeisen Bank.

¹²⁰ E përbërë nga shuma e depozituar prej 36.000 USD dhe diferenca e interesave të depozitës.

¹²¹ Shkresë nr. *** prot., datë 26.7.2021, e ABI Bank.

¹²² Duket lapsus, referenca duhet të jetë për vitin e mëparshëm, vitin 2010.

¹²³ E përbërë nga shuma e depozituar dhe interesat neto.

(iii) për periudhën 1.1.2005 – 23.2.2005¹²⁴, për shumën 3.000 USD; (iv) për vitin 2006, për kursimet në shumën 10.000 USD, nga të cilat 5.000 USD janë përdorur për shtimin e depozitës në datën 1.3.2007.

3.21.1 Analiza financiare për periudhën 1992 – 2003 (20.000 USD) – Në këtë analizë u konsideruan: (i) të ardhurat nga paga e subjektit¹²⁵; (ii) të ardhurat nga paga e bashkëshortit të subjektit¹²⁶; (iii) të ardhurat nga shitja e kuotave të shoqërisë “***” sh.p.k.¹²⁷; (iv) shpenzimet e jetesës sipas ILDKPKI - INSTAT¹²⁸; (iv) shpenzimet për blerjen e kuotave të shoqërisë “***” sh.p.k.¹²⁹; (v) blerjet dhe shpenzimet e zhdoganimit për automjetin me targë ***¹³⁰; (vi) kursimet në shumën 20.000 USD¹³¹.

Tabela nr. 10 – Analiza financiare për periudhën 1992 – 2003 (20.000 USD)

Periudha	Përshkrimi	Të ardhura	Shpenzime /pasuri	Gjendje progresive
1992-shtator 1997	Të ardhura të subjektit nga pagat	913,073		913,073
	Të ardhura të bashkëshortit nga pagat	386,750		1,299,823
	Shpenzime jetese		529,177	770,646
30.9.1997	Blerje 25% të kuotave në shoqërinë “***” (5.750 USD)		854,623	-83,976
Tetor-dhjetor 1997	Të ardhura të subjektit nga pagat	87,150		3,174
	Të ardhura të bashkëshortit nga pagat	9,653		12,827
	Shpenzime jetese		32,516	-19,689
1998-shkurt 1999	Të ardhura të subjektit nga pagat	466,269		446,580
	Të ardhura të bashkëshortit nga pagat	82,012		528,591
	Shpenzime jetese		194,008	334,583
4.3.1999	Blerje 5% të kuotave në shoqërinë “***” (1.637,5 USD)		217,018	117,565
mars-dhjetor 1999	Të ardhura të subjektit nga pagat	341,217		458,782
	Të ardhura të bashkëshortit nga pagat	64,726		523,508
	Shpenzime jetese		145,084	378,424
2000	Të ardhura të subjektit nga pagat	440,309		818,733
	Të ardhura të bashkëshortit nga pagat	85,037		903,770
	Shpenzime jetese		324,000	579,770
2001	Të ardhura të subjektit nga pagat	505,272		1,085,042
	Të ardhura të bashkëshortit nga pagat	90,579		1,175,621
	Shpenzime jetese		281,592	894,029
30.12.2001	Blerje dhe shpenzime zhdoganimi, automjet me targë ***		378,291	515,738
2002	Të ardhura të subjektit nga pagat	594,382		1,110,120
	Të ardhura të bashkëshortit nga pagat	37,278		1,147,398
	Shpenzime jetese		281,592	865,806
9.11.2002	Shitja e 28% të kuotave të shoqërisë “***” (7.000 USD)	956,690		1,822,496

¹²⁴ Data e depozitimit të totalit prej 30.000 USD.

¹²⁵ Vërtetim datë 11.1.2017 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë (të dhënat e pagës për muajin korrik 2000 u saktësuan me shkresën nr. *** prot., datë 26.4.2024, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë).

¹²⁶ Vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare të shtetasit K. Ç. (paraqitur në deklaratën *Vetting*) – Përllogaritur paga neto në përputhje me legjislacionin e kohës.

¹²⁷ Shuma 7.000 USD e vlerësuar me kursin zyrtar të këmbimit në datën 8.11.2002, sipas të dhënave të Bankës së Shqipërisë.

¹²⁸ Shpenzime jetike, të përllogaritura: (i) për periudhën 1992 – 1999, referuar arsyetimit të përdorur nga Kolegji i Posaçëm i Apelit (vendimi nr. 15-2021, datë 18.6.2021, paragrafët 21.40-21.42), 30% të të ardhurave të subjektit (pagë vjetore mbi 800 USD) dhe 66% të të ardhurave të subjektit (pagë vjetore nën 800 USD); (ii) bazuar në shkresën e ILDKPKI-së nr. *** prot., datë 4.3.2019, për periudhën 2000 – 2016 (në mungesë të të dhënave për vitin 2001 u konsiderua vlera e vitit pasardhës, ndërsa vlera për vitin 2007 është saktësuar sipas shkresës nr. *** prot., datë 27.5.2008, të INSTAT-it, drejtuar ILDKPKI-së (174.072 lekë/vit për person).

¹²⁹ Shuma 5.750 USD, vlerësuar me kursin mesatar të këmbimit për muajin shtator 1997, sipas të dhënave të Bankës së Shqipërisë dhe shuma 1.637,50 USD, vlerësuar me kursin mesatar të këmbimit për muajin tetor 1999, sipas të dhënave të Bankës së Shqipërisë.

¹³⁰ Trajtuar në pikën 7 të relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht.

¹³¹ Shuma 20.000 USD, vlerësuar: 13.000 USD me kursin zyrtar të këmbimit në datën 31.12.2003, 7.000 USD me kursin zyrtar të këmbimit në datën e shitjes së kuotave.

2003	Të ardhura të subjektit nga pagat	651,281		2,473,777
	Të ardhura të bashkëshortit nga pagat	0		2,473,777
	Shpenzime jetese		281,592	2,192,185
31.12.2003	Gjendje në dollar <i>cash</i> (20.000 USD)		2,702,850	-510,665
	TOTALI	5,711,678	6,222,343	-510,665

3.21.2 Analiza financiare për vitin 2004 (7.000 USD) – Referuar analizës financiare të kryer më lart në paragrafin 2.21, duket se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme financiare për blerjen e makinerive për reparatin mekanik, shtesën e kursimeve dhe kryerjen e shpenzimeve në vitin 2004.

3.21.3 Analiza financiare për periudhën 1.1.2005 – 23.2.2005 (3.000 USD) – Në këtë analizë u konsideruan: (i) shtesa e kursimeve prej 3.000 USD¹³²; (ii) të ardhurat nga paga e subjektit¹³³; (iii) të ardhurat e bashkëshortit të subjektit nga aktiviteti tregtar si person fizik¹³⁴ – në mënyrë përpjesëtimore për 1,8 muaj; (iv) shpenzimet e jetesës sipas ILDKPKI - INSTAT¹³⁵ – në mënyrë përpjesëtimore për 1,8 muaj.

Tabela nr. 11 – Analiza financiare për periudhën 1.1.2005 – 23.2.2005 (3.000 USD)

Përshkrimi	Shuma
Shtim likuiditetesh <i>cash</i> (3.000 USD)	291,210
Shtim/pakësim likuiditete në bankë	0
Total pasuri	291,210
Të ardhura të subjektit nga pagat	118,698
Të ardhura të bashkëshortit nga aktiviteti tregtar (person fizik)	54,000
Total të ardhura	172,698
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI - INSTAT	49,301
Total shpenzime	49,301
Balanca e fondeve (të ardhura - pasuri - shpenzime)	-167,813

3.21.4 Analiza financiare për vitin 2006 – Në këtë analizë u konsideruan: (i) shtimi i kursimeve në shumën 10.000 USD¹³⁶; (ii) pakësimi i gjendjes në llogaritë bankare¹³⁷; (iii) të ardhurat nga paga e subjektit¹³⁸; (iv) të ardhurat e subjektit nga mësimdhënia; (v) të ardhurat e bashkëshortit nga aktiviteti tregtar (person fizik)¹³⁹; (vi) të ardhurat e bashkëshortit si ekspert mekanik¹⁴⁰; (vii) të ardhurat nga interesat bankarë; (viii) shpenzimet e jetesës sipas ILDKPKI - INSTAT¹⁴¹; (ix) shpenzimet e shkollimit për vajzën¹⁴²; (x) shpenzimet për udhëtime nga sistemi TIMS.

¹³² Vlerësuar me kursin mesatar janar – shkurt 2005 (1 USD = 97,07 lekë).

¹³³ Vërtetim datë 11.1.2017 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, për llogaritë pagat e muajit janar 2005 dhe ½ e pagesës për muajin shkurt 2005.

¹³⁴ Trajtuar në paragrafët 2.13-2.21 të relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht.

¹³⁵ Bazuar në shkresën e ILDKPKI-së nr. *** prot., datë 4.3.2019.

¹³⁶ Shuma 10.000 USD, vlerësuar me kursin mesatar të këmbimit të vitit 2006 (1 USD = 98,10 lekë).

¹³⁷ Diferenca midis gjendjes së likuiditeteve bankare në datën 31.12.2016 me atë të datës 31.12.2015.

¹³⁸ Vërtetim datë 11.1.2017 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

¹³⁹ Trajtuar në paragrafët 2.13-2.21 të relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht.

¹⁴⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 17.5.2024, e Zyrës së Përmbartimit Korçë.

¹⁴¹ Bazuar në shkresën e ILDKPKI-së nr. *** prot., datë 4.3.2019.

¹⁴² Vërtetim nr. *** prot., datë 21.12.2020, kolegji “****” (paraqitur në pyetësorin standard).

Tabela nr. 12 – Analiza financiare për vitin 2006 (10.000 USD¹⁴³)

Përshkrimi	Shuma
Shtim likuiditetesh <i>cash</i> (10.000 USD)	981,000
Shtim/pakësim likuiditetesh në bankë	-184,595
Total pasuri	796,405
Të ardhura të subjektit nga pagat	919,668
Të ardhura të subjektit nga mësimdhënia	54,729
Të ardhura të bashkëshortit nga aktiviteti tregtar (person fizik)	720,000
Të ardhura të bashkëshortit si ekspert mekanik	105,000
Të ardhura nga interesat bankarë	178,359
Total të ardhura	1,977,756
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI - INSTAT	328,671
Shpenzime shkollimi për vajzën	50,000
Shpenzime për udhëtime nga sistemi TIMS	217,717
Total shpenzime	596,388
Balanca e fondeve (të ardhura - pasuri - shpenzime)	584,962

3.22 Nga faktet e analizuara më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: *Subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën -678.478 lekë për krijimin e depozitës bankare, blerjen e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve, e detajuar si në vijim: (i) mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën -510.665 lekë për krijimin e kursimeve 20.000 USD, blerjen e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve gjatë periudhës 1992 – 2003; (ii) mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën -167.813 lekë për krijimin e kursimeve prej 3.000 USD dhe kryerjen e shpenzimeve, në datën 23.2.2005.*

3.23 Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹⁴⁴, subjekti paraqiti shpjegimet e saj si vijon:

3.24 *Lidhur me konstatimin për mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën -510.665 lekë për krijimin e kursimeve 20.000 USD, blerjen e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve gjatë periudhës 1992 – 2003, subjekti parashtrori pretendimet e saj si në vijim:*

3.24.1 *Së pari*, subjekti kërkon që të kryhet saktësimi i zërit të të ardhurave, konkretisht: (i) të ardhurat e subjektit nga paga të përllogariten duke filluar që prej datës 1.9.1987; (ii) të ardhurat e subjektit nga paga për muajin dhjetor 1992 të paraqiten në shumën 680 lekë, përkundrejt shumës 380 lekë të paraqitur nga Komisioni; (iii) të ardhurat e bashkëshortit të subjektit nga paga të përllogariten duke filluar që prej datës 1.6.1985; (iv) të kryhet saktësimi i të ardhurave të bashkëshortit të subjektit nga paga për 7 muaj gjatë periudhës 1993 – 1997.

Subjekti shpjegon se, referuar përllogaritjeve të kryera nga ana e saj, të ardhurat nga paga për periudhën 1.9.1987 – 31.12.1992 kanë qenë të paktën 44.320 lekë, duke u bazuar vetëm në vërtetimet e pagave që disponon dhe duke mos konsideruar rritjet që janë krye gjatë kësaj periudhe. Subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor justifikues¹⁴⁵.

¹⁴³ Nga të cilat 5.000 USD u përdorën në vitin 2005 për të shtuar depozitën bankare.

¹⁴⁴ Email datë 15.7.2024.

¹⁴⁵ (i) Shkresë nr. *** prot., datë 26.8.1987, me lëndë “Emërim kuadri”, lëshuar nga Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Kuadrit, (ii) shkresë nr. *** prot., datë 9.9.1989, lëshuar nga Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Kuadrit.

Më tej, referuar përlllogaritjeve të kryera nga ana e subjektit, të ardhurat e bashkëshortit nga paga për periudhën 1.6.1985 – 1.9.1991 kanë qenë në shumën 53.040 lekë. Po kështu, subjekti kërkon që në analizën financiare të përfshihen edhe pagat për muajt nëntor 1993, dhjetor 1993, janar 1994, gusht – tetor 1996 dhe tetor 1997, për të cilat mungon informacioni në vërtetimet e lëshuara nga institucionet përkatëse. Subjekti shpjegon se mungesa e listëpagesave në institucionet përgjegjëse nuk mund të privojë apo zerojë të ardhurat e realizuara në këtë periudhë, prandaj paga e kësaj periudhe mund të llogaritet me VKM-në nr. 561, datë 12.8.2005, “Për përcaktimin e pagave referuese për llogaritjen e pensioneve”. Nëse shikohen muajt paraardhës dhe pasardhës të periudhave për të cilat mungojnë të dhënat, pagat kanë qenë shumë më të larta se kjo pagë referuese, sqaron subjekti. Për të mbështetur deklaratimet e saj, subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor justifikues¹⁴⁶.

Në përfundim të shpjegimeve të paraqitura, subjekti deklaroi se shuma totale e kursimeve për të dhe bashkëshortin ka qenë 59.035 lekë¹⁴⁷.

3.24.2 *Së dyti*, subjekti parashton shpjegimet e saj lidhur me të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti, në shumën 14.000 USD, gjatë periudhës që ai ka qenë ortak i shoqërisë “****” sh.p.k.

Subjekti shpjegon se qëllimi i krijimit të shoqërive tregtare është fitimi dhe se duke u nisur nga objekti i krijimit të kësaj shoqërie të licencuar nga Banka e Shqipërisë, për çdo transfertë kishte si fitim një komision të përcaktuar. Subjekti sqaron se sistemi me të cilin punohej në ato vite quhej SITA dhe se çdo transfertë e realizuar kishte kodin e saj unik, duke u shoqëruar edhe me mandatpagesë, dokumentacion i cili, në fund të vitit, arkivohej pranë Unionit Financiar, Tiranë.

Në prapësimet e saj, subjekti ka paraqitur 4 tabela, ku pasqyrohen të dhëna të aktivitetit të kryer gjatë periudhës tetor 1997 – dhjetor 2001, konkretisht: (i) numri i transaksioneve për secilin muaj; (ii) të ardhurat e realizuara në shumën totale 101.251 USD; (iii) të ardhurat e realizuara nga konvertimi i monedhave të huaja në lek, në shumën 6.551 USD; (iv) fitimi i realizuar në shumën totale 55.382 USD. Subjekti shpjegon se pjesa takuese e bashkëshortit ka qenë 28% e fitimit të realizuar (15.507 USD).

Për të provuar deklaratimet e saj, subjekti ka përcjellë informacion në formë tabelare lidhur me tregues të ndryshëm financiarë të aktivitetit të shoqërisë “****” sh.p.k.¹⁴⁸.

Subjekti sqaron se në informacionin e përcjellë ka një kolonë ku pasqyrohen pagesat për tatim-taksat sipas viteve, por nuk ka dijeni se përse ky informacion nuk është i pasqyruar në Degën e Tatim-Taksave Korçë.

Bashkëshorti, vijon subjekti, në momentin e shkëputjes nuk mund të merrte me vete dokumentacionin për të ardhurat, shpenzimet dhe fitim-humbjen e shoqërisë, sepse ky dokumentacion është pronësi e shoqërisë, e cila ka statusin e saj si person juridik. Ai ka kërkuar

¹⁴⁶ (i) Librezë pune e shtetasit K. Ç.; (ii) vërtetim “Për vjetërsi në punë për efekt pensioni”, nr. ***, datë 9.7.2024; (iii) shkresë nr. *** prot., datë 6.7.2006, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, Arkivi Shtetëror Vendor; (iv) vërtetim datë 5.7.2006, lëshuar nga Drejtoria Arsimore Rajonale Korçë.

¹⁴⁷ Referuar përlllogaritjeve të subjektit, shuma prej 59.035 lekësh përbëhet nga: (i) kursimet e subjektit në shumën 31.024 lekë (diferencë e të ardhurave në shumën 44.320 lekë me shpenzimet e jetesës për këtë periudhë në masën 30% të pagës, pra 13.296 lekë); (ii) kursimet e bashkëshortit të subjektit në shumën 18.034 lekë (diferencë e të ardhurave në shumën 53.040 lekë me shpenzimet e jetesës për këtë periudhë në masën 66% të pagës, pra 35.006 lekë); (iii) kursimet e bashkëshortit të subjektit në shumën 9.977 lekë (si diferencë e të ardhurave të bashkëshortit për muajt për të cilët mungon informacioni 29.344 lekë me shpenzimet e jetesës për këtë periudhë në masën 66% të pagës).

¹⁴⁸ (i) Dokument me emërtim “**** Aktiviteti për vitet 1997 – 2000”, 19 faqe; (ii) dokument me emërtim “**** Aktiviteti për vitet 1997 – 2001”, 9 faqe.

pranë Unionit Financiar Tiranë për t'i vënë në dispozicion dokumentacion mbi veprimtarinë e Western Union për periudhën tetor 1997 – dhjetor 2001, të gjeneruar nga shoqëria “****” Korçë, por nuk i është vënë në dispozicion asnjë informacion prej tyre.

Në përfundim, subjekti deklaron: *“Të gjitha sa kam parashkruar më sipër justifikojnë burimin e ligjshëm të të ardhurave për vlerën 20.000 USD, të deklaruar nga ana jonë gjatë periudhës 1985 – 2003, sipas pikës 3.16 dhe pikës 9.12 të konstatuar nga ana juaj”.*

3.25 Në vijim, për sa i përket konstatimit të Komisionit lidhur me mungesën e burimeve të ligjshme në shumën 167.812 lekë gjatë periudhës 1.1.2005 – 23.2.2005, subjekti kërkon që në analizën financiare, konkretisht në zërin e të ardhurave nga aktiviteti i bashkëshortit të saj për periudhën 1.1.2005 – 23.2.2005, të përfshihet edhe fatura tatimore nr. **, shuma 250.000 lekë, faturë e cila ka të bëjë me një parapagim të shoqërisë “****”, me NUIS **, në favor personit fizik “R. Ç. & K. Ç.”, me NUIS **.

Konkretisht, subjekti shpjegon se në vitin 2005 kontaktuan me shoqërinë “****” me NUIS **, e cila kishte nevojë për përzierës boje dhe subjekti tregtar “R. Ç. dhe K. Ç.” mori përsipër prodhimin e tyre. Për të pasur garanci se shoqëria “****” do të blinte përzierësit e bojës, i kërkuan një parapagim të barabartë me vlerën e një makine. Nga faturat e vëna në dispozicion, vijon subjekti, konstatohet se vlera e shitjes se një mikseri boje ka qenë 250.000 lekë. Fatura tatimore nr.120796, e cila mungon dhe ka qenë midis datave 10.2.2005 dhe 17.2.2005 në tabelën e xhiros të vitit 2005 – pasqyruar në përgjigjet e pyetësorit nr. 1, datë 11.5.2024, faqe 12 – ka qenë fatura e parapagimit për shoqërinë “****”, me NUIS **, në vlerën 250.000 lekë, shpjegon subjekti.

3.25.1 Për sa i përket shpenzimeve për blerjen e automjetit me targë ** në vitin 2001 – si një element përbërës i analizës financiare për periudhën 1991 – 2003 – subjekti sqaron se nuk ka mundur të gjejë dokumentacion shtesë përveç atyre që ka vënë në dispozicion në pyetësorët e mëparshëm, pasi shtetasi A. D. aktualisht është në Gjermani. Më tej, shpjegon se pavarësisht se nuk ka mundur të disponojë dokumente financiare për të ardhurat e tij, ai e kishte mundësinë financiare për të blerë një automjet i cili ka kushtuar 3.500 marka gjermane, shumë e cila e konvertuar me kursin e ditës së dhurimit, 30.11.2002, është në vlerën 222.705 lekë.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

3.26 Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore – arsyeton si vijon:

3.27 *Së pari*, lidhur me konstatimin për mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën -510.665 lekë për krijimin e kursimeve 20.000 USD, blerjen e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve, Komisioni analizoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit si në vijim:

3.27.1 Lidhur me pretendimin e subjektit për të përfshirë në analizën financiare të ardhurat e realizuara prej saj duke filluar nga data 1.9.1987 dhe të ardhurat e realizuara nga bashkëshorti duke filluar nga data 1.6.1985, Komisioni çmon se ky pretendim është i pabazuar, duke iu referuar vendimit nr. 15-2021 (JR), datë 18.6.2021, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i cili në

funksion të një qëndrimi orientues, sipas parashikimit të nenit 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, parashtron: “[...] *periudha kohore para ndryshimeve demokratike në vend që përkon me vitet 1991 – 1992, nuk mund të jetë si rregull një periudhë e cila mund të llogaritet në funksion të përcaktimit të ndonjë vlere të kursyer, për shkak të një realiteti të jetuar që ka provuar se monedha zyrtare, leku, në këtë periudhë pësoi një inflacion në nivele shumë të larta e të jashtëzakonshëm, produkt i ndryshimeve politike, sociale dhe ekonomike në vend që e bën të pabesueshme dhe të palogjikshme mundësinë potenciale të kursimit nga të ardhurat nga puna në këto periudha. Për pasojë, pasi monedha vendase hyri në një fazë stabiliteti, pas viteve 1992 – 1993, mundësia për të kursyer mund të konsiderohet si opsion.. [...]*”. Për rrjedhojë, në analizën financiare nuk u përfshinë të ardhurat e realizuara përpara vitit 1991.

3.27.2 Në vijim, Komisioni çmoi t’i pranojë shpjegimet e subjektit lidhur me përlllogaritjen e pagave të bashkëshortit për muajt për të cilët mungonin listëpagesat në DRSSH, konkretisht për periudhat nëntor – dhjetor 1993, janar 1994, gusht – tetor 1996 dhe 1 – 24 tetor 1997, pasi në librezën e punës u konstatua një periudhë e pandërprerë punësimi përgjatë periudhës ku përfshihen këta muaj. Për përlllogaritjen e tyre, Komisioni iu referua pagës së muajit më të afërt¹⁴⁹, nga ku rezultoi një shumë totale të ardhurash nga paga prej 48.911 lekësh.

3.27.3 Më tej, Komisioni përlllogariti edhe: (i) pagat e subjektit për periudhën 1.1.1991 – 15.12.1992, duke saktësuar edhe diferencën e pallogaritur për muajin dhjetor 1992, referuar dokumentacionit të paraqitur nga subjekti gjatë prapësimeve, në shumën totale 16.420 lekë; (ii) pagat neto të bashkëshortit për periudhën shtator – dhjetor 1991, referuar dokumentacionit të administruar¹⁵⁰, në shumën totale 4.918 lekë.

3.27.4 Lidhur me të ardhurat në shumën 14.000 USD, të përfituara nga bashkëshorti i subjektit nga veprimtaria e shoqërisë “***” sh.p.k.¹⁵¹, rezulton se DRT Korçë¹⁵² informon se nga verifikimi i kryer në regjistrat manualë, subjekti “***” sh.p.k. figuron i regjistruar në Degën e Tatimeve Korçë, me kod fiskal ***, nga viti 1997, dhe se nuk disponojnë informacion për të ardhurat e realizuara për periudhën 1997 – 2002.

3.27.5 Gjithashtu, në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti nuk depozitoi dokumentacion ligjor që justifikon të ardhurat e realizuara nga bashkëshorti i saj nga shpërndarja e dividendit. Informacioni i paraqitur në formë tabelash nuk provon deklaratimet e subjektit, për sa kohë të dhënat e paraqitura nuk janë konfirmuar nga institucionet përkatëse.

3.27.6 Megjithatë, edhe sikur të pranohet që bashkëshorti i subjektit ka realizuar të ardhura në shumën 14.000 USD nga aktiviteti i shoqërisë “***” sh.p.k., në kushtet kur sipas parashikimeve të ligjit nr. 8438/1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ardhurat që rrjedhin nga fitimi i ortakut në shoqërinë tregtare merren si të ardhura të tatueshme¹⁵³ dhe nuk rezulton që shoqëria “***” sh.p.k. të ketë paguar detyrimet tatimore lidhur me shpërndarjen e fitimit ortakëve të shoqërisë,

¹⁴⁹ Për periudhën nëntor – dhjetor 1993 u konsiderua paga e muajit paraardhës (4.819 lekë/muaj); për janar 1994 u konsiderua paga e muajit pasardhës (4.776 lekë/muaj); për periudhën gusht – tetor 1996 u konsiderua paga e muajit paraardhës (8.650 lekë/muaj); për periudhën 1 – 24 tetor 1997 u konsiderua paga e muajit paraardhës, duke u përlllogaritur për 24 ditë (8.546 lekë).

¹⁵⁰ Vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare të shtetasit K. Ç., paraqitur në deklaratën *Vetting*.

¹⁵¹ Të ardhurat e bashkëshortit të subjektit nga aktiviteti i shoqërisë “***” sh.p.k. janë trajtuar në pikën 9 të vendimit.

¹⁵² Shkresë nr. *** prot., datë 16.1.2017, drejtuar subjektit (paraqitur në deklaratën *Vetting*).

¹⁵³ Neni 8: “1.Për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale, merren si të ardhura të tatueshme: ...b) të ardhurat që rrjedhin nga fitimi i ortakut apo i aksionerit në shoqërinë tregtare...”.

në periudhën 1997 – 2002, rezulton se këto të ardhura nuk plotësojnë kriterin e të ardhurës së ligjshme të parashikuar nga neni 3, pika 19¹⁵⁴ e ligjit nr. 84/2016.

3.27.7 Për rrjedhojë, të ardhurat e pretenduara në shumën 14.000 USD nuk u paraqitën në analizën financiare.

3.27.8 Për sa i përket shpenzimeve për blerjen e automjetit me targë *** në vitin 2001 – si një element përbërës i analizës financiare për periudhën 1991 – 2003 – Komisioni vlerëson se, pavarësisht se subjekti nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion justifikues, duhet të mbahen në konsideratë rrethanat në vijim: (i) kontrata e dhurimit nr. *** është nënshkruar në datën 30.11.2001, pra në kohën e dhurimit; (ii) pagesa e detyrimeve doganore është kryer nga bashkëshorti i subjektit në datën 3.12.2001; (iii) subjekti e ka deklaruar dhurimin në deklaratën e pasurisë së vitit 2003; (iv) shtetasi A. D. jeton në Gjermani që prej vitit 1990¹⁵⁵ – rrethana të cilat i krijojnë bindjen Komisionit se automjeti me targë *** i është dhuruar bashkëshortit të subjektit në vitin 2001. Për rrjedhojë, në analizën financiare nuk u paraqitën shpenzime për blerjen e automjetit, por vetëm shpenzime për pagesën e detyrimeve doganore në shumën 150.231 lekë.

3.27.9 Në përfundim, pas rishikimit të analizës financiare, rezulton se subjekti dhe personat e lidhur kanë mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën -258.720 lekë për krijimin e kursimeve 20.000 USD, blerjen e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve gjatë periudhës 1991 – 2003¹⁵⁶.

3.28 Së dyti, lidhur me konstatimin se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën -167.813 lekë, në datën 23.2.2005, Komisioni vlerëson se pretendimet e subjektit lidhur me faturën e parapagimit të lëshuar për shoqërinë “****”, në shumën 250.000 lekë, mbeten në nivel deklarativ, për sa kohë që subjekti nuk paraqiti kopje të kësaj fature.

3.28.1 Për rrjedhojë, mbetet i pandryshuar konkluzioni se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën -167.813 lekë, në datën 23.2.2005, për krijimin e kursimeve prej 3.000 USD dhe kryerjen e shpenzimeve.

3.29 Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti dhe personat e lidhur kanë mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën -426.533 lekë¹⁵⁷ për krijimin e depozitës bankare prej 20.000 USD pranë ABI Bank, blerjen e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve, duke u gjendur në kushtet e parashikuara në shkronjën “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, situatë e cila është vlerësuar në tërësi me rrethanat e çështjes që janë përcaktuese për vlerësimin e pasurive.

4. Automjet tip “Opel” me targë *, vit prodhimi 1998, në vlerën 250.000 lekë**

4.1 Në deklaratën Vetting 2017, subjekti ka deklaruar: “Një makinë veturë, tip “Opel”, prodhim i vitit 1998, me targë ***, në emrin tim, blerë me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol.,

¹⁵⁴ Ligji nr. 84/2016, neni 3: “19. “Të ardhura të ligjshme” janë të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur të tij/saj, sipas përcaktimeve të burimit të të ardhurave, të parashikuara në ligjin “Mbi tatimin mbi të ardhurat”.

¹⁵⁵ Sipas deklarimit të tij në deklaratën noteriale nr. ***, datë 13.3.2019.

¹⁵⁶ Balanca negative e paraqitur në rezultatet e hetimit u korrigjua pas këtyre saktësimeve: (i) nuk u paraqitën shpenzime për blerjen e automjetit (228.060 lekë); (ii) u shtua shuma prej 23.884 lekësh si diferencë midis të ardhurave të subjektit dhe bashkëshortit (+70.249 lekë) dhe shpenzimeve respektive të jetesës për këto të ardhura (-46.365 lekë) (-510.665 lekë + 228.060 lekë + 23.884 lekë).

¹⁵⁷ E përllogaritur si shumë e (-258.720 lekë) dhe (-167.813 lekë).

në datën 27.10.2005, në vlerën 250.000 lekë". Si burim krijimi deklarohet të ardhurat në vite nga puna e saj dhe e bashkëshortit. Për vërtetimin e deklaramëve, subjekti ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues¹⁵⁸.

4.2 Referuar dokumentacionit të paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting*, administruar edhe nga DPSHTRR-ja¹⁵⁹, konstatohet se me kontratën nr. ***, datë 27.10.2005, subjekti ka blerë nga shtetasi L. N. automjetin tip "Opel", vit prodhimi 1998, kundrejt çmimit 250.000 lekë. Ky automjet është regjistruar pranë DRSHTRR-së Korçë me targa ***.

4.3 Nga dokumentacioni i administruar konstatohet se shitësi, shtetasi L. N., e ka blerë këtë automjet në datën 19.10.2005, në shumën 1.700 euro, dhe ka paguar detyrime doganore në vlerën 146.761 lekë, pra në total ky automjet ka kushtuar rreth 356.558 lekë¹⁶⁰.

4.4 Sa më lart, konstatohet se shtetasi L. N. ia ka shitur këtë automjet subjektit 8 ditë pasi e ka blerë, me një vlerë 106.558 lekë më pak seç e ka blerë.

4.5 Në përgjigje të pyetësorit nr. 1¹⁶¹, subjekti deklarohet se *shtetasi L. N. dhe bashkëshorti i saj njihen me njëri-tjetrin, pasi kanë lidhje farefisnore. Më tej, subjekti shpjegoi se në muajin tetor 2005 shtetasi L. N. së bashku me mjetin e tij tip "Opel ***" është paraqitur tek puna e bashkëshortit të saj për ta rregulluar, pasi e kishte dëmtuar nga poshtë dhe defekti ishte i rëndë. Bashkëshorti i subjektit së bashku me vëllain e tij u munduan ta rregullonin, por L. i doli nga qejfi kjo makinë dhe kërkonte ta shiste, sqaroi subjekti. Bashkëshorti, ndonëse nuk e dinte çmimin se sa e kishte blerë L., duke parë dhe dëmtimin që kishte pësuar ky automjet, ra dakord që ta blinte në vlerën 250.000 lekë, përfundoi subjekti.*

4.6 Më pas, me kontratën e shitjes datë 9.10.2020, subjekti ia ka shitur këtë automjet shtetasit J. T., në shumën 100.000 lekë.

4.7 Komisioni hetoi lidhur me konfliktin e interesit të subjektit me shtetasin L. N. dhe rezultoi që subjekti nuk ishte në kushtet e konfliktit të interesit¹⁶².

4.8 Në vijim, Komisioni kreu analizën financiare për periudhën 24.2.2005 – 27.10.2005, për pasuritë, të ardhurat, detyrimet dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur – ku u konsideruan: (i) blerja e automjetit tip "Opel"; (ii) ndryshimi i likuiditeteve *cash*¹⁶³; (iii) ndryshimi i likuiditeteve në bankë¹⁶⁴; (iv) të ardhurat e subjektit nga pagat¹⁶⁵ dhe mësimdhënia¹⁶⁶; (v) të ardhurat e bashkëshortit të subjektit nga aktiviteti tregtar si person fizik¹⁶⁷ – në mënyrë përpjesëtimore për 8 muaj; (vi) shpenzime jetese sipas ILDKPKI - INSTAT¹⁶⁸; (vii) shpenzime shkollimi për vajzën¹⁶⁹.

¹⁵⁸ Kontratë shitjeje nr. ***, datë 27.10.2005.

¹⁵⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 29.7.2021.

¹⁶⁰ Çmimi 209.797 lekë (1.700 euro x 123,41) dhe detyrimet doganore 146.761 lekë.

¹⁶¹ Email datë 13.5.2024.

¹⁶² Shkresë nr. *** prot., datë 8.3.2024, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

¹⁶³ Pakësimi i kursimeve *cash* të mbartura në shumë 27.000 USD dhe i kursimeve 3.000 USD (analiza financiare për shumë 3.000 USD paraqitur në tabelën nr. 10).

¹⁶⁴ Diferenca midis gjendjes së likuiditeteve bankare në datën 27.10.2005 me atë të datës 23.2.2005 – e përbërë nga shtimi i gjendjes së llogarisë rrjedhëse të Raiffeisen Bank (314.014 lekë) dhe depozita (30.000 USD).

¹⁶⁵ Vërtetim datë 11.1.2017 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë – përlllogaritur ½ e pagës për shkurt 2005 dhe mars – shtator 2005.

¹⁶⁶ Vërtetim datë 24.10.2016 nga universiteti "****" – kredituar në Raiffeisen Bank datë 18.7.2005 (18.000 lekë) dhe datë 26.7.2005 (59.706 lekë).

¹⁶⁷ Trajtuar në paragrafët 2.14 - 2.22 të relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht.

¹⁶⁸ Bazuar në shkresën e ILDKPKI-së nr. ***, datë 4.3.2019 – në mënyrë përpjesëtimore për 8 muaj.

¹⁶⁹ Vërtetim nr. *** prot., datë 21.12.2020, kolegji "****" (paraqitur në pyetësorin standard).

Tabela nr. 13 – Analiza financiare për periudhën 24.2.2005 – 27.10.2005

Përshkrimi	Shuma
Automjet tip “Opel”, me targë ***, vit prodhimi 1998	250,000
Pakësim likuiditetesh <i>cash</i>	-3,713,520
Shtim/pakësim likuiditete bankë	4,027,534
Total pasuri	564,014
Të ardhura të subjektit nga pagat	586,575
Të ardhura të subjekti nga mësimdhënia	77,706
Të ardhura të bashkëshortit nga aktiviteti tregtar (person fizik)	240,000
Total të ardhura	904,281
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI - INSTAT	219,114
Shpenzime shkollimi për vajzën	35,000
Total shpenzime	254,114
Balanca e fondeve (të ardhura - pasuri - shpenzime)	86,153

4.9 Nga analiza financiare rezultoi se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme financiare për blerjen e automjetit në datën 27.10.2005.

4.10 Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme financiare për blerjen e automjetit në datën 27.10.2005, duke u gjendur në kushtet e shkronjës “a” të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

5. Automjet tip “Ford” me targë *, vit prodhimi 2000, në vlerën 250.000 lekë**

5.1 Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Një makinë autoveturë “Ford Focus”, prodhim i vitit 2000, me targë *** blerë sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.9.2012, në emër të bashkëshortit, të cilën e përdor aktualisht*”. Si burim krijimi deklaroi të ardhurat familjare. Për vërtetimin e deklarimeve, subjekti ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues¹⁷⁰.

5.2 DPSHTRR-ja¹⁷¹ konfirmon se me kontratën nr. ***, datë 27.9.2012, subjekti ka blerë nga shtetasi H. T. automjetin tip “Ford Focus”, vit prodhimi 2000, kundrejt çmimit 250.000 lekë, shumë e cila është dorëzuar jashtë zyrës noteriale. Nga dokumentacioni i administruar konstatohet se shitësi, shtetasi H. T., e ka blerë këtë automjet në datën 4.9.2012, në shumën 1.100 euro, dhe ka paguar detyrime doganore në vlerën 34.697 lekë, pra në total ky automjet ka kushtuar rreth 189.500 lekë.

5.3 Komisioni hetoi lidhur me konfliktin e interesit të subjektit me shtetasin H. T. dhe rezultoi që subjekti nuk ishte në kushtet e konfliktit të interesit¹⁷².

5.4 Në vijim, Komisioni kreu analizën financiare në datën 27.9.2012 për pasuritë, të ardhurat, detyrimet dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur, ku u konsideruan: (i) blerja e automjetit tip “Ford”; (ii) ndryshimi i likuiditeteve në bankë¹⁷³; (iii) të ardhurat e subjektit nga pagat¹⁷⁴; (iv) të ardhurat e bashkëshortit të subjektit nga aktiviteti tregtar si person

¹⁷⁰ Kontratë shitjeje nr. ***, datë 27.9.2012.

¹⁷¹ Shkresë nr. *** prot., datë 29.7.2021.

¹⁷² Shkresë nr. *** prot., datë 8.3.2024, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Juridiksioni të Përgjithshëm Korçë.

¹⁷³ Diferenca midis gjendjes së likuiditeteve bankare në datën 27.9.2012 me atë të datës 31.12.2011.

¹⁷⁴ Pagat e kredituara në llogarinë bankare të subjektit pranë Credins Bank gjatë periudhës 1.1.2012 – 27.9.2012.

fizik¹⁷⁵ – në mënyrë përpjesëtimore për 8,9 muaj; (v) dhurimi nga nëna e subjektit¹⁷⁶; (vi) të ardhurat nga shitja e automjetit me targë ***¹⁷⁷; (vii) të ardhurat nga interesat bankarë; (viii) shpenzimet e jetesës sipas ILDKPKI - INSTAT¹⁷⁸; (ix) shpenzimet e shkollimit për vajzën¹⁷⁹.

Tabela nr. 14 – Analiza financiare datë 27.9.2012

Përshkrimi	Shuma
Automjet tip “Ford Focus” me targë ***, vit prodhimi 2000	250,000
Shtim/pakësim likuiditetesh në bankë	13,556
Total pasuri	263,556
Të ardhura të subjektit nga pagat	970,459
Të ardhura të bashkëshortit nga aktiviteti tregtar (person fizik)	347,801
Dhurime nga nëna e subjektit	350,000
Të ardhura nga shitja e automjetit me targë ***	100,000
Të ardhura nga interesat bankarë	35,634
Total të ardhura	1,803,894
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI - INSTAT	313,778
Shpenzime për pagesën e kredisë (principal, interes etj.)	557,556
Shpenzime shkollimi për vajzën	278,080
Total shpenzime	1,149,414
Balanca e fondeve (të ardhura - pasuri - shpenzime)	390,923

5.5 Nga analiza financiare rezultoi se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme financiare për blerjen e automjetit me targë ***.

5.6 Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme financiare për blerjen e automjetit me targë ***, duke u gjendur në kushtet e shkronjës “a” të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

6. Gjendje cash në vlerën 3.000 USD

6.1 Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Gjendje cash në vlerën 3.000 dollarë”. Si burim krijimi deklaroi të ardhurat e punës së saj dhe të bashkëshortit.

6.2 Në deklaratat periodike vjetore, subjekti ka deklaruar: (i) në deklaratën e pasurisë së vitit 2003, gjendje cash 20.000 USD, me burim shitjen e aksioneve të shoqërisë “****” (Western Union) nga puna e bashkëshortit dhe kursime nga paga; (ii) në DIPP/2004, gjendje cash 7.000 USD¹⁸⁰; (iii) në DIPP/2005, dollarë cash për vitin 2005, të cilat së bashku me shumën e deklaruar në dy deklaratimet e viteve të mëparshme janë depozituar në Raiffeisen Bank, dega Korçë, në vlerën 3.000 USD¹⁸¹; (iv) në DIPP/2006, dollarë cash, gjendje 10.000 USD¹⁸²; (v) në DIPP/2007, pakësuar nga përdorimi dhe ndërtimi i shtëpisë të gjitha të ardhurat vjetore dhe

¹⁷⁵ Trajtuar në paragrafët 2.11 - 2.19.3 të relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht.

¹⁷⁶ Trajtuar në pikën 8 të relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht – në datën 10.9.2012, nëna e subjektit ka tërhequr shumën 350.000 lekë, me burim transfertën bankare nga Bashkia Korçë dhe në datën 13.9.2012 është lidhur kontrata e dhurimit për të njëjtën shumë.

¹⁷⁷ Kontratë nr. ***, datë 26.9.2012, blerës R. M., çmimi 100.000 lekë.

¹⁷⁸ Bazuar në shkresën e ILDKPKI-së nr. ***, datë 4.3.2019 – në mënyrë përpjesëtimore për 8,9 muaj.

¹⁷⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 2.5.2024, A. U..

¹⁸⁰ Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti deklaroi se burim kanë qenë të ardhurat nga puna e saj dhe të bashkëshortit.

¹⁸¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 5.2.2014, ILDKPKI-ja ka përcjellë një deklaratë, me shënimin “PV 2006”, datë 16.11.2007 (fax), ku subjekti ka deklaruar se në vitin 2005 i është pakësuar gjendja cash e dollarëve të deklaruar në deklaratat e vitit 2003 (pra 20.000 USD) të vitit 2004 (pra 7.000 USD) dhe të vitit 2005 (pra 3.000 USD), pasi të gjitha këto shuma të lartpërmendura (gjithsej 30.000 USD) u depozituan në vitin 2005 në Raiffeisen Bank, dega Korçë.

¹⁸² Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti deklaroi se burim kanë qenë të ardhurat nga puna e saj dhe e bashkëshortit.

5.000 USD *cash* që ishin gjendje. Gjithashtu, ka deklaruar se nga 10.000 USD *cash* gjendje në vitin 2006, 5.000 USD u kaluan në depozitën në Bankën Amerikane, e cila është në certifikatë dhe u kalua në depozitën rrjedhëse; (vi) në DIPP/2008, gjendje e mbetur nga kredia e marrë, gjendje *cash* në vlerën 10.000 euro; (vii) në DIPP/2009, gjendje *cash* e mbetur në fund të vitit 4.000 USD¹⁸³; (viii) në DIPP/2010, mbyllja e të dy depozitave së bashku me interesat përkatës në NBG Bank (të deklaruara në vitin 2009), të cilat aktualisht ndodhen gjendje *cash* (25.000 USD). Gjithashtu, ka deklaruar se ka shpenzuar për mobilimin e shtëpisë së re vlerën 4.000 USD të deklaruar si gjendje në fund të vitit 2009; (ix) në DIPP/2011, nga gjendja *cash* e deklaruar në vitin 2011 (25.000 USD) u çel një depozitë në Raiffeisen Bank në vlerën 20.000 USD dhe u pakësua gjendja *cash* e mbetur 5.000 USD, në vlerën 2.000 USD, pra mbetur *cash* 3.000 USD; (x) në DIPP/2012, pakësim të gjendjes *cash* të mbetur prej 3.000 USD (në vitin 2011), në vlerën 1.000 USD, pra mbetur *cash* 2.000 USD; (xi) në DIPP/2013, shtim i gjendjes *cash* në vlerën 200.000 lekë¹⁸⁴; (xii) në DIPP/2014, shtim i gjendjes *cash* në vlerën 800.000 lekë¹⁸⁵; (xiii) në DIPP/2015, pakësimi i gjendjes *cash* të deklaruar në deklaratimet e mëparshme në shumën 1.000.000 lekë, të cilat janë përdorur për mobilimin e shtëpisë së re, si dhe për punime të reja të kësaj shtëpie; (xiv) në DIPP/2016, shtim i gjendjes *cash* të deklaruar nga deklaratat e mëparshme në shumën 1.000 USD¹⁸⁶.

6.3 Në vijim të analizimit të ecurisë së gjendjes së kursimeve në likuiditete *cash*, të paraqitur në tabelën nr. 14 të relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht, e ndarë për secilën monedhë (USD, euro, lek)¹⁸⁷, Komisioni konstaton se deklaratimet e subjektit në procesverbalin e ILDKPKI-së datë 24.2.2016¹⁸⁸ përputhen me gjendjen e përlogaritur nga deklaratat periodike vjetore, konkretisht subjekti ka deklaruar që gjendja *cash* në vitin 2005 ka qenë zero¹⁸⁹ dhe se gjendja *cash* në total nga kursimet familjare (subjekti dhe bashkëshorti), në datën 31.12.2014 ka qenë 1.000.000 lekë dhe 2.000 USD¹⁹⁰.

6.4 Gjithashtu, konstatohet se gjendja e përlogaritur nga deklaratat periodike vjetore përputhet me deklarimin e gjendjes së kursimeve *cash* në deklaratën *Vetting*.

6.5 Sa më lart, subjekti ka deklaruar saktë gjendjen e likuiditeteve *cash* në deklaratën *Vetting*.

6.6 Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka deklaruar saktë gjendjen e likuiditeteve *cash* në deklaratën *Vetting* dhe ka pasur burime të ligjshme financiare, duke u gjendur në kushtet e shkronjës “a” të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

KONSTATIME TË TJERA

7. Automjet tip “Mercedes-Benz” – dhuruar bashkëshortit të subjektit në vitin 2001

¹⁸³ Në DIPP/2009, subjekti ka deklaruar: “Mbyllja e depozitës së bashku me interesin në Raiffeisen Bank në vlerën prej 36.720 \$ dhe çelja e dy depozitave të tjera, respektivisht në vlerën 5.000 \$ dhe 20.000 \$ në NBG Bank, na la një diferencë prej 11.720 \$ plus 331 \$ interesa”.

¹⁸⁴ Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti deklaroi se burim kanë qenë të ardhurat nga puna e saj dhe e bashkëshortit.

¹⁸⁵ Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti deklaroi se burim kanë qenë të ardhurat nga puna e saj dhe e bashkëshortit.

¹⁸⁶ Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti deklaroi se burim kanë qenë të ardhurat nga puna e saj dhe e bashkëshortit.

¹⁸⁷ Në këtë tabelë nuk është përfshirë trajtimi i tërheqjes së shumës 8.870 euro, të tërhequr nga kredia në vitin 2007 dhe të shpenzuar në vitin 2008 (trajtuar në paragrafët 1.65-1.66 të relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht).

¹⁸⁸ Përcjellë nga ILDKPKI-ja me shkresën nr. *** prot., datë 5.2.2014.

¹⁸⁹ Përgjigje e pyetjes nr. 5.

¹⁹⁰ Përgjigje e pyetjes nr. 11.

7.1 Në deklaratën e pasurisë së vitit 2003, subjekti ka deklaruar: “Automjet tip “Mercedes-Benz”, me targë ***, e zotëruar nga bashkëshorti për nevoja familjare”. Si burim krijimi ka deklaruar: “Dhuratë bashkëshortit nga B. D., banues në *** të rrethit Korçë...”.

7.2 Në DIPP/2012, subjekti ka deklaruar: “Shitje të automjetit të bashkëshortit të markës “Mercedes-Benz”, me targë ***, në vlerën 100.000 lekë”.

7.3 DPSHTRR-ja¹⁹¹ konfirmon se me kontratën e dhurimit nr. ***, datë 30.11.2001, shtetasi A. D. i ka dhuruar pa kundërshpërblim shtetasit K. Ç. automjetin e përdorur tip “Mercedes-Benz” me nr. shasie ***, të cilën ky i fundit e ka pranuar.

7.4 Komisioni konstaton se shtetasi A. D. ka blerë në Gjermani në datën 16.11.2001 automjetin tip “Mercedes-Benz”, vit prodhimi 1988, në shumën 3.500 marka gjermane. Më pas, referuar deklaratës doganore të datës 30.11.2001¹⁹², konstatohet se bashkëshorti i subjektit, në cilësinë e importuesit, ka kryer zhdoganimin e automjetit duke paguar detyrimin doganor në shumën 150.231 lekë. Në këtë deklaratë doganore figuron si eksportues shtetasi A. D..

7.5 Më pas, shtetasi K. Ç., me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 26.9.2012, i ka shitur shtetasit R. M. automjetin e mësipërm me targë *** kundrejt çmimit 100.000 lekë.

7.6 Komisioni hetoi nëse subjekti ndodhej në kushtet e papajtueshmërisë me shtetasit B. D.dhe A. D. (konflikti i interesit është parashikuar në ligjin 9367/2005¹⁹³) dhe rezultoi që nuk ishte në kushtet e papajtueshmërisë¹⁹⁴.

7.7 Sa më sipër, sipas parashikimeve të pikës 14 të nenit 3 dhe nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, shtetasi A. D. konsiderohet “person tjetër i lidhur”, për shkak të marrëdhënies së dhurimit (interesit) që ekziston ndërmjet tij dhe bashkëshortit të subjektit e, për pasojë, subjekti ka detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të shumës 3.500 marka gjermane nga shtetasi A. D., në vitin 2001.

7.8 Komisioni, me anë të pyetësorit nr. 1, i kërkoi subjektit të rivlerësimin të shpjegojë arsyen e dhurimit, e cila në përgjigje¹⁹⁵ deklaroi se shtetasi A. D. ia ka dhuruar automjetin tip “Mercedes-Benz” në vitin 2001 bashkëshortit të saj, për shkak të marrëdhënieve miqësore e familjare që kishin prindërit e tyre. Më pas, shpjegoi se shtetasi A. D. dhe babai i tij kanë ndërtuar një shtëpi në fshatin ***, Korçë, ku në vitin 2000 bashkëshorti i saj (me profesion inxhinier mekanik) e ka ndihmuar në kryerjen e instalimeve hidraulike dhe elektrike në këtë ndërtesë, pa shpërblim, në formë miqësie. Në atë kohë, sqaroi subjekti, shtetasi A. D. ishte në Gjermani dhe në fund të nëntorit 2001 i ka dërguar mjetin e lartpërmendur, në formë mirënjohje e falënderimi, dhe ia ka dhuruar.

7.9 Lidhur me të ardhurat e shtetasit A. D., që kanë shërbyer për blerjen e automjetit nga ana e tij në vitin 2001, në përgjigje të pyetësorëve¹⁹⁶, subjekti deklaroi se aktualisht shtetasi A. D.

¹⁹¹ Shkresë nr. *** prot., datë 7.3.2024.

¹⁹² Sipas deklaratës doganore automjeti ka hyrë në Shqipëri në datën 19.11.2001.

¹⁹³ Vendim nr. 29_2023, i Kolegjit: “22.5 ...trupi gjykoës konstaton se situata faktike ka ekzistuar në vitin 2002 dhe kualifikimi i saj prej Komisionit si një situatë e cila i nënshtrohet legjislacionit për konfliktin e interesit, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, ...i ndryshuar, gjendet i padrejtë, përderisa ky legjislacion është miratuar prej Kuvendit të Shqipërisë në vitin 2005 dhe nuk ka ndonjë parashikim të posaçëm për efekte prapavepruese. Në këto kushte, referimi që Komisioni ka bërë te neni 33, pika 5, germa “d” e ligjit nr.84/2016, e cila është një dispozitë që evidenton konfliktin e interesit në krijimin e pasurive, nuk mund të aplikohet në rastin konkret përderisa norma nuk ka ekzistuar në kohën e ngjarjes së analizuar”.

¹⁹⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 8.3.2024, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

¹⁹⁵ Email datë 13.5.2024.

¹⁹⁶ Pyetësorët nr. 1 dhe nr. 2.

ndodhet në Gjermani dhe ka mundur të sigurojë vetëm dy dokumente gjermane të tij (kartë identiteti e lëshuar nga shteti gjerman dhe një dokument tjetër i padallueshëm). Gjithashtu, subjekti paraqiti deklaratën noteriale nr. ***, datë 13.3.2019, të shtetasit A. D., i cili konfirmon deklaratimet e subjektit.

7.10 Në kushtet kur subjekti nuk paraqiti dokumentacionin justifikues lidhur me të ardhurat e ligjshme të shtetasit A. D. për të justifikuar blerjen e automjetit në vitin 2001, Komisioni pasqyrooi shumën 3.500 DM¹⁹⁷ si shpenzim në analizën financiare të subjektit dhe personave të lidhur, rrethanë e cila jep efektin tek mungesa e burimeve për krijimeve për kursimet prej 20.000 USD (analiza financiare kronologjike për periudhën 1992 – 2003).

7.11 Nga faktet e analizuara më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: *Ka mungesë të dokumentacionit ligjor justifikues për të ardhurat e personit tjetër të lidhur/shtetasit A. D. për blerjen e automjetit të dhuruar bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.*

7.12 Sa më sipër, në përgjigje të rezultateve të hetimit¹⁹⁸, subjekti paraqiti shpjegimet e saj, të cilat u analizuan nga Komisioni në pikën 3 të këtij vendimi, si pjesë përbërëse e analizës financiare për periudhën 1991 – 2003.

8. Dhurimet nga nëna e subjektit

8.1 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar se nëna e saj/A. Q. i ka dhuruar subjektit dhe bashkëshortit një shumë totale prej 870.000 lekësh¹⁹⁹ dhe se këto të ardhura janë përdorur për shpenzime familjare.

8.2 Në seksionin e të dhënave konfidenciale të DIPP/2012, subjekti ka deklaruar: *“Dhuruar shumën 350.000 lekë nga A. Q., deklarues Irena Çunoti, sipas kontratës së dhurimit nr. *** rep., nr. *** kol., të noterisë Korçë”.*

8.3 Në seksionin e të dhënave konfidenciale të DIPP/2013, subjekti ka deklaruar: *“Dhuruar shumën 260.000 lekë nga A. Q., deklarues Irena Çunoti, sipas kontratës së dhurimit nr. *** rep., nr. *** kol., të noterisë Korçë”.*

8.4 Në seksionin e të dhënave konfidenciale të DIPP/2014, subjekti ka deklaruar: *“Dhuruar shumën prej 260.000 lekësh nga A. Q., bashkëshortit të deklarueses K. Ç., sipas kont. dhur. nr. *** rep., nr. ***kol.”.*

¹⁹⁷ Vlerësuar me kursin e këmbimit të pasqyruar në deklaratën doganore, 1 DM = 65,16 lekë

¹⁹⁸ Email datë 15.7.2024.

¹⁹⁹ *“(i) Të ardhura nga kontrata e dhurimit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.9.2012, të mamasë time A. Q. në favorin tim, në shumën 350.000 lekë; (ii) Të ardhura nga kontrata e dhurimit nr. *** rep., nr. *** kol., të datës 27.12.2013, të mamasë time A. Q. në favorin tim, në shumën 260.000 lekë. Burim i këtyre të ardhurave është kontrata e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., e datës 9.11.2011, të mamasë dhe bashkëpronarëve të tjerë të një trualli, pronë e tyre prej 97 m², ndodhur në qytetin e Korçës, shitur bashkisë së këtij qyteti, e cila e pagoi shumën e kësaj prone me këste. Të gjitha këto të ardhura janë përdorur për shpenzimet familjare. Shuma e të ardhurave neto të krijuara 610.000 lekë; (iii) Të ardhura nga kontrata e dhurimit nr. *** rep., nr. *** kol., të datës 31.12.2014, të mamasë time A. Q. në favorin e bashkëshortit tim, në shumën 260.000 lekë. Burim i këtyre të ardhurave është kontrata e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., e datës 9.11.2011, të mamasë dhe bashkëpronarëve të tjerë të një trualli, pronë e tyre prej 97 m², ndodhur në qytetin e Korçës, shitur bashkisë së këtij qyteti, e cila e pagoi shumën e kësaj prone me këste. Këto të ardhura janë përdorur për shpenzimet familjare. Shuma e të ardhurave neto të krijuara 260.000 lekë”.*

8.5 Referuar dokumentacionit të administruar²⁰⁰, rezulton se: (i) në kontratën e dhurimit nr. ***, datë 13.9.2012, pasqyrohet se shtetasja A. Q. i ka dhuruar subjektit Irena Çunoti shumën 350.000 lekë, të përfituar nga 2 këstet e para të parashikuara në kontratën e shitblerjes me kusht nr. *** rep., nr. *** kol., për pasurinë truall të ndodhur në Lagjen Nr. ***, Korçë, me sip. 97 m², ku dhuruesja është bashkëpronare; (ii) në kontratën e dhurimit nr. ***, datë 27.12.2013, pasqyrohet se shtetasja A. Q. i ka dhuruar subjektit Irena Çunoti shumën 260.000 lekë, të përfituar nga kësti i tretë i parashikuar në kontratën e shitblerjes me kusht nr. *** rep., nr. *** kol., për pasurinë truall të ndodhur në Lagjen Nr. ***, Korçë, me sip. 97 m², ku dhuruesja është bashkëpronare; (iii) në kontratën nr. ***, datë 31.12.2014, pasqyrohet se shtetasja A. Q. i ka dhuruar shtetasit K. Ç. shumën 260.000 lekë, të përfituar nga kësti i katërt i parashikuar në kontratën e shitblerjes me kusht nr. *** rep., nr. *** kol., për pasurinë truall të ndodhur në Lagjen nr. ***, Korçë, me sip. 97 m², ku dhuruesja është bashkëpronare.

8.6 Në kushtet kur nëna e subjektit/A. Q. figuron në cilësinë e dhurueses së një shume totale prej 870.000 lekësh, konkretisht subjektit i ka dhuruar shumat 350.000 lekë dhe 260.000 lekë dhe bashkëshortit të subjektit i ka dhuruar 260.000 lekë, fakte të provuara nga kontratat përkatëse të dhurimit, referuar pikës 4²⁰¹ të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të shumave të mësipërme.

Burimi i krijimit për shumën totale të dhuruar (870.000 lekë)

8.7 Referuar kontratave të dhurimit të sipërcituara, shumat që shtetasja A. Q. i ka dhuruar subjektit dhe bashkëshortit të saj kanë si burim nga këstet e përfituara në kontratën e shitblerjes me kusht nr. *** rep., nr. *** kol., për shitjen e pasurisë truall me sip. 97 m².

8.8 Lidhur me origjinën e pronës objekt shitjeje, nga dokumentacioni i përcjellë nga ASHK Korçë²⁰² konstatohet se shtetasja A. Q., në cilësinë e një prej trashëgimtarëve ligjorë të shtetasit M. C., bazuar në vendimin nr. ***, datë 9.2.2000, të Gjykatës së Apelit Korçë, figuron bashkëpronare e pasurisë truall me sip. 97 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, fq. ***.

8.9 Me vendimin nr. ***, datë 5.10.2011, Këshilli Bashkiak Korçë ka miratuar lidhjen e kontratës së shitjes për truallin me sip. 97 m² të ndodhur në rrugën “***”, Lagjja Nr. ***, Korçë, me vlerë 2.619.000 lekë²⁰³.

8.10 Më tej është lidhur kontrata e shitblerjes me kusht nr. ***, datë 9.11.2011²⁰⁴, në të cilën pasqyrohet se shtetasit A. Q., V. C. dhe G. C. i kanë shitur Bashkisë Korçë një truall²⁰⁵ me sip. 97 m² kundrejt çmimit 2.619.000 lekë.

8.11 Në këtë kontratë parashikohet se çmimi i shitjes do të paguhet me këste në llogaritë bankare pranë Raiffeisen Bank të secilit prej shitësve²⁰⁶.

²⁰⁰ Paraqitur nga subjekti dhe përcjellë nga noteri B. E. Z. me shkresën nr. extra prot. (nr. *** prot., datë 12.2.2024 në Komision).

²⁰¹ Që parashikon se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

²⁰² Shkresë nr. *** prot., datë 31.7.2023.

²⁰³ Administruar bashkëlidhur kontratës së shitjes me kusht.

²⁰⁴ Administruar bashkëlidhur kontratave të dhurimit.

²⁰⁵ I ndodhur në Lagjen Nr. *** të qytetit të Korçës, me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, fq. ***.

²⁰⁶ Në kontratë parashikohet: (i) kësti i parë prej 300.000 lekësh do të shlyhet ditën e sotme (datën e kontratës 9.11.2011); (ii) kësti i dytë në shumën 773.000 lekë do të paguhet brenda 6-mujorit të parë, por pas miratimit të buxhetit për vitin 2012; (iii) kësti i tretë shuma prej 773.000 lekësh do të paguhet brenda 6-mujorit të parë, por pas miratimit të buxhetit për vitin 2013; (iv) kësti i katërt prej 773.000 lekësh do të paguhet brenda 6-mujorit të parë, por pas miratimit të buxhetit për vitin 2013.

8.12 Nga analizimi i llogarisë bankare të shtetasës A. Q. pranë Raiffeisen Bank, konstatohet se në llogarinë e kësaj shtetaseje janë kredituar disa pagesa nga Bashkia Korçë²⁰⁷, konkretisht në datën 23.11.2011 shuma 100.000 lekë, në datën 7.6.2012 shuma 257.667 lekë, në datën 18.10.2013 shuma 100.000 lekë, në datën 11.11.2013 shuma 157.666 lekë dhe në datën 13.6.2014 shuma 257.660 lekë, në total 872.993 lekë.

8.13 Komisioni konstaton se: (i) në datën 10.9.2012, nëna e subjektit ka tërhequr shumën 350.000 lekë, me burim transfertën bankare nga Bashkia Korçë dhe në datën 13.9.2012 është lidhur kontrata e dhurimit për të njëjtën shumë; (ii) në datën 31.10.2013, nëna e subjektit ka tërhequr shumën 100.000 lekë dhe në datën 13.12.2013 ka tërhequr shumën 160.000 lekë, me burim transfertën bankare nga Bashkia Korçë dhe në datën 27.12.2013 është lidhur kontrata e dhurimit për shumën 260.000 lekë; (iii) në datën 18.12.2014, nëna e subjektit ka tërhequr shumën 263.000 lekë, me burim transfertën bankare nga Bashkia Korçë dhe në datën 31.12.2014 është lidhur kontrata e dhurimit për shumën 260.000 lekë.

8.14 Në nenin 8 të ligjit nr. 8438/1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, me ndryshime deri në vitet 2012 – 2013, nuk gjendet një parashikim i posaçëm që të kualifikojë shumat monetare të dhuruara si të ardhurat që u nënshtrohen detyrimeve tatimore. Gjithashtu, edhe sipas udhëzimit nr. 5, datë 30.1.2006, të miratuar në zbatim të ligjit nr. 8438/1998, “Dhurimi i vlerave monetare”, nuk listohet tek kategoritë që bëjnë pjesë “të ardhura të tjera”, për të cilat mund të aplikohet tatimi në burim²⁰⁸.

8.15 Sa më sipër, shumat e dhuruara nga shtetasja A. Q. në datat 13.9.2012, 27.12.2013 dhe 31.12.2014 subjektit Irena Çunoti dhe bashkëshortit të saj K. Ç. nuk përfshihen në rrethin e të ardhurave që i nënshtrohen detyrimeve tatimore.

8.16 Në përfundim, Komisioni vlerëson se personi tjetër i lidhur/A. Q., nëna e subjektit, ka pasur burime financiare të ligjshme për dhurimin e shumës totale prej 870.000 lekësh, e cila u pasqyrua në analizën financiare të vitit përkatës.

9. Të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti nga shoqëria “**” sh.p.k.**

9.1 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar të ardhura të përfituara nga bashkëshorti nga shoqëria “****” sh.p.k., në shumën totale 21.000 USD, konkretisht: (i) për periudhën 1997 – 2002, të ardhura nga fitimi i shoqërisë “****” sh.p.k., për 28% të aksioneve kanë qenë në vlerën 14.000 USD; (ii) shitja e aksioneve në vitin 2002 kap shumën 7.000 USD.

9.2 Subjekti ka paraqitur dokumentacionin justifikues: (i) konfirmim datë 19.10.2016, lëshuar nga shoqëria “****” sh.p.k. për shtetasin K. Ç.; (ii) akt themelimi i shoqërisë “****” sh.p.k., datë 30.9.1997; (iii) kontratë shitjeje nr.*** rep., nr. *** kol., datë 8.11.2002, me palë shitëse K. Ç. dhe palë blerëse K. B., të 28% të kuotave të shoqërisë “****” sh.p.k. kundrejt shumës 7.000 USD, shoqëruar me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për transferimet e kuotave; (iv) vendim nr. ***, datë 15.10.1999, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pranimin e depozitimit të vendimit të ortakëve të shoqërisë “****” sh.p.k., për transferimin me anë të shitjes së 15% të kuotave të ortakut N. L. dhe E. L., në pjesë të barabarta (5% secili), tre ortakëve të tjerë K. Ç., K. B. dhe A. Z..

²⁰⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 24.4.2024, e Raiffeisen Bank.

²⁰⁸ Vendim nr. 15, datë 18.6.2021 (JR), i Kolegjit.

Lidhur me blerjen dhe shitjen e kuotave

9.3 Nga dokumentacioni i administruar nga QKB-ja²⁰⁹ rezulton se me vendimin e datës 8.10.1997 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, është regjistruar shoqëria “****” sh.p.k., me objekt aktivitetin financiar të kambizmit, menaxhimit të fondeve, shitblerjes së letrave me vlerë, transferimit të kapitaleve etj., ku në cilësinë e ortakut pasqyrohet edhe shtetasi K. Ç..

9.4 Shtetasi K. Ç. ka qenë ortak i shoqërisë “****” sh.p.k., fillimisht me pjesëmarrje 23% të aksioneve dhe më pas me 28% të aksioneve (vlerë nominale 7.000 USD), të cilat më tej ia ka shitur ortakut tjetër të shoqërisë, shtetasit K. B., me vlerë nominale 7.000 USD²¹⁰.

9.5 Bazuar në aktin e themelimit të shoqërisë “****” sh.p.k., datë 30.9.1997, kontributi në para i bashkëshortit të subjektit për blerjen e 23% të kuotave ka qenë në shumën 5.750 USD. Më pas, referuar kontratës për shitje kuotash nr. ***, datë 4.3.1999²¹¹, bashkëshorti i subjektit ka blerë 25 pjesë nga dy ortakët e larguar të shoqërisë (5% të kuotave), me çmim 65,5 USD për pjesë, pra në total 1.637,5 USD, duke arritur në 28% të kuotave.

9.6 Me anë të pyetësorit nr. 1, subjektit iu kërkua të deklarojë burimin financiar të krijimit të shumave të sipërcituara, e cila në përgjigje²¹² sqaroi se burimi financiar i shumës 5.750 USD kanë qenë të ardhurat nga puna e saj dhe nga puna e bashkëshortit deri në vitin 1997 kur u krijua kjo shoqëri. Po kështu, subjekti sqaroi se burim i shumës 1.637,5 USD ka qenë puna e bashkëshortit në këtë shoqëri dhe të ardhurat e punës së saj.

9.7 Për sa i përket shitjes së kuotave, referuar dokumentacionit të paraqitur, të administruar edhe nga noter A. Q.²¹³, konstatohet se me kontratën e shitjes nr. ***, datë 9.11.2002, shtetasi K. Ç. i ka shitur shtetasit K. B. 28% të kuotave të shoqërisë “****” sh.p.k., kundrejt çmimit të shitjes në vlerën 7.000 USD.

9.8 Sa më lart, Komisioni paraqiti në analizën financiare shpenzime për blerjen e kuotave në shumën 5.750 USD²¹⁴, në datën 8.10.1997 dhe në shumën 1.637,50 USD²¹⁵, në datën 4.13.1999, si dhe të ardhura nga shitja e tyre në shumën 7.000 USD²¹⁶, në datën 9.11.2002.

Lidhur me të ardhurat në shumën 14.000 USD (nga fitimi i shoqërisë)

9.9 Referuar vërtetimit datë 19.10.2016, lëshuar nga shoqëria “****” sh.p.k.²¹⁷, shtetasi K. Ç. ka kryer detyrën e administratorit të shoqërisë gjatë periudhës 8.10.1997 – 30.5.2002, datë në të cilën është liruar nga kjo detyrë sipas vendimit nr. *** të arkivuar në regjistrin e shoqërisë. Gjatë periudhës që ka kryer këtë detyrë, ai ka përfituar pagesën minimale të njohur ligjërisht nga ISSH-ja dhe për periudhën në fjalë janë kryer të gjitha pagesat e detyrimeve pranë këtij institucioni. Gjithashtu, shoqëria vërteton se ka përfituar edhe nga aktiviteti i shoqërisë gjatë periudhës që ka qenë ortak (sipas vendimit të shoqërisë), në shumën 14.000 USD.

²⁰⁹ <https://qkb.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-tregtar/kerko-per-subjekt/>

²¹⁰ Vërtetim datë 19.10.2016, lëshuar nga shoqëria “****” sh.p.k., vendim i regjistrit të shoqërisë nr. ***, datë 23.1.2003

²¹¹ Administruar në dokumentacionin e ndodhur në ekstraktin tregtar historik, në faqen zyrtare të QKB-së.

²¹² Email datë 13.5.2024.

²¹³ Nr. *** prot., datë 11.3.2024, në Komision.

²¹⁴ Vlerësuar me kursin mesatar të këmbimit për muajin shtator 1997, sipas të dhënave të Bankës së Shqipërisë.

²¹⁵ Vlerësuar me kursin mesatar të këmbimit për muajin tetor 1999, sipas të dhënave të Bankës së Shqipërisë.

²¹⁶ Shuma 7. USD e vlerësuar me kursin zyrtar të këmbimit në datën 8.11.2002, sipas të dhënave të Bankës së Shqipërisë.

²¹⁷ Paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting* (Aneks nr. 4/6).

9.10 DRT Korçë²¹⁸ bën me dije se nga verifikimi i kryer në regjistrat manualë të subjektit “****” sh.p.k. figuron i regjistruar në Degën e Tatimeve Korçë, me kod fiskal *** nga viti 1997 dhe se nuk disponojnë informacion për të ardhurat e realizuara për periudhën 1997 – 2002²¹⁹.

9.11 Sa më lart, në kushtet kur: (i) sipas parashikimeve të ligjit nr. 8438/1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ardhurat që rrjedhin nga fitimi i ortakut në shoqërinë tregtare merren si të ardhura të tatueshme²²⁰; (ii) nuk rezulton që shoqëria “****” sh.p.k. të ketë paguar detyrimet tatimore lidhur me shpërndarjen e të ardhurave të realizuara nga aktiviteti i saj ortakëve të shoqërisë në periudhën 1997 – 2002, duket se të ardhurat e deklaruara nga subjekti në deklaratën *Vetting* në shumën 14.000 USD, të përfituar nga bashkëshorti i saj për periudhën 1997 – 2002 nga fitimi i shoqërisë “****” sh.p.k., nuk plotësojnë kriterin e të ardhurës së ligjshme të parashikuar nga neni 3, pika 19²²¹ e ligjit nr. 84/2016, duke e vënë subjektin në kushtet e mosjustifikimit me burime të ligjshme të krijimit të kësaj shume e, për rrjedhojë, kjo shumë nuk u paraqiti si e ardhur në analizën financiare të subjektit.

9.12 Nga faktet e analizuara më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: *Mungon dokumentacioni ligjor justifikues për të ardhurat e bashkëshortit të subjektit në shumën 14.000 USD, të përfituar nga fitimi i shoqërisë “****” sh.p.k., të deklaruar në deklaratën *Vetting*.*

9.13 Sa më sipër, në përgjigje të rezultateve të hetimit²²², subjekti paraqiti shpjegimet e saj, të cilat u analizuan nga Komisioni në pikën 3 të këtij vendimi, si pjesë përbërëse e analizës financiare për periudhën 1991 – 2003.

10. Adresat e banimit

10.1 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar adresën e gjendjes civile *Lagjja Nr. ***, rruga “****”, nr. ***, Korçë* dhe adresën e banimit *Lagjja Nr. ***, rruga “****”, nr. ***, Korçë*.

10.2 Në DIPP-të vjetore, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: (i) në DIPP-të e viteve 2003 – 2009 ka deklaruar si adresë banimi/regjistrimi në gjendjen civile *Lagjja Nr. ***, rruga “****”, nr. ***, Korçë*; (ii) në DIPP-të e viteve 2010 – 2016 ka vazhduar të deklarojë si adresë të gjendjes civile *Lagjja Nr. ***, rruga “****”, nr. ***, Korçë*, ndërsa si adresë banimi ka deklaruar *Lagjja Nr. ***, rruga “****”, nr. ***, Korçë*.

10.3 Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar si në vijim:

- *Periudha 1.9.1987 deri në datën 8.11.1988 (data e martësës)* – në banesën në pronësi të babait të saj S. Q., me adresë *Lagjja Nr. ***, rruga “****”, nr. ***, Korçë*, ku ka jetuar me prindërit dhe vëllain Dh. Q. (kjo adresë është trajtuar në pasurinë nr. 1).

²¹⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 16.1.2017, drejtuar subjektit (paraqitur në deklaratën *Vetting*).

²¹⁹ Në përgjigje të kërkesës së Komisionit, DRT Korçë, me shkresën nr. *** prot., datë 10.6.2024, bëri me dije se subjekti tregtar “****” sh.p.k. mbështetur në sistemin informatik C@ts, rezultoi i regjistruar me përgjegjësi tatim i thjeshtuar mbi fitimin prej datës 1.2.2005 dhe se subjektet e regjistruar me përgjegjësi tatimore tatim i thjeshtuar mbi fitimin nuk kanë detyrim ligjor për dorëzimin e pasqyrave financiare).

²²⁰ Neni 8: “1.Për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale, merren si të ardhura të tatueshme: ...b) të ardhurat që rrjedhin nga fitimi i ortakut apo i aksionerit në shoqërinë tregtare...”

²²¹ Ligji nr. 84/2016, neni 3: “19. “Të ardhura të ligjshme” janë të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur të tij/saj, sipas përcaktimeve të burimit të të ardhurave, të parashikuara në ligjin “Mbi tatimin mbi të ardhurat”.

²²² Email datë 15.7.2024.

- *Periudha 8.11.1988 (data e martesës) – 25.12.1990* – në banesën e prindërve të bashkëshortit, P. dhe A. Ç., me adresë Lagjja Nr. ***, rruga “****”, nr. ***, Korçë.
- *Periudha 26.12.1990 deri nga fundi i vitit 2010/fillimi i vitit 2011* – janë ndarë nga prindërit e bashkëshortit si familje më vete, por kanë banuar në të njëjtën banesë, në Lagjen Nr. ***, rruga “****”, nr. ***, Korçë, në pronësi të prindërve të bashkëshortit, P. dhe A. Ç., banesë e përshtatur me 3 hyrje, një prej të cilave e përdorte familja e subjektit.
- *Periudha fundi i vitit 2010/fillimi i vitit 2011 deri në vijim* – ka banuar në banesën në bashkëpronësi me nënën A. Q., me adresë Lagjja Nr. ***, rruga “****”, nr. ***, Korçë (kjo adresë është trajtuar në pasurinë nr. 1).

10.4 DPGJC-ja²²³ konfirmon se në periudhën 1974 – 1988 subjekti figuron me gjendje familjare bashkë me prindërit e saj në adresën *Lagjja Nr. ***, rruga “****”, nr. ****. Pas martesës, në datën 11.8.1988, subjekti figuron në përbërjen familjare të shtetasit P. Ç., me adresë *Lagjja Nr. ***, rruga “****”, nr. ***, Korçë*. Në vijim, në periudhën 26.12.1990 – 11.8.2014, subjekti figuron në përbërje familjare më vete, me bashkëshortin dhe vajzën e saj, në adresën *Lagjja Nr. ***, rruga “****”, nr. ***, Korçë*.

10.5 FSHU-ja²²⁴ konfirmon se me gjeneralitetet P. A. Ç. identifikohet një abonent me kontratë furnizimi nr. *** në instancën Korçë, me adresë rruga “****”, nr. ***. Gjithashtu, konfirmon se në emër të shtetasit K. Ç. identifikohet 1 abonent me kontratë furnizimi nr. *** në instancën Korçë, me adresë rruga “****”, ***.

Lidhur me banesën në adresën Lagjja Nr. ***, rruga “*”, nr. ***, Korçë, pasuri në pronësi të prindërve të bashkëshortit të subjektit***

10.6 Referuar dokumentacionit të administruar nga ASHK Korçë²²⁵, konstatohet se shtetasit P. dhe A. Ç., me anë të kontratës së dhurimit nr. ***, datë 4.7.1963, janë bërë pronarë të një shtëpie me sipërfaqe totale 203 m², nga të cilat 120 m² ndërtesë, me 1/2 pjesë takuese secili, me adresë rruga “****”, Korçë.

10.7 Më pas rezulton se pasuria e mësipërme është regjistruar në pronësi të shtetasve P.dhe A. Ç. me nr. pasurie nr. ***, z. k. ***, vol. ***, fq. ***, e llojit truall, me sipërfaqe totale 203,5 m², nga të cilat 120 m² ndërtesë, për të cilën është lëshuar certifikata e pronësisë në datën 7.4.2005.

10.8 Në vijim konstatohet se në datën 3.7.2020 janë regjistruar dëshmitë e trashëgimisë së të ndjerëve A. Ç. (ndërruar jetë në datën 11.8.2012) dhe P. Ç. (ndërruar jetë në datën 26.1.2020) dhe pasuria e mësipërme figuron e regjistruar në emër të shtetasve R. Ç. dhe K. Ç., me 1/2 pjesë takuese secili.

10.9 Me kontratën e shitjes nr. ***, datë 9.9.2020, shtetasit K. dhe R. Ç. pasurinë e mësipërme e kanë shitur tek shtetasit A. dhe I. M. me vlerë 80.000 euro.

10.10 Referuar formularit të tatimit për kalim të së drejtës së pronësisë, konstatohet se llogaritja e tatimit është bërë për ndërtesën 2 kate (120 m²x2) dhe truallin me sip. 83,5 m², ndërkohë që

²²³ Shkresë nr. *** prot., datë 22.5.2024.

²²⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 26.7.2021.

²²⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 31.7.2023.

në dokumentet e origjinës së regjistrimit, në kontratën e shitjes së datës 9.9.2020 dhe në kartelën e pasurisë bashkëlidhur kontratës nuk pasqyrohet që banesa është 2 kate.

10.11 Sa më sipër, me anë të pyetësorit nr. 2, Komisioni i kërkoi subjektit të sqarojë: (i) pse nga ASHK-ja është llogaritur tatimi i shitjes për objektin 2 kate, ndërkohë që nga dokumentet e origjinës së regjistrimit dhe në kontratën e shitjes së datës 9.9.2020 nuk pasqyrohet që banesa të jetë 2 kate; (ii) nëse subjekti ka kryer investime në këtë objekt gjatë periudhës që ka banuar aty dhe, nëse po, sa është vlera e tyre, si dhe të vendosë në dispozicion koordinatat gjeografike të objektit të mësipërm.

10.12 Në përgjigje²²⁶, subjekti deklaroi se: *“...Është i vërtetë konstatimi juaj, pasi në dokumentet e origjinës nuk përmendet numri i kateve të objektit në fjalë. Gjithashtu, në kartelën e pasurisë, hartën treguese dhe në kontratën e shitjes nr. ***, datë 9.9.2020, nuk përmendet numri i kateve. Por, në bazë të dokumentacionit që kam tërhequr nga ASHK Korçë, përkatësisht referenca me nr. ***, datë 22.8.2020, mbi të cilën është kryer rivlerësimi i pasurisë në dokumentacionin e dosjes, ndodhet një fotografim ajror (Google Maps), ku duket qartësisht se shtëpia është dy kate dhe nuk ka ndryshime në strukturë apo në formë. Gjithashtu, mendoj se ASHK Korçë në llogaritjen e tatimit u është referuar dhe fotografimeve ajrore të viteve të ndryshme, për të cilën kanë konstatuar që pasuria objekt kontratë ka qenë 2 kate dhe nuk ka ndryshime në formë”*.

10.13 Gjithashtu, subjekti sqaron se: *“...nga momenti që unë kam hyrë në këtë banesë, 11.8.1988... dhe derisa u largova, shtëpia ka qenë e formës 2-katëshe, e mirëmbajtur prej nesh dhe nuk kemi pasur asnjë pretendim në lidhje me llogaritjen e tatimit pasi shtëpia ka qenë 2-katëshe”*.

10.14 Në vijim të pyetësorit nr. 2²²⁷, Komisioni i kërkoi subjektit të sqarojë nëse janë kryer shtesa/investime në këtë pasuri gjatë kohës kur ka banuar aty, nëse ka kontribuar financiarisht bashkë me bashkëshortin në shtesa/investimet e kryera në këtë pronë e, nëse po, sa është shuma e shpenzuar dhe viti në të cilin janë kryer, si dhe të paraqesë koordinata gjeografike në *Google Maps* të objektit të mësipërm.

10.15 Në përgjigje²²⁸, subjekti deklaroi se: *“...gjatë viteve që kam jetuar në këtë shtëpi, nuk është kryer asnjë shtesë apo investim në këtë pasuri. Kjo banesë është mirëmbajtur nga ana jonë, por jo të jenë kryer shtesa në ndryshim të strukturës dhe formës së saj”*. Për të vërtetuar deklarimin e saj, subjekti ka paraqitur dokumentacionin justifikues²²⁹.

10.16 Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti konstatohet edhe një herë dokumentacioni i origjinës së regjistrimit të banesës së mësipërme, e cila është pasqyruar më lart, si dhe një foto e objektit 2 kate, e cila është njëzuar me origjinalin nga ASHK Korçë.

10.17 Komisioni vëren se objekti që evidentohet në sfond të fotove familjare të paraqitura nga subjekti (që sipas deklarimit i përkasin vitit 1970) duket i njëjtë me atë të paraqitur në foton e administruar në dokumentacionin e përcjellë nga ASHK-ja. Në të dyja rastet objekti është 2 kate.

²²⁶ Email datë 26.5.2024.

²²⁷ Email datë 20.5.2024.

²²⁸ Email datë 26.5.2024.

²²⁹ Dokumentacioni i ASHK-së me nr. reference ***, datë 22.8.2020; fotografi të shtëpisë së vulosur nga ASHK-ja; foto në *Google Maps*; dy fotografi nga albumet familjare, të cilat sipas subjektit i përkasin vitit 1970 dhe ku kanë dalë bashkëshorti i subjektit dhe babai i tij me disa të afërm.

garancinë e shkollës. Në këto kushte, vijon deklarin, ka menduar që transfertën e dytë ta kryejë në emër të shokut të tij të ngushtë K. Ç. dhe në datën 9.3.2004 janë paraqitur të dy në Bankën Greke, dega Korçë dhe kanë bërë transfertën, e cila është bërë në emër të shtetasit K. Ç., ndërsa të hollat ishin të tij. Më pas, shpjegon se djali i tij E. C. aplikoi 3 herë për t'u pajisur me vizë, por Ambasada e SHBA-së në datat 3.6.2004, 15.7.2004 dhe 12.8.2004 nuk e pajisi me vizë dhe, në këto kushte, vajza e tij M. C. në datën 30.8.2004 ktheu shumën 61.960 USD. Për të provuar deklarin e saj, bashkëlidhur deklaratës gjendet dokumentacioni provues²³².

11.5 Të njëjtin deklarin ka bërë edhe shtetasja Sh. C., bashkëshortja e shtetasit K. C., në deklaratën noteriale nr. ***, datë 19.4.2010.

11.6 Nga shqyrtimi i dokumentacionit provues konstatohet se:

- Në datën 1.3.2004, shtetasja Sh. C. i dërgon vajzës së saj M. C. shumën 30.000 USD, çka provohet me kopje të transfertës ndërkombëtare nëpërmjet Tirana Bank, me bankë përfituese ***, USA.
- Në datën 9.3.2004, nga llogaria e bashkëshortit të subjektit transferohen për shtetasen M. C. shuma 30.173 USD (sipas detajeve të sipërcituara), me të njëjtën bankë përfituese si transferta ndërkombëtare e sipërcituar.
- Në datën 23.3.2004, *** Bank USA lëshon një vërtetim, ku konfirmohet balanca e llogarisë së shtetasës M. C. në shumën 65.515 USD (totali i dy transfertave të mësipërme është 60.173 USD) – vërtetim i paraqitur nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 1.
- Në datën 19.4.2004, *** i dërgon konfirmimin e pranimit shtetasit E. C. – letër pranimi e paraqitur nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 1.
- Në datat 3.6.2004, 15.7.2007 dhe 12.8.2004, Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës informon se nuk mund t'i lëshojë vizën – 3 njoftime të paraqitura nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 1.
- Në datën 31.8.2004, shtetasja M. C. transferon në llogari të babait të saj K. C. shumën 61.960 USD në llogarinë e tij pranë Tirana Bank – subjekti ka paraqitur kopje të transfertës ndërkombëtare nga M. C. tek K. C. dhe lëvizje të llogarisë bankare të shtetasit K. C. pranë Tirana Bank, për periudhën 13.8.2004 – 22.10.2013.

11.7 Me anë të pyetësorit nr. 3, Komisioni i kërkoi subjektit të shpjegojë se përse transaksionet bankare (depozitimi dhe transferimi) janë kryer nëpërmjet llogarisë bankare të bashkëshortit të subjektit (dhe jo një të afërmi të tij), si dhe i kërkoi të paraqesë dokumentacion justifikues lidhur me të ardhurat e shtetasit K. C. deri në datën 9.3.2004.

11.8 Në përgjigje²³³, subjekti sqaroi se nuk ka qenë në dijeni të këtij veprimi bankar ditën e ngjarjes dhe, më tej, shpjegoi se në vitin 2010, rastësisht, në bisedë e sipër me bashkëshortin, ka mësuar për këtë fakt, fakt të cilin e vlerësoi dhe, duke qenë se ishte një transaksion që nuk kishte lidhje fare dhe as ndikim financiar me familjen e saj, menjëherë ka mbledhur

²³² Dokument i datës 1.3.2004 i Tirana Bank për transferim të shumës 30.000 USD; dokument në gjuhën angleze i ***, i datës 19.4.2004; dokument në gjuhën angleze i *** USA, ku pasqyrohet se në llogarinë e shtetasës M. C. janë të depozituara 65.000 USD; formular aplikimi për emigrimin dhe natyralizimin, i plotësuar nga shtetasja M. C. në gjuhën angleze, i datës 5.10.2004; njoftim i datës 3.6.2004 i Ambasadës së SHBA-së; njoftim i datës 15.7.2004, i Ambasadës së SHBA-së; njoftim i datës 12.8.2004 i Ambasadës së SHBA-së; dokument bankar për transferimin e shumës 61.96 USD në datën 31.8.2004.

²³³ Datë 26.6.2024.

dokumentacion justifikues dhe provues që në vitin 2010, për të shmangur çfarëdo lloji keqkuptimi.

11.9 Subjekti sqaroi se viti 2010 ishte viti i marrjes në dijeni për këtë fakt dhe prandaj deklaratat noteriale janë përpiluar në këtë vit, që daton shumë kohë përpara miratimit të ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. E gjithë shuma e transaksionit të kryer është kthyer dhe është depozituar në llogarinë bankare të shtetasit K. C., pra provohet qartësisht se pronësia e kësaj shume është e këtij shtetasi dhe se në asnjë prej deklaratave të deklarimit vjetor të plotësuar në vite nuk del përdorimi i kësaj shume nga familja e saj, përfundoi subjekti.

11.10 Lidhur me arsyen se përse transaksionet janë kryer pikërisht nga llogaria e bashkëshortit të saj, subjekti deklaroi se: *“Shtetasi K. C. në kohën e kryerjes së kësaj transferte nuk kishte asnjë të afërm në Korçë, pasi motra e tij Q. X. familjarisht ishte dhe ndodhet edhe aktualisht në ***, SHBA; vëllai i tij P. C. familjarisht ishte në Kanada fillimisht dhe aktualisht ndodhet në ***, SHBA; kunati i tij (vëllai i vetëm i bashkëshortes), shtetasi M. P., familjarisht ishte dhe ndodhet edhe aktualisht në ***, SHBA. Ai i është drejtuar bashkëshortit tim për këtë transfertë jo si bashkëshort i një prokuroreje, por si shok i ngushtë i tij, pasi ata njiheshin familjarisht që në kohën para martesë dhe më pas të dy kanë qenë me detyrën e inxhinierit mekanik në të njëjtën ndërmarrje e pikërisht në Kombinatin e Trikotazheve Korçë”.*

11.11 Lidhur me burimet e ligjshme financiare të shtetasit K. C., subjekti shpjegoi se ai ka pasur biznese në emër të bashkëshortes së tij Sh. C., si dhe në emrin e tij personal, përveç të ardhurave të tjera nga trashëgimia apo kursimet e tij nga puna. Gjithashtu, subjekti shpjegoi se Sh. C. (bashkëshortja e K. C.) ka zhvilluar aktivitet privat që në vitin 1993 si laborante dhe stomatologe, por në kushtet që shtetasja Sh. C. ka ndërruar jetë, nuk disponojnë dokumente me kod fiskal dhe i vetmi dokument që disponojnë, është diploma në gjuhën greke, e përkthyer në shqip, në kuadrin e programit ***, viti 1996²³⁴.

11.12 Subjekti paraqiti: (i) vendim nr. ***, datë 11.4.1995, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për regjistrimin e shoqërisë “****” sh.p.k., me ortakë shtetaset Y. Gj., T. B. e Sh. P. (bashkëshortja e K. C.), me objekt veprimtarie prodhim sixhadesh, qilimash, batanijesh, tapetesh, blerje dhe rishitje të llojeve të leshit etj., dhënie me qira të objekteve etj., pajisur me NUIS ***, me datë lëshimi 27.6.1996²³⁵; (ii) vendim nr. ***, datë 28.2.2002, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për regjistrimin e shoqërisë “****” sh.p.k., me ortakë K. C. dhe Sh. C., me objekt veprimtarie prodhim, tregti në fushën e tekstilit, konfeksione, prodhim qilimash etj., import, eksport të artikujve të ndryshëm me shumicë dhe pakicë etj., pajisur me kod fiskal nr. ***²³⁶.

11.13 Sa më lart, Komisioni vëren se subjekti ka paraqitur dokumentacion, i cili provon aktivitetin tregtar të zhvilluar nga shtetasi K. C. dhe bashkëshortja e tij, por nuk ka paraqitur dokumentacion për të provuar sasinë e të ardhurave të realizuara, të cilat kanë shërbyer si burim për depozitimin e shumës 30.173 USD në llogarinë e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

11.14 Nga faktet e analizuara më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën

²³⁴ Subjekti ka paraqitur kopje të NUIS (në përgjigjet e pyetësorit nr. 3).

²³⁵ Subjekti ka paraqitur kopje të certifikatës së regjistrimit në organin tatimor (në përgjigjet e pyetësorit nr. 3).

²³⁶ Subjekti ka paraqitur kopje të certifikatës së regjistrimit në organin tatimor (në përgjigjet e pyetësorit nr. 3).

e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: *Mungon dokumentacioni ligjor justifikues për të provuar burimet e ligjshme financiare për depozitim të shumës 30.173 USD në llogarinë e bashkëshortit të subjektit në datën 9.3.2004.*

11.15 Në përgjigje të rezultateve të hetimit²³⁷, subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale nr. ***, datë 8.7.2024, të shtetasit K. C., i cili ka deklaruar se në datën 7.2.1998 bashkë me dy persona të tjerë është bërë pjesëtar i pasurisë ish-ndërmarrja e prodhimit të qilimave Korçë. Pas ndarjes së kësaj pasurie, vijon deklaruesi, ka përfituar një pjesë të objektit të ndërmarrjes dhe mbi këtë bazë ekonomike bashkëshortja e tij (e cila ndërruar jetë) është bërë ortakë e shoqërisë “****” e, më pas, bashkë me deklaruesin, në shoqërinë “****”. Më tej, deklaroi se nga këto aktivitete familja e tij ka krijuar fitime, por nuk ka ruajtur dokumentacion justifikues për shkak të kohës së largët mbi 24 vjet, parashikimeve të legjislacionin tatimor, që përcaktojnë detyrimin për ruajtjen e dokumentacionit deri në 5 vjet dhe për shkak se nuk ka qenë subjekt i detyrimit për deklarim. Gjithashtu, deklaroi se në lidhje me transfertën e shumës 30.000 USD, të kryer në vitin 2004 nga shtetasi K. Ç., ai e ka kryer për llogari të tij, për të cilën është shprehur në deklaratën e vitit 2010 dhe i qëndron atij deklarimi.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

11.16 Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore – arsyeton si vijon:

11.17 Pika 14²³⁸ e nenit 3 e ligjit nr. 84/2016 përcakton si persona të tjerë të lidhur ata persona të cilët kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, që rrjedh nga interesi pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi. Kolegji i Posaçëm i Apelit²³⁹ në praktikën e tij ka çmuar se përcaktimet e nenit 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016, shërbejnë për të përcaktuar rrethin e personave të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit në kontekst më të gjerë, si në funksion të deklarimit e verifikimit të çdo situatë të mundshme të konfliktit të interesit, pjesë gjithashtu e detyrueshme për kontroll si nga ILDKPKI-ja (shihni nenin 33, pika 5, shkronja “d” e ligjit nr. 84/2016), ashtu edhe nga vetë organet e rivlerësimit dhe në funksion të përcaktimit të detyrimit të subjekteve të rivlerësimit, për të provuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive të tyre, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Ky detyrim i subjektit të rivlerësimit rezulton i qartë, përcaktuar në rrethana të veçanta, kur këta persona të tjerë të lidhur të kenë si elemente të detyrueshme në marrëdhënien me subjektin e rivlerësimit një marrëdhënie huaje apo dhurimi, sipas parashikimit të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Pra, në këndvështrim të Kolegjit, një subjekt rivlerësimi do të ketë detyrimin të provojë ligjshmërinë e krijimit të pasurisë së personit tjetër të lidhur vetëm kur me të ka hyrë në një marrëdhënie huaje ose dhurimi, në raste të tjera

²³⁷ Email datë 15.7.2024.

²³⁸ Ligji 84/2016, neni 3: “14. “Persona të tjerë të lidhur janë personat fizikë ose juridikë, që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, komisionerin, gjyqtarin ose komisionerin publik që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi”.

²³⁹ Vendimet nr. 15/2019 (JR), datë 17.7.2019 dhe nr. 20/2020 (JR), datë 8.9.2020.

pasuria e personave të tjerë të lidhur kryesisht duhet të jetë objekt verifikimi në kontekst të verifikimit të gjendjes së konfliktit të interesave.

11.18 Në rastin konkret rezulton se: (i) bashkëshortja e shtetasit K. C., Sh. C., në datën 1.3.2004 i ka transferuar vajzës së saj M. C. shumën 30.000 USD dhe, sipas rregullores nr. ***, datë 30.7.2003, të Bankës së Shqipërisë “Për veprimtarinë valutore”²⁴⁰, nuk mund të transferonte jashtë shtetit një shumë të ngjashme brenda vitit kalendarik; (ii) shtetasi K. C. e ka deklaruar transferimin e shumës 30.000 USD në datën 9.3.2004 në llogarinë e vajzës së tij M. C. nëpërmjet llogarisë së shtetasit K. Ç. me anë të deklarates noteriale të datës 19.4.2010, e cila është jashtë procesit të rivlerësimit; (iii) transferimi i shumës 30.173 USD nëpërmjet llogarisë së bashkëshortit të subjektit ka shërbyer si garanci që vëllai i shtetases M. C. të pajisej me vizë nga Ambasada e SHBA-së; (iv) pas refuzimit të vizës nga Ambasada e SHBA-së në Tiranë të shtetasit E. C., shtetasja M. C. ka transferuar në llogari të babait të saj K. C. pranë Tirana Bank shumën 61.960 USD.

11.19 Sa më sipër, nuk krijohen dyshime që ndërmjet bashkëshortit të subjektit dhe shtetasit K. C. të ketë ekzistuar një marrëdhënie huaje apo dhurimi, marrëdhënie të cilat nuk konfirmohen as nga palët, sipas parashikimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Gjithashtu, nga hetimi administrativ nuk rezulton që subjekti të ishte në kushtet e konfliktit të interesit me shtetasin K. C.²⁴¹.

11.20 Sa më sipër, subjekti nuk ndodhet në kushtet e justifikimit të ligjshmërisë së krijimit të shumës 30.170 USD nga shtetasi K. C., sipas parashikimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

11.21 Në përfundim, Komisioni vlerëson se nuk konstatohen problematika lidhur me transferimin nga ana e shtetasit K. C. të shumës 30.170 USD në datën 9.3.2004 nëpërmjet llogarisë së bashkëshortit të subjektit.

12. Analiza financiare

12.1 Komisioni kreu analizën financiare duke konsideruar pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet për periudhën 1992 – 2016 për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur (subjektin, bashkëshortin dhe vajzën²⁴²). Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti deklaroi se që prej datës 24.8.2007, nëna e saj, shtetasja A. Q., ka jetuar me subjektin dhe familjen e saj deri në momentin që ndërroi jetë. Më tej, subjekti sqaroi se gjatë gjithë kësaj kohe ishte pensioniste dhe se kanë jetuar bashkë, pasi ajo ishte vetëm.

12.2 Komisioni i vuri në dispozicion subjektit edhe aneksin nr. 1 me emërtimin “Analiza financiare e detajuar”, si dhe aneksin nr. 2 me emërtimin “Metodika e analizës financiare”²⁴³.

12.3 Nga faktet e analizuara, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve

²⁴⁰ Neni 7: “2. Çdo individ ka të drejtë të transferojë lirisht nga brenda-jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë ekuivalenten në çdo monedhë tjetër të shumës deri në 3.5 milionë lekë, sipas kursit të ditës dhe brenda afatit kohor të një viti kalendarik”.

²⁴¹ Shkresë nr. *** prot., datë 8.3.2024, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

²⁴² Deri në vitin 2014, pasi është martuar dhe larguar jashtë vendit. Në deklaratën *Vetting* ka deklaruar se nuk disponon pasuri veçmas.

²⁴³ Në këtë analizë nuk u përfshi nëna e subjektit, pasi nuk kishte detyrim për deklarim referuar ligjit nr. 9049/2003. Nga analizimi i dokumentacionit të përcjellë nga ISSH-ja, rezulton se të ardhurat nga pensioni për periudhën 1.9.2007 – 31.12.2016 kanë qenë në shumën 1.561.561 lekë, pothuajse të barabarta me shpenzimet për të njëjtën periudhë, që rezultuan në shumën 1.565.918 lekë.

të hetimit, në lidhje me konstatimin se: (i) *Subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën -3.070.540 lekë në momentin e krijimit të pasurive, e detajuar si në vijim: periudha 1992 – 2003 – mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën -510.665 lekë për krijimin e kursimeve 20.000 USD, blerjen e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve gjatë periudhës 1992 – 2003; viti 2005 – mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën -167.813 lekë për krijimin e kursimeve prej 3.000 USD dhe kryerjen e shpenzimeve në datën 23.2.2005; viti 2008 – mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën -2.392.062 lekë për ndërtimin e banesës në Korçë, si dhe mungon dokumentacioni ligjor justifikues për të provuar burimet e ligjshme financiare për depozitimin e shumës 30.173 USD në llogarinë e bashkëshortit të subjektit në datën 9.3.2004.*

12.4 Në përfundim, në vijim të analizimit të pretendimeve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë prapësimeve, të trajtuara në paragrafët përkatës në këtë vendim, analiza financiare paraqitet në tabelën vijuese:

Tabela nr. 15 – Analiza financiare vjetore

Viti	Pasuri	Ndryshim likuiditete cash	Ndryshim likuiditete bankë	Të ardhurat	Detyrimet	Shpenzime	Diferenca për shpenzime	Balanca negative në momentin e krijimit të pasurive
1991-2003	-	2,702,850	-	5,781,927	-	3,337,797	- 258,720	- 258,720
2004	513,900	719,460	-	1,889,625	-	339,491	316,774	-
2005	250,000	- 3,422,310	3,765,684	1,422,655	-	363,671	465,610	- 167,813
2006	-	981,000	- 184,595	1,977,756	-	596,388	584,962	-
2007	1,552,150	86,150	624,927	2,016,517	1,082,790	627,351	208,730	-
2008	5,528,891	165,950	220,873	3,188,108	2,589,510	944,866	- 1,082,962	- 1,082,962
2009	1,795,500	- 758,172	- 1,357,117	1,766,648	-	1,432,054	654,383	-
2010	415,760	2,493,322	- 3,003,592	1,882,604	-	1,559,016	418,098	-
2011	-	- 2,612,060	2,306,273	1,877,016	-	1,829,563	353,240	-
2012	250,000	- 118,730	23,638	2,246,489	-	1,478,277	613,304	-
2013	-	200,000	- 11,587	2,250,922	-	1,354,460	708,048	-
2014	-	800,000	43,834	2,625,251	-	1,454,404	327,014	-
2015	2,200,000	- 1,000,000	41,145	2,028,568	-	448,552	338,871	-
2016	1,130,000	124,140	- 91,253	2,168,005	-	508,648	496,471	-
TOTAL	13,636,201	361,600	2,378,230	33,122,093	3,672,300	16,274,539	4,143,823	- 1,509,495

Konkluzion lidhur me vlerësimin e pasurisë

12.5 Në përfundim, Komisioni vlerësoi balancat negative në një vlerë totale prej -426.533 lekësh ndër vite për krijimin e depozitës në shumën 20.000 USD në momentin e krijimit të saj, në një hark kohor prej 18 vitesh, si dhe balanca negative të konstatuara për ndërtesën -1.082.962 lekë nga babai i subjektit, e vlerësuar me rrethanat e përshkruara më lart, në zbatim të parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit, u çmuan si balanca negative që nuk justifikojnë vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra dhe plotësojnë kushtet për konkludimin se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e një deklarimi të pamjaftueshëm sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

12.6 Bazuar në sa më sipër, subjekti i rivlerësimit Irena Çunoti ka arritur nivel të besueshëm për vlerësimin e pasurisë.

B. KONTROLLI I FIGURËS

1. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK, ish-DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim AKSIK-ja ka dërguar një raport me shënimin “Sekret”.

2. Komisioni kërkoi nga AKSIK-ja deklasifikimin e raportit mbi kontrollin e figurës së znj. Irena Çunoti, si dhe përditësimin e raportit me informacione shtesë. AKSIK-ja me shkresën nr. *** prot., datë 26.5.2023, ka përcjellë raportin për subjektin e rivlerësimit, të deklasifikuar pjesërisht me vendimin e KDZH-së nr. ***, datë 25.5.2023, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

3. Sipas raportit, subjekti i rivlerësimit, znj. Irena Çunoti: (a) ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar; (b) ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara nga vetë ajo në deklaratën për kontrollin e figurës; (c) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

4. Pavarësisht raportit të dërguar nga AKSIK-ja, Komisioni ka kryer hetim administrativ, prej të cilit rezulton se konstatimet e Grupit të Punës për kontrollin e figurës janë të sakta.

5. Komisioni vlerëson se: (a) subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratën për kontrollin e figurës në kohën e përcaktuar nga ligji nr. 84/2016; (b) nuk ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar; (c) nuk ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me kontrollin e figurës, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

6. Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues i Komisionit arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Irena Çunoti ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

1. Sipas nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, relatori përgatit relacionin për vlerësimin e aftësive profesionale mbështetur në raportin e inspektorëve, informacionin e marrë nga burime të tjera, si dhe në kriteret e vlerësimit të parashikuara në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve dhe akteve të tjera ligjore.

2. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka hartuar raportin e vlerësimit profesional për këtë subjekt.

3. Ky raport ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit:

a) aftësive profesionale;

- b) aftësive organizative;
- c) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale;
- ç) aftësive personale dhe angazhimit profesional.

Raporti është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit, së bashku me tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin, të paraqitura nga subjekti; (ii) pesë dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhënave nga burimet arkivore të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorisë së Përgjithshme dhe prokurorive të rretheve gjyqësore.

4. Nga shqyrtimi i të dhënave në dosjen personale konstatohet se subjekti i rivlerësimit Irena Çunoti është emëruar prokurore në Prokurorinë e Rrethit Korçë në datën 26.8.1987. Me vendimin nr. ***, datë 22.2.2019, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, është caktuar përkohësisht në detyrën e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Korçë dhe aktualisht vijon të ushtrojë detyrën në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

5. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Nga analiza e 3 dokumenteve ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe në pesë dosjet e shortuara, është konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka identifikuar normën ligjore të zbatueshme në të gjitha rastet. Analizon normën penale dhe procedurale penale të zbatueshme, duke e harmonizuar atë me faktin penal apo rrethanat që përcaktojnë masën e dënimit.

b) Arsyetimi ligjor

Bazuar në tri aktet e dorëzuara dhe në pesë dosjet e shortuara konstatohet se subjekti i rivlerësimit shfaq aftësi në arsyetimin ligjor të akteve. Aktet e arsyetuara janë të kuptueshme. Nga pikëpamja gjuhësore, subjekti i rivlerësimit përpiqet të respektojë rregullat e drejtshkrimit lidhur me përdorimin e të gjitha karaktereve të gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të aktit të përgatitur prej saj.

Hetimi i Komisionit

6. Pavarësisht raportit të dërguar nga KLP-ja, Komisioni kreu një hetim të pavarur në lidhje me tri dokumentet e përzgjedhura nga subjekti dhe me pesë dosjet e shortuara sipas një shorti objektiv. Pas analizimit të tyre u konstatuan problematika dhe u kërkuan shpjegime për dosjet nr. 2 dhe nr. 4 të shortuara, si vijon:

7. **Lidhur me dosjen nr. 2**, që i përket procedimit penal nr. ***, i regjistruar në datën 4.10.2013, për veprën penale “Ushtrimi pa licencë i veprimtarisë bankare”, parashikuar nga neni 170/c i Kodit Penal, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit për konstatimin se: *Subjekti ka marrë vendimin e datës 24.12.2013 për pushimin e procedimit penal nr. ***/2013, duke u bazuar vetëm në thëniet e personit të dyshuar dhe nuk ka vlerësuar faktet dhe provat e administruara gjatë hetimeve paraprake, nga të cilat ka rezultuar se:*

(i) shërbimet e policisë gjyqësore kanë pasur informacion paraprak se i dyshuari ushtronte veprimtarinë e paligjshme të këmbimit valutor; (ii) personi i dyshuar ka qenë më parë i dënuar për veprën penale të parashikuar nga neni 170/c i Kodit Penal; (iii) shtetasi S. S. ka deklaruar se i dyshuari i është afruar, duke i thënë nëse donte të këmbente valutë, i ka treguar për kursin

e euros dhe i ka dhënë të dyshuarit 10 euro për t'i thyer, deklarime që konfirmohen nga procesverbali i kapjes në flagrancë dhe nga dëshmia e punonjësit të policisë.

8. Në përgjigje të rezultateve të hetimit²⁴⁴ *lidhur me konstatimin në pikën i*), subjekti shpjegon se shërbimet e policisë gjyqësore nuk kanë pasur informacion paraprak se i dyshuari ushtronte veprimtarinë e paligjshme të këmbimit valutor. Po kështu, vijon subjekti, pas shfuqizimit të vendimit të pushimit të marrë nga ana e saj, Drejtoria e Policisë e Qarkut Korçë me shkresën e datës 17.2.2014 është shprehur se për këtë shtetas nuk është çelur apo arkivuar ndonjë dosje procedimi policor, ku të administrohen informacione policore.

Lidhur me konstatimin në pikën ii), subjekti shpjegon se nga verifikimet e kryera prej saj deri në momentin e përpilimit të vendimit të pushimit ka rezultuar se sipas vërtetimit të gjendjes gjyqësore të datës 28.10.2013, të lëshuar nga Prokuroria e Përgjithshme, rezulton se shtetasi N. S. ishte i padënuar. Në këto kushte, sqaron subjekti, nuk ka pasur të dhëna se ky shtetas ka qenë i dënuar.

Më tej, *lidhur me konstatimin e pikës iii*), shpjegon se konstatimi është i vërtetë vetëm në lidhje me deklaratimet e shtetasit S. S., por nuk mbështetet tek procesverbali i kapjes në flagrancë dhe në deklaratimin e punonjësit të policisë A. B., i cili vetëm ka konstatuar dhe parë ngjarjen, por jo të kenë dëgjuar bisedat e zhvilluara mes të dyshuarit dhe shtetasit S. S..

Në përfundim, subjekti shprehet se në marrjen e vendimit të pushimit ka analizuar dhe vlerësuar të gjitha veprimet hetimore të administruara dhe ka rezultuar që këmbimi valutor nuk ishte kryer, nuk kishte të dhëna që subjekti nën hetim të kryente një veprimtari të tillë dhe vlera e kartëmonedhës së kapur është vlerësuar shumë e vogël për konfigurimin e veprës penale. Gjithashtu, sqaron se ka marrë në konsideratë edhe sugjerimin e oficerit të policisë gjyqësore, i cili ka qenë pjesë e strukturave të policisë dhe ka disponuar edhe informacionet policore.

Analiza e Komisionit

9. Nga shqyrtimi i akteve të dosjes penale rezulton se në datën 3.10.2013, në vendin e quajtur *** Korçë, shtetasi N. S. ka pyetur shtetasin S. S. nëse kishte për të thyer euro ose dollarë, ndërsa ky i fundit ka pyetur se sa ishte kursi dhe i dyshuari i ka thënë se kursi ishte 140,5 lekë. Më pas, shtetasi S. S. i ka dhënë kartëmonedhën 10 euro dhe i dyshuari e ka marrë atë. Në këtë moment kanë ndërhyrë punonjësit e policisë dhe kanë bërë kapjen në flagrancë të shtetasit N. S.. Ka rezultuar se ky shtetas nuk është i pajisur me licencë për ushtrimin e aktivitetit tregtar për shkëmbimin e monedhave me vlerë. Subjekti me urdhrin e datës 4.10.2013 ka vendosur regjistrimin e procedimit penal për veprën penale “Ushtrimi pa licencë i veprimtarisë bankare”, e parashikuar nga neni 170/ç i Kodit Penal në ngarkim të shtetasit N. S.. Pas përfundimit të hetimeve, subjekti me vendimin e datës 24.12.2013 ka vendosur pushimin e procedimit penal, me arsyetimin se nuk ndodhemi përpara elementeve të veprës penale, parashikuar nga neni 170/ç i Kodit Penal, pasi personi nën hetim i ka marrë 10 euro shtetasit S. S. për ta ndihmuar, duke i çuar tek zyrat e këmbimit valutor për t'i konvertuar në lekë.

10. Drejtuesi i Prokurorisë me vendimin e datës 6.1.2014 ka vendosur shfuqizimin e vendimit të subjektit, me arsyetimin se pavarësisht pretendimeve të personit nën hetim se eurot i ka marrë me qëllim për t'i thyer në zyrë këmbimi valutor, ky pretendim bie poshtë nga deklaratimet e shtetasit S. S., deklaratimet e punonjësve të policisë, procesverbali i kapjes në flagrancë, informacionet e marra në rrugë operative, si dhe nga fakti që shtetasi N. S. ka qenë i dënuar më

²⁴⁴ Email datë 15.7.2024.

parë për veprën penale “Ushtrimi pa licencë i veprimtarisë bankare”, parashikuar nga neni 170/ç i Kodit Penal. Në vijim, drejtuesi i prokurorisë ka caktuar edhe detyrat përkatëse, si dhe ka vendosur zëvendësimin e subjektit me prokurorin G. S..

11. Në përfundim të hetimeve, prokurori G. S. ka vendosur marrjen të pandehur të shtetasit N. S. dhe dërgimin e çështjes në gjykatë për gjykim. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë me vendimin nr. ***, datë 25.6.2014, ka vendosur deklarinim fajtor të të pandehurit dhe, pas uljes së 1/3-ës së dënimit për shkak të gjykimit të shkurtuar, e ka dënuar me 200.000 lekë gjobë. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Korçë me vendimin nr. ***, datë 18.11.2014.

12. Komisioni arsyeton se nga ana objektive figura e veprës penale, e parashikuar nga neni 170/c²⁴⁵ i Kodit Penal, konsumohet me veprime aktive të kundërligjshme nëpërmjet ushtrimit të një veprimtarie të caktuar financiare, siç është këmbimi valutor pa pasur një licencë përkatëse nga organet kompetente shtetërore.

13. Në rastin konkret rezulton se në informacionin për referimin e veprës penale të datës 3.10.2013, oficeri i policisë gjyqësore ka pasqyruar faktin se në bazë të informacioneve të grumbulluara në rrugë operative shtetasi N. S. ushtronte aktivitetin e këmbimit valutor pa licencë, si dhe ka pasqyruar rrethanat e kapjes në flagrancë. Kjo do të thotë se deri në marrjen e vendimit të datës 24.12.2013 për pushimin e procedimit penal subjekti ishte i informuar nga policia gjyqësore se arrestimi i të dyshuarit është bërë bazuar në informacione të marra në rrugë operative. Megjithatë, në dosjen penale konstatohet edhe shkresa e datës 17.2.2014 e Drejtorisë së Policisë së Qarkut Korçë, që sqaron faktin që ndaj të dyshuarit nuk ka dosje ku administrohen informacionet policore, rrethanë e cila është sqaruar nga prokurori, të cilit i është kaluar dosja pas shfuqizimit të vendimit të subjektit.

14. Lidhur me shpjegimin e subjektit se *nuk ka pasur të dhëna që shtetasi i dyshuar ka qenë i dënuar më parë, pasi sipas certifikatës së gjendjes gjyqësore të datës 28.10.2013 figuronte i padënuar*, ky shpjegim nuk mbështetet në aktet e dosjes penale, pasi në dokumentin informacion për referimin e veprës penale të datës 3.10.2013 oficeri i policisë gjyqësore ka pasqyruar faktin se shtetasi N. S. ishte i dënuar më parë për veprën penale të parashikuar nga neni 170/c i Kodit Penal. Gjithashtu, ky fakt citohet edhe në procesverbalet e datave 3.10.2013 dhe 28.10.2013, ku pasqyrohet marrja në pyetje e shtetasit N. S. nga oficeri i policisë gjyqësore. Në këto kushte, subjekti ka qenë i informuar se i dyshuari ishte dënuar më parë dhe, pavarësisht certifikatës së gjendjes gjyqësore, duhej të verifikonte informacionin e policisë gjyqësore pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, sikurse ka vepruar prokurori të cilit i ka kaluar dosja më pas, i cili ka administruar vendimin nr. ***, datë 22.2.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

15. Lidhur me shpjegimin e subjektit se *deklarimet e shtetasit S. S. nuk konfirmohen nga procesverbali i kapjes në flagrancë edhe as nga deklarimi i punonjësit të policisë A. B.*, Komisioni konstaton se në procesverbalin e kapjes në flagrancë, të nënshkruar edhe nga i dyshuari, pasqyrohet se punonjësit e policisë në vendin e quajtur ***: “...kanë konstatuar një shtetas... rreth 65 vjeç... Në këtë kohë i është afruar një person tjetër, i cili mbante në dorë një

²⁴⁵ Kodi Penal, neni 170/c: “Ushtrimi i një ose disa veprimtarive financiare të ndryshme nga veprimtaria bankare, nga persona që nuk janë të licencuar për këtë qëllim, sipas legjislacionit bankar dhe/ose financiar në fuqi, dënohet me gjobë ose burgim gjer në tre vjet.
Po kjo vepër, kur i ka shkaktuar pasoja të rënda interesave shtetërore ose atyre të shtetasve, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet”.

kartëmonedhë 10 euro, të cilën më pas ia jep shtetasit të përshkruar më sipër për ta këmbyer... ”. Injëjti përshkrim pasqyrohet edhe në deklarinimin e punonjësit të policisë A. B.. Gjithashtu, edhe shtetasi S. S. ka deklaruar se i dyshuari i është afruar, duke i thënë nëse donte të këmbente valutë, i ka treguar për kursin e euros dhe i ka dhënë të dyshuarit 10 euro për t’i thyer. Sa më sipër, përputhet deklarimi i shtetasit S. S. me deklarinimet e të dyshuarit dhe të punonjësit të policisë në procesverbalin e kapjes në flagrancë.

16. Lidhur me shpjegimin e subjektit se *“në vendimin tim ndërmjet të tjerave jam mbështetur edhe në sugjerimin e oficerit të policisë gjyqësore”*, ky shpjegim nuk është i mjaftueshëm, pasi sipas parashikimeve kushtetuese dhe të Kodit të Procedurës Penale është prokurori subjekti që ushtron ndjekjen penale, bën hetime, kontrollon hetimet paraprake dhe ngre akuzën në gjykatë.

17. Sa më lart, Komisioni çmon se subjekti nuk ka paraqitur shpjegime të mjaftueshme për të kundërshtuar rezultatet e hetimit.

18. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, duke u bazuar në tregues të tillë, si aftësia e përgjithshme për të mbledhur provat e kërkuara me ligj dhe për të interpretuar ligjin, kritere që parashikohen në pikën 2 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.

19. Lidhur me dosjen nr. 4, që i përket procedimit penal nr. ***, i regjistruar në datën 28.10.2014 për veprën penale “Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike”, të parashikuar nga neni 137/1 i Kodit Penal, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit për konstatimin se: *(i) Subjekti ka marrë vendimin e datës 23.1.2015 për marrjen në cilësinë e të pandehurit të shtetasit S. Q. për veprën penale “Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike”, parashikuar nga neni 137 i Kodit Penal në kushtet kur:*

- I pandehuri nuk ka konsumuar elementin e anës objektive të figurës së veprës penale “Vjedhja”, pasi: (a) veprimet e tij nuk janë kundër vullnetit të furnizuesit, pasi furnizuesi e ka shfaqur vullnetin e tij që i pandehuri të furnizohej me energji elektrike, duke pranuar aplikimin e tij për lidhjen e kontratës së furnizimit; (b) ekziston prezumimi ligjor se ndërmjet palëve është lidhur kontrata e furnizimit me energji elektrike, për sa kohë që furnizuesi e ka pranuar aplikimin e të pandehurit për lidhjen e kontratës së energjisë elektrike dhe nuk e ka refuzuar;

- Në rastin konkret mungon elementi i anës subjektive i figurës së veprës penale, qëllimi i përfitimit të paligjshëm, pasi i pandehuri ka kërkuar nga furnizuesi të lidhë kontratën e furnizimit të energjisë elektrike dhe, sipas parashikimeve ligjore, prezumohet se ndërmjet palëve ekzistonte kontrata e furnizimit me energji elektrike, rrethana që vërtetojnë se qëllimi i pandehurit ishte lidhja e ligjshme e kontratës së furnizimit me energji elektrike.

Subjekti me vendimin e datës 23.1.2015 për marrjen në cilësinë e të pandehurit të shtetasit S. Q. për veprën penale “Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike”, parashikuar nga neni 137 i Kodit Penal, ka cenuar parimin e ligjshmërisë të parashikuar nga nenet 1 dhe 2 të Kodit Penal në lidhje me nenin 290 të Kodit të Procedurës Penale, në kushtet kur fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, pasi në rastin konkret nuk janë konsumuar të gjitha elementet e figurës së veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri”.

20. Në përgjigje të rezultateve të hetimit²⁴⁶, subjekti shpjegon se i pandehuri pavarësisht se ka aplikuar për furnizimin me energji elektrike dhe ka paguar tarifën për lidhjen e kontratës, kjo

²⁴⁶Email datë 15.7.2024.

nuk do të thotë që i lind e drejta për të lidhur vetë në rrjet energjinë elektrike për të furnizuar banesën e tij, pa pritur që lidhja të bëhet nga personat e autorizuar nga OSHEE-ja. Gjithashtu, energjia që ka marrë, është një energji që nuk është matur, faturuar e, për rrjedhojë, nuk është paguar nga i pandehuri.

20.1 Më pas, subjekti shpjegon se në vendimmarrjen e saj ka vlerësuar të gjitha provat e administruara në raport me ligjin, përfshirë edhe qëndrimin pohues e pendesën e të pandehurit, deklaratimet e tij për mënyrën se si ai ka vepruar dhe qëllimin që ai ka pasur, si dhe sugjerimin e oficerit të policisë gjyqësore. Më tej, shprehet se vendimi i saj për marrjen e shtetasit të dyshuar në cilësinë e të pandehurit, dërgimin e çështjes në gjyq, por edhe konkluzionet përfundimtare janë miratuar nga zv.drejtuari dhe drejtuesi i Prokurorisë, si dhe vendimmarrja e saj është vlerësuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, prokurori i Apelit dhe Gjykata e Apelit Korçë.

Analiza e Komisionit

21. Nga shqyrtimi i akteve të dosjes penale konstatohet se në datën 23.10.2014 punonjësit e OSHEE-së Korçë, në bashkëpunim me Komisaratin e Policisë Korçë, kanë ushtruar kontroll në banesën e shtetasit S. Q., fshati ***, Korçë dhe kanë gjetur lidhjen e paligjshme të energjisë elektrike nëpërmjet dy përcjellësve elektrikë të zhveshur, në formë gripi, që janë takuar me linjën elektrike. Personi nën hetim ka deklaruar se para një viti ka përfunduar ndërtimin e banesës së re dhe ka bërë pagesën në OSSHE për lidhjen e kontratës së re që në datën 3.3.2014, por, për shkak se punonjësit e OSSHE-së nuk po vinin për të lidhur kontratën përkatëse, fillimisht ka marrë energji elektrike nga fqinji, dhe tri ditë përpara ngjarjes ka bërë lidhjen tek shtylla e energjisë elektrike. Për të vërtetuar deklarin e tij, i dyshuari ka paraqitur në organin e akuzës mandatin për pagesën e kontratës së energjisë elektrike të datës 3.3.2014.

22. Pas përfundimit të hetimeve, subjekti ka marrë vendimin e datës 23.1.2015 që shtetasi S. Q. të merret në cilësinë e të pandehurit, duke e akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 137/1 i Kodit Penal, si dhe ka marrë vendimin për dërgimin e çështjes në gjyq. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë me vendimin nr. ***, datë 23.2.2015, ka vendosur deklarin fajtor të të pandehurit dhe, pasi i ka zbritur 1/3-at e dënimit, e ka dënuar përfundimisht me 1 muaj burgim. Gjykata e Apelit Korçë me vendimin nr. ***, datë 21.7.2015, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit dhe pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim me kusht për 18 muaj, duke mbajtur gjatë kësaj kohe kontakte me zyrën e shërbimit të provës.

23. Sa më sipër, rezulton se në rastin konkret kërkesa e subjektit për gjykimin e të pandehurit dhe dënimin e tij është pranuar në të gjitha shkallët e gjykimit e, për pasojë, Komisioni çmon se problematikat e konstatuara në rezultatet e hetimit kanë lidhje me korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe me logjikën e subjektit, të cilat sipas pikës 4 të nenit 73 të ligjit nr. *** nuk janë kompetencë e organeve të rivlerësimit.

24. Në përfundim, Komisioni vlerëson se nuk konstatohen problematika që kanë lidhje me procesin e rivlerësimit të aftësive profesionale, parashikuar nga neni 73 i ligjit nr. 96/2016.

25. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Rezulton se subjekti i rivlerësimit Irena Çunoti gjatë periudhës së rivlerësimit ka trajtuar gjithsej 584 çështje penale. Nga analiza e pesë çështjeve të përzgjedhura me short, qëndrimi i saj është

brenda afateve të parashikuara në ligjin procedural penal. Nga analizimi i të dhënave konstatohet se subjekti i rivlerësimit është efikase dhe efektive.

b) Aftësia për të kryer procedurat hetimore/gjyqësore

Subjekti i rivlerësimit, prokurorja Irena Çunoti, merr pjesë në gjykim si palë, duke përfaqësuar Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë. Konstatohet se tregon profesionalizëm në gjykim dhe qëndrimin që mban për çështjet në gjykim.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, konstatohet se dosjet janë të administruara rregullisht, materialet janë të vendosura në rend kronologjik, duke pasqyruar faktin penal, qëndrimin e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë dhe disponimin e gjykatës.

26. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Nga aktet e përzgjedhura prej vetë subjektit, si dhe nga dosjet e hedhura në short, ka rezultuar se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, prokurorja Irena Çunoti, dhe nga pesë dosjet e vëzhguara sipas shortit, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit. Në asnjërin prej dokumenteve dhe dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak anësie të dokumentuar. Gjithashtu, asnjë prej tri dokumenteve ligjore dhe pesë dosjet e vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në tri dokumentet ligjore dhe në aktet e pesë dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera, që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

27. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësia e komunikimit

Në tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe në pesë dosjet e përzgjedhura me short vihet re se komunikimi është në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën e Prokurorisë, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Në periudhën e rivlerësimit, subjekti ka deklaruar se është angazhuar në aktivitete profesionale (seminare/trajnime) të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës, duke marrë pjesë në 2 seminare/trajnime në total. Formularit të vetëvlerësimit i është bashkëlidhur vërtetim i lëshuar nga Shkolla e Magjistraturës, si dhe kopje të certifikatave të trajnimeve për pjesëmarrjen në aktivitetet trajnuese të Programit të Trajnimit Vazhdues në Shkollën e Magjistraturës.

Subjekti i rivlerësimit Irena Çunoti ka deklaruar në formular pjesëmarrjen në 27 trajnime të kryera disa brenda dhe disa jashtë periudhës së rivlerësimit nga agjenci të ndryshme të ligjit. Formularit të vetëvlerësimit i janë bashkëlidhur kopje të certifikatave, që të vërtetojë kryerjen e këtyre trajnimeve.

Të dhëna nga burimet arkivore (kallëzime, ankesa, masa disiplinore, vlerësime)

28. Nga të dhënat që ndodhen në Sektorin e Burimeve Njerëzore pranë Prokurorisë së Përgjithshme dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, nuk rezulton që ndaj subjektit Irena Çunoti të jetë marrë ndonjë masë disiplinore.

29. Për subjektin e rivlerësimit Irena Çunoti janë administruar informacionet si vijon:

- Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar Tiranë (ish-Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda) ka konfirmuar se ndaj subjektit të rivlerësimit Irena Çunoti është regjistruar kallëzimi penal nr. ***, i vitit 2020, për të cilin pas verifikimeve është vendosur mosfillimi i procedimit penal.

- Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan²⁴⁷ konfirmon se ndaj subjektit Irena Çunoti është regjistruar materiali kallëzues nr. ***, datë 13.9.2023, i ardhur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, për të cilin prokurori i çështjes ka vendosur mosfillimin e procedimit penal.

30. Drejtoria e Koordinimit Institucional në Prokurorinë e Përgjithshme ka dërguar informacion se për subjektin e rivlerësimit nuk janë paraqitur ankesa.

Hetimi i Komisionit

31. Komisioni, pasi shqyrtoi materialet e kallëzimit penal nr. ***, viti 2016, të ish-Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, si dhe procedimin penal nr. ***, viti 2016, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë²⁴⁸, për shkak të të cilit është bërë regjistrimi i kallëzimit penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, nuk konstaton problematika që lidhen me vlerësimin e aftësive profesionale.

32. Në vijim, Komisioni shqyrtoi materialin kallëzues nr. ***, datë 13.9.2023, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan²⁴⁹, si dhe materialin kallëzues nr. ***/2023 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë (pjesë e dosjes së Prokurorisë Elbasan), për shkak të të cilit është bërë regjistrimi i kallëzimit penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe i kërkoi shpjegime subjektit, si vijon:

²⁴⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 3.2.2024.

²⁴⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 12.3.2024.

²⁴⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 28.2.2024.

33. Lidhur me materialin kallëzues nr. */2023**, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit për konstatimin se: *Subjekti në marrjen e vendimit të datës 13.7.2023 për mosfillimin e procedimit penal nr. ***/2023 nuk ka analizuar:*

i) Veprimet e shtetasit K. H. në raport me elementet e figurës së veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, në kushtet kur nga aktet e administruara rezultoi se:

- *prokura e datës 4.12.2021 e shtetasit K. H. është revokuar në datën 8.6.2023;*
- *shtetasi K. H. është njoftuar për revokimin e prokurës;*
- *pavarësisht dijenisë për revokimin e prokurës, shtetasi K. H. ka paraqitur përpara noterit publik prokurën e shfuqizuar për nënshkrimin e kontratës së dhurimit të datës 19.6.2021;*
- *sipas raportit të rivlerësimit të dorëzuar nga kallëzuesi, shoqërisë “H. K.” sh.p.k. i është shkaktuar një dëm në vlerën 1.429.000 euro.*

ii) Veprimet e noterit dhe të nëpunësve të ASHK-së në raport me elementet e figurës së veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, i parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, për sa kohë që nga aktet e administruara ka rezultuar se:

- *në prokurën e përgjithshme të datës 4.12.2021 nuk përcaktohet e drejta e shtetasit K. H. të lidhë kontrata dhurimi;*
- *noteri ka lidhur kontratën e dhurimit të datës 19.6.2023, pavarësisht se në prokurën e përgjithshme shtetasi K. H. nuk ka pasur tagrin e dhurimit;*
- *nëpunësit e ASHK-së nuk kanë verifikuar ligjshmërinë e kontratës së dhurimit të datës 19.6.2023;*
- *si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve të noterit dhe nëpunësve të ASHK-së, shoqërisë “***” sh.p.k. i është shkaktuar një dëm i rëndë i interesave të ligjshëm pasurorë.*

iii) Arsyetimi i subjektit se “pretendimet e kallëzuesve për falsifikim dhe nënshkrimin e aktit noterial në kushtet e kanoşjes duhet të vërtetohen fillimisht gjatë gjykimit civil e më pas është gjykata që i paraqet aktet për ndjekje penale në prokurori”, nuk bazohet në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale dhe në jurisprudencën e Gjykatës së Lartë.

34. Në përgjigje të rezultateve të hetimit²⁵⁰, subjekti shpjegon se gjatë hetimeve të procedimit penal nr. ***/2023 nuk i është vënë në dispozicion revokimi i prokurës së shtetasës D. H. në datën 8.6.2023, në SHBA. Në lidhje me ekzistencën e këtij akti noterial, vijon subjekti, është vënë në dijeni vetëm nga konstatimi i Komisionit, pasi në kallëzimet e shtetasve A. e D. H., në pyetjen e tyre në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale, por edhe në pyetjen e shtetasit K. H., nuk citohet se ekziston revokimi i prokurës së datës 8.6.2023. Po kështu, vazhdon shpjegimin subjekti, edhe në dokumentacionin që kallëzuesi i ka vënë në dispozicion organit procedues, nuk ndodhet akti noterial revokim prokure i datës 8.6.2023. Në këto kushte, shpjegon se vendimin e mosfillimit të procedimit penal e ka marrë vetëm mbi bazën e materialit kallëzues që dispononte.

34.1 Gjithashtu, subjekti shpjegon se lidhur me faktin që shoqëria “***” sh.p.k. ka depozituar padi civile në gjykatë, duke kërkuar anulimin e kontratës së dhurimit të datës 19.6.2023, është vënë në dijeni vetëm nga rezultatet e hetimit, pasi nuk ka pasur dijeni.

²⁵⁰ Email datë 15.7.2024.

34.2 Lidhur me konstatimet e pikave ii) dhe iii) për mosanalizimin e veprimeve të noterit dhe të nëpunësve të ASHK-së në raport me elementet e figurës së veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, dhe për sa i përket arsytimit të vendimit jo në përputhje me Kodin e Procedurës Penale dhe jurisprudencën e Gjykatës së Lartë, subjekti nuk ka dhënë shpjegime.

Analiza e Komisionit

35. Nga shqyrtimi i akteve të dosjes penale nr. ***/2023, rezulton se shtetasi A. H. ka paraqitur kallëzim penal, duke pretenduar se shoqëria “****” sh.p.k., me administrator dhe ortak të vetëm shtetasen D. H., bashkëshorten e tij, ka ndërtuar një kompleks rezidencial në ***, Pogradec dhe ka në pronësi disa apartamente. Për shkak se familjarisht jeton në SHBA, bashkëshortja e tij ka pajisur me prokurë të përgjithshme të datës 4.12.2021 babain e tij, shtetasin K. H., duke i dhënë tagrat e shitjes, dhënies me qira të apartamenteve që dispononte shoqëria etj. Në vijim, kallëzuesi ka deklaruar se prokura që ka pasur babai i tij është revokuar në Amerikë në datën 8.6.2023 dhe për këtë revokim shtetasi K. H. është vënë në dijeni nga ana e tij dhe e bashkëshortes së tij. Por, pavarësisht revokimit të prokurës, vijon kallëzuesi, babai i tij me kontratën e dhurimit të datës 19.6.2023, pa dijeninë e tij dhe të bashkëshortes, i ka dhuruar vëllait të tij D. H. 11 pasuri të shoqërisë “****” sh.p.k. Në këto kushte, kallëzuesi i ka kërkuar babait të tij të bëjë revokimin e kontratës, pasi në të kundërt do të bëjë kallëzim në polici. Gjithashtu, ka pretenduar se vëllai i tij D. H. e ka kërcënuar dhe i ka kërkuar që të mos vijë në Shqipëri dhe të mos i afrohet kompleksit dhe se ka rrahur pastruesen e kompleksit, si dhe ka kërcënuar shtetasin e punësuar nga kallëzuesi për shitjen e apartamenteve.

36. Në vijim, konstatohet se ka paraqitur kallëzim penal edhe shtetasja D. H., bashkëshortja e kallëzuesit A. H., e cila ka akuzuar shtetasin D. H. për kërcënimin e bashkëshortit dhe djalit të saj, si dhe për faktin që bashkë me vjehrrin K. H. i kanë grabitur pronat me vlerë 1.2 milionë euro.

37. Për shkak të këtij konflikti, kallëzuesi dhe bashkëshortja e tij janë pajisur me urdhër mbrojtjeje me vendimet e datave 27.6.2023 dhe 14.7.2023 të Gjykatës së Shkallës së Parë Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

38. Në përfundim të hetimeve, subjekti me vendimin e datës 13.7.2023 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, me arsytimin se nuk gjenden elemente të veprës penale “Dhuna në familje”, parashikuar nga neni 130/a/2 i Kodit Penal, pasi kjo vepër penale, përveç elementeve të tjera nga ana objektive, kërkon seriozitetin që duhet të ketë kërcënimi/kanosja. Më pas, arsyeton se familja H. ka mosmarrëveshje në lidhje me pronat, kryerjen e veprimeve juridike mbi këto prona, si dhe lidhur me përdorimin e prokurës nga babai i tyre dhe sipas subjektit ky është një konflikt që zgjidhet në rrugë ligjore civile duke iu drejtuar gjykatës. Për sa i përket akteve juridike të kryera në zyrën noteriale, subjekti arsyeton se nëse kallëzuesit pretendojnë se njëra palë nuk ka nënshkruar dhe ka firmosur dikush tjetër në kontratën përkatëse apo akti noterial është kryer në kushtet e kanosjes, atëherë ato duhet të deklarohen të pavlefshme nga gjykata e, më pas, nëse nga hetimi gjyqësor rezulton se ndodhemi përpara ndonjë vepre penale (si falsifikim dokumentesh), atëherë gjykata duhet t’i paraqesë aktet në prokurori për ndjekje penale. Ndërsa për sa i përket pretendimeve se shtetasi D. H. ka rrahur pastruesen e kompleksit dhe ka kërcënuar shtetasin e punësuar nga kallëzuesi për shitjen e apartamenteve, subjekti ka arsyetuar se organi i akuzës nuk mund të investohet për ndjekjen e veprës penale të rrahjes, pasi

është e drejtë e të dëmtuarit të paraqesë kërkesë në gjykatë për të vërtetuar akuzën dhe të kërkojë shpërblimin e dëmit.

39. Kundër vendimit të subjektit kallëzuesi ka paraqitur ankim në gjykatë. Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë me vendimin nr. ***²⁵¹, datë 16.10.2023, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të mosfillimit të procedimit penal²⁵².

40. Komisioni, pavarësisht faktit që veprimet e subjektit janë analizuar në kuadër të një procesi gjyqësor penal, duke çmuar se të njëjtat fakte mund t'u shërbejnë në mënyrë të pavarur procedimeve të ndryshme, të cilat ndjekin qëllime të ndryshme²⁵³, ka analizuar qëndrimin dhe sjelljen profesionale të subjektit si prokurore që ka ndjekur çështjen penale.

41. Komisioni arsyeton se vepra penale “Falsifikimi i dokumenteve”, e parashikuar nga neni 186²⁵⁴ i Kodit Penal, mund të konsumohet në dy mënyra: ose duke vepruar drejtpërsëdrejti mbi dokumentin, duke i bërë shtesa a tjetërsime të paligjshme, apo me çdo veprim tjetër material një dokumenti ekzistues të mëparshëm. Në këtë rast do të ndodhemi përpara falsifikimit “material”; apo në mënyrën tjetër që konsiston në falsifikimin e përmbajtjes së dokumentit, pa prekur formën e tij, duke ndryshuar konceptin dhe brendinë e dokumentit. Gjithashtu kemi të bëjmë me falsifikim “intelektual”, që cenon pjesën përshkruese-dëftuese të dokumentit²⁵⁵. Pra, paraqitja e rrethanave të rreme në një dokument nga autori i këtij dokumenti përbën një rreth prej formave të anës objektive, me të cilat manifestohet krimi “Falsifikimi i dokumenteve”, i parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal²⁵⁶. Megjithatë, është e rëndësishme të bëhet një dallim midis falsifikimit të dokumentit të përpiluar nga një privat dhe atij të përpiluar nga personi që ka për detyrë të lëshojë dokumentin. Një shtetas nuk ka detyrim, por vullnet për të përpiluar një dokument/akt privat. Thënë kjo, një karakteristikë tjetër e falsifikimit të një akti/dokumenti privat ka të bëjë me shkaktimin e pasojës. Kështu, në rastin e dokumentit privat, falsifikimi do të quhet i perfeksionuar kur nga ky falsifikim hartuesi i dokumentit ka pasur përfitim (jo detyrimisht ekonomik) të padrejtë apo u ka shkaktuar dëme personave të tretë, pra jo thjesht nga evidentimi i përmbajtjes së rreme pa pasoja.

42. Në rastin konkret rezulton se kallëzuesja D. H., në cilësinë e administratores së shoqërisë “***” sh.p.k., me prokurën e përgjithshme të datës 4.12.2021 ka emëruar si përfaqësues të përgjithshëm shtetasin K. H., duke i dhënë të drejtën e shitjes dhe dhënies me qira të pronave të shoqërisë. Më pas, në datën 8.6.2023, përpara noterit publik në SHBA ka revokuar prokurën e datës 4.12.2021 dhe bashkë me bashkëshortin e saj kanë pretenduar se e kanë njoftuar shtetasin e mësipërm. Gjithashtu, konstatohet se pavarësisht revokimit të prokurës, shtetasi K. H. ka përdorur prokurën e revokuar të datës 4.12.2021 për nënshkrimin e kontratës së dhurimit të datës 19.6.2023, duke i dhuruar djalit të tij (vëllait të kallëzuesit) D. H. 11 pasuri të shoqërisë

²⁵¹ Të administruar nga sistemi gjykata.gov.al/

²⁵² Me arsyetimin se: “... debatet e konfliktet mes të dy vëllezërve, kallëzuesit dhe të kallëzuarit, si dhe bashkëshortes së kallëzuesit dhe të kallëzuarit janë zhvilluar nëpërmjet komunikimeve telefonike. Pavarësisht kërcënimeve e fyerjeve që i kallëzuari ka bërë kundër kallëzuesit për çështjen e pronave, këto debate janë bërë në distancë. Në rrethana të tilla që kanosja nuk është e shoqëruar me përdorimin e ndonjë sendi të aftë për të shkaktuar pasojën kriminale, që është vdekja apo plagosja e personit, veprimet e kallëzuarit nuk i përmbajnë elementet e veprës penale “Kanosja”, parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal”.

²⁵³ Vendim nr. 30, datë 18.11.2019 (JR) (pg.52), i Kolegjit.

²⁵⁴ Kodi Penal, neni 186: “Falsifikimi ose përdorimi i dokumenteve të falsifikuara dënohet me burgim deri në tre vjet. Kur kjo veprë kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë apo ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet”. Kur falsifikimi bëhet nga personi që ka për detyrë të lëshojë dokumentin, dënohet me burgim nga një vit deri në shtatë vjet”.

²⁵⁵ Vendim nr. ***, datë 12.7.2017, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

²⁵⁶ Vendim nr. ***, datë 21.3.2023, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

“****” sh.p.k., të cilat sipas raportit të rivlerësimit të dorëzuar nga kallëzuesi përllëgariten në vlerën 1.429.000 euro.

43. Lidhur me shpjegimin e subjektit se *për ekzistencën e aktit noterial të datës 8.6.2023 për revokimin e prokurës së datës 4.12.2021 në emër të shtetasit K. H. është vënë në dijeni vetëm nga konstatimi i Komisionit*, vërehet se në përmbajtjen e ankimit ndaj vendimit të subjektit ankuesi ka cituar se bashkëshortja e tij në datën 8.6.2023 i ka revokuar prokurën e përgjithshme shtetasit K. H. në SHBA e më pas e ka njoftuar këtë të fundit për revokimin e prokurës. Gjithashtu, bashkëlidhur ankimit kallëzuesi citon dhe provat, ku ndërmjet të tjerave pasqyrohen dhe revokimet e prokurave. Ky shkak i ankimit pasqyrohet edhe në vendimin nr. ***, datë 16.10.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

44. Sa më lart, Komisioni çmon se subjekti në marrjen e vendimit të datës 13.7.2023 për mosfillimin e procedimit penal nr. ***/2023 nuk ka analizuar veprimet e shtetasit K. H. në raport me elementet e figurës së veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve” (në formën e falsifikimit të dokumentit privat), parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, për sa kohë që nga hetimi rezulton se: (i) prokura e datës 4.12.2021 e shtetasit K. H. është revokuar në datën 8.6.2023; (ii) kallëzuesit kanë pretenduar se shtetasi K. H. është njoftuar për revokimin e prokurës; (iii) pavarësisht dijenisë për revokimin e prokurës, shtetasi K. H. ka paraqitur përpara noterit publik prokurën e shfuqizuar (rrethana të rreme) për nënshkrimin e kontratës së dhurimit të datës 19.6.2023; (iv) sipas raportit të rivlerësimit të dorëzuar nga kallëzuesi i shoqërisë “****” sh.p.k., i është shkaktuar një dëm në vlerën 1.429.000 euro.

45. Në vijim, Komisioni konstaton se me prokurën e përgjithshme të datës 4.12.2021 shtetasja D. H., në cilësinë e administratores së shoqërisë “****” sh.p.k., ka emëruar si përfaqësues të përgjithshëm shtetasin K. H., duke i përcaktuar dhe tagrat e përfaqësimit, ku ndërmjet të tjerave i ka dhënë të drejtën e shitjes dhe dhënies me qira të pronave të shoqërisë, ndërsa e drejta e dhurimit nuk parashikohet në prokurë. Pavarësisht se në prokurën e mësipërme shtetasit K. H. nuk i është dhënë e drejta të lidhë kontrata për dhurimin e pasurive të shoqërisë “****” sh.p.k., noteri ka hartuar kontratën e dhurimit të datës 19.6.2023, duke i kaluar pasuritë e shoqërisë në pronësi të shtetasit D. H.²⁵⁷. Gjithashtu, rezulton se edhe ASHK-ja ka vijuar regjistrimin e pasurive të parashikuara në kontratën e dhurimit në pronësi të shtetasit D. H..

46. Sa më sipër, Komisioni çmon se subjekti nuk ka analizuar veprimet e noterit dhe të nëpunësve të ASHK-së në raport me elementet e figurës së veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248²⁵⁸ i Kodit Penal, për sa kohë që nga hetimi ka rezultuar se: (i) në prokurën e përgjithshme të datës 4.12.2021 nuk përcaktohet e drejta e shtetasit K. H. të lidhë kontrata dhurimi; (ii) noteri ka lidhur kontratën e dhurimit të datës 19.6.2023, pavarësisht se në prokurën e përgjithshme shtetasi K. H. nuk ka pasur tagrin e dhurimit; (iii) nëpunësit e ASHK-së nuk kanë verifikuar ligjshmërinë e kontratës së dhurimit të datës 19.6.2023; (iv) si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve të noterit dhe nëpunësve të ASHK-së, shoqërisë “****” sh.p.k. i është shkaktuar dëmtimi i rëndë i interesave të ligjshëm pasurorë.

²⁵⁷ I cili me disa kontrata dhurimi pasuritë e mësipërme (10 pasuri) i ka kaluar në pronësi të motrës së tij, shtetases Adelina Fjolla.

²⁵⁸ Neni 248: “Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a e mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mospërbushje të rregullt të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, kur i kanë sjellë atij ose personave të tjerë përfitime materiale ose jomateriale të padrejta a kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë, nëse nuk përbën veprë tjetër penale, dënohet me burgim deri në shtatë vjet”.

47. Për sa i përket arsyetimit të subjektit se nëse kallëzuesit pretendojnë se njëra palë nuk ka qenë për të nënshkruar dhe ka firmosur dikush tjetër në kontratën përkatëse apo akti noterial është kryer në kushtet e kanosjes, atëherë ato duhet të deklarohen të pavlefshme nga gjykata dhe, më pas, nëse nga hetimi gjyqësor rezulton se ndodhemi përpara ndonjë vepre penale (si falsifikim dokumentesh), atëherë aktet duhet t'i paraqesë gjykata në prokurori për ndjekje penale, Komisioni arsyeton se procesi penal dhe civil në lidhje me falsitetin e dokumentit, si rregull mund të zhvillohet në mënyrë të pavarur. Gjykata civile, njëlloj sikurse gjykata penale, është e pajisur nga ligji procedural me mjetet për të hetuar në lidhje me falsitetin e dokumentit në mënyrë autonome. Këto dy gjykime, për nga destinimi dhe qëllimi që ndjekin, janë autonome dhe të pavarura nga njëra-tjetra. Gjykimi civil ka karakter objektiv, pasi si rregull ka në qendër dokumentin dhe zhvlehtësimin e tij. Ndërsa gjykimi penal është me karakter subjektiv, me qëllim primar identifikimin e autorit për vënien e tij para përgjegjësisë penale²⁵⁹. Duke ndjekur qëllime të ndryshme, dy proceset janë të pavarura dhe autonome në raport me njëra-tjetrën²⁶⁰.

48. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, duke u bazuar në aftësinë e prokurores për të interpretuar ligjin, kriter që parashikohet në pikën 2 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.

DENONCIME

49. Në Komision, për subjektin e rivlerësimit Irena Çunoti janë administruar 4 denoncime nga publiku, nga të cilat, referuar nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, i kërkoi shpjegime për 2 denoncime, si vijon:

50. Në lidhje me denoncimin anonim nr. *** prot., datë 18.6.2020, në të cilin akuzohet subjekti se fshehu vrasësin e shtetasit Ll. K., Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime për konstatimin se:

i) Subjekti ka marrë vendimin e datës 14.12.2016 për pushimin e procedimit penal nr. ***, viti 2016, me arsyetimin se nuk ndodhemi përpara veprës penale "Vrasja me dashje", të parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal pa kryer më parë veprimet e nevojshme hetimore, pasi:

- nuk ka marrë në pyetje shtetasin G. H. lidhur me rrethanat e ngjarjes, në kushtet kur vëllai i viktimës ka deklaruar se ky shtetas e ka marrë në telefon dhe i ka thënë që natën e ngjarjes ka parë dy persona që lëviznin, por nuk i ka dalluar se kush ishin;
- nuk ka urdhëruar kryerjen e aktit të ekspertimit kriminalistik për qartësimin e mekanizmit të ngjarjes në kushtet kur: (a) janë konstatuar dy njolla gjaku jo shumë larg njëra-tjetrës, njëra në asfalt (rrugë) dhe tjetra në trotuar; (b) ndërmjet njollave të gjakut janë konstatuar pika gjaku; (c) viktima është gjetur nga shërbimet e policisë i shtrirë me kokën në trotuar dhe trupi në asfalt; (ç) duket jo i logjikshëm fakti që viktima mund të jetë rrëzuar në asfalt dhe ka pësuar plagë në pjesën e sipërme të kokës e për më tepër të ketë pësuar dy plagë në pjesë të ndryshme të kokës;
- nuk ka zhvilluar hetime ndaj shtetasve T. M. dhe O. D. në kushtet kur: (a) vëllai i viktimës ka deklaruar se shtetasit G. H. i ka thënë se atë natë (kur ka ndodhur ngjarja) ka parë dy persona që lëviznin, por nuk i ka dalluar se cilët ishin; (b) ishin personat e fundit që e kanë

²⁵⁹ Vendim nr. ***, datë 25.11.2020, i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

²⁶⁰ Vendimet nr. ***, datë 2.10.2008 dhe nr. ***, datë 15.3.2018, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

parë/janë shkëmbyer me viktimën pak minuta përpara se të konstatohej i shtrirë në rrugë në gjendje të rënduar.

ii) *Subjekti ka marrë vendimin e datës 14.12.2016 për pushimin e procedimit penal nr. ***, viti 2016, duke u bazuar në rezultatet e aktit shtesë të ekspertimit mjekoligjor në kushtet kur:*

- *konkluzioni i aktit shtesë të ekspertimit se dëmtimet e viktimës janë shkaktuar me mjet të fortë mbretës, me “mundësinë më të madhe” me mekanizmin rënie-përplasje, është i paqartë, pasi nuk saktëson se nga cilat elemente faktike rrjedh ky konkluzion, qoftë edhe hipotetik;*
- *konkluzioni i aktit shtesë të ekspertimit të viktimës se i janë shkaktuar dëmtime me mjet të fortë mbretës me “mundësinë më të madhe” me mekanizmin rënie-përplasje, është kontradiktor për sa i përket mjetit të përdorur dhe pasojës së ardhur, pasi, nëse dëmtimet e viktimës do të vinin nga rënia/përplasja në asfalt, atëherë dëmtimet do të shkaktoheshin me mjet të fortë jombretës me mekanizmin e përplasjes me forcë në sende të forta.*

51. Në përgjigje të rezultateve të hetimit²⁶¹, subjekti jep këto shpjegime: *Lidhur me konstatimet e pikës i), shtetasi G., i njohur me mbiemrin H. (nga S.), nuk ka mbiemrin H., por ka mbiemrin N., çka del nga përmbajtja e deklarimeve të tyre të cilët janë të afërm, djalë halle e djalë daje. Pra, ky veprim i konstatuar si i pakryer është kryer dhe rezulton se G. H. është i njëjti person me emrin G. N..*

51.1 Në vijim, shpjegon se është i vërtetë konstatimi i Komisionit se nga ana e saj nuk është urdhëruar kryerja e aktit të ekspertimit kriminalistik për qartësimin e mekanizmit të ngjarjes, por sqaron se është vlerësuar e mjaftueshme kryerja e një akti të dytë ekspertimi mjekoligjor. Gjithashtu, shpjegon se situata e përshkruar në relacionin e rezultateve të hetimit lidhur me mekanizmin e ngjarjes nuk lë vend për të ngritur dyshime për një vrasje të mundshme.

51.2 Në lidhje me konstatimin në shkronjën “ç”, shpjegon se sipas dy akteve mjekoligjore të administruara në dosje, por edhe sipas procesverbalit të këqyrjes së kufomës, shoqëruar me tabelën fotografike, dy plagët në kokë nuk janë në pjesë të ndryshme të kokës, por janë në të njëjtën pjesë dhe shumë afër njëra-tjetrës dhe lidhen me konfigurimin e buzës së trotuarit ku është përplasur koka e viktimës, çka sipas subjektit konfirmon faktin që viktima është rrëzuar dhe ka dëmtuar veten në njërin anë të kokës. Këto lloje plagësh, siç është shpjeguar edhe në aktin e dytë të ekspertimit mjekoligjor, me mundësi shumë të mëdha nuk janë rrjedhojë e goditjes, por rrjedhojë e mekanizmit të rrëzim-përplasjes, sepse në rast se do të kishim goditje me mjet të fortë mbretës nga një person i jashtëm, pa diskutim që do të kishim përveç thyerjes së kockës se kokës edhe shtypje të saj, ku kjo e fundit mungon dhe është e pamundur një konfigurim i tillë i plagës.

51.3 Në lidhje me hetimet ndaj shtetasve T. M. dhe O. D., sqaron se këta shtetas janë pyetur dhe kanë dhënë deklaratimet e tyre, por nuk kishte asnjë *indicie* apo dyshim, sado të vogël, për të kryer hetime ndaj tyre. Ata janë pyetur si të gjithë personat e tjerë në lidhje me këtë procedim penal.

51.4 Lidhur me konstatimet e pikës ii), subjekti shpjegon se akti shtesë i ekspertimit mjekoligjor nuk është kontradiktor për sa i përket mjetit të përdorur dhe pasojës së ardhur. Në rastin konkret, rruga, asfalti dhe trotuari janë sende apo mjete të forta mbretëse dhe jo prerëse, pasi është një

²⁶¹ Email datë 15.7.2024.

dallim shumë i madh midis mjetit mbretës dhe mjetit prerës dhe karakteristikat e plagëve që shkaktojnë e ato janë krejtësisht të ndryshme.

51.5 Në përfundim, subjekti shprehet se në pushimin e procedimit penal ka marrë në konsideratë vlerësimin e të gjitha provave të administruara në raport me ligjin dhe sugjerimin e oficerit të policisë gjyqësore. Gjithashtu, shpjegon se vendimi i marrë është diskutuar dhe miratuar nga zv.drejtuesi dhe drejtuesi i prokurorisë dhe kjo vendim i saj i është njoftuar vëllezërve të viktimës të cilët nuk e kanë ankimuar.

Analiza e Komisionit

52. Nga shqyrtimi i akteve të dosjes penale, rezulton se në datën 3.8.2016, në orën 1:05, në qytetin e Korçës, shërbimet e policisë kanë konstatuar shtetasin Ll. K. të shtrirë në rrugë, pa ndjenja dhe të gjakosur. Janë njoftuar shërbimet mjekësore, të cilat e kanë marrë të dëmtuarin dhe e kanë shoqëruar në spital. Për shkak të gjendjes së rënduar, i dëmtuari është transportuar në Spitalin e Traumës në Tiranë. Më pas, në datën 11.8.2016, shtetasi Ll. K. ka ndërruar jetë në Tiranë. Bazuar në orientimin e zv.drejtuesit të prokurorisë, subjekti ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal për veprën penale “Vrasja me dashje”, të parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal.

53. Gjatë hetimeve është pyetur vëllai i viktimës, shtetasi S. K., i cili ndër të tjera ka deklaruar se i ka kërkuar djalit të dajës, shtetasit G. H., të interesohet se çfarë mund t’i ketë ndodhur vëllait të tij dhe të nesërmen ai e ka marrë në telefon dhe i ka thënë se atë natë ka parë dy persona që lëviznin, por nuk i ka dalluar se cilët ishin. Në përfundim të dëshmisë, ky shtetas ka deklaruar se vëllain e tij e kanë goditur. Dhe vëllai tjetër i viktimës, shtetasi K. K., ka deklaruar se mendon se vëllain e kanë goditur. Gjithashtu, shtetasi H. L. ka deklaruar: *“Mora vesh në lagje se viktimën e kanë goditur”*. Janë marrë edhe dëshmitë e personave me të cilët ka qenë i shoqëruar viktimja para momentit kur ka ndodhur ngjarja (shtetasit A. V. dhe A. J.), të cilët kanë deklaruar se kanë qenë me të duke pirë deri në orën 23:30, por viktimja nuk ishte në gjendje të rënduar.

54. Në vijim është administruar akti i ekspertimit mjekoligjor i datës 11.8.2016, i cili ka konkluduar se në trupin e viktimës janë konstatuar trauma të kokës dhe indit trunor dhe plagë në pjesën e buzës së sipërme, dëmtime të cilat janë shkaktuar me mjet të fortë mbretës dhe shkak i vdekjes ka qenë trauma kafko-trunore me mekanizmin e komës së rëndë të trurit. Subjekti, bazuar në pretendimet e familjarëve se viktimja ka pasur dhe dëmtime të tjera, ka marrë vendimin e datës 22.9.2016 për kryerjen e ekspertimit mjekoligjor, duke kërkuar nga eksperti t’u përgjigjet pyetjeve nëse në trupin e viktimës janë konstatuar dëmtime të tjera, përveç atyre të mësipërme dhe nëse dëmtimet e konstatuara mund të jenë shkaktuar nga goditja e tij nga persona të tjerë apo gjatë rrëzimit. Në përgjigje, në aktin e ekspertimit mjekoligjor nr. ***, dërguar organit të akuzës me shkresën e datës 24.11.2016, ekspertët, pasi u janë referuar konstatimeve të pasqyruara në aktin e ekspertimit mjekoligjor të datës 11.8.2016, kanë konkluduar se dëmtimet e pasqyruara në aktin mjekoligjor të datës 11.8.2016 janë shkaktuar me mjet të fortë mbretës me “mundësinë më të madhe” me mekanizmin rënie-përplasje.

55. Në përfundim, subjekti me vendimin e datës 14.12.2016 ka vendosur pushimin e procedimit penal, me arsyetimin se nuk ndodhemi përpara veprës penale për të cilën është regjistruar procedimi, pasi nga hetimi nuk rezultoi që persona të tjerë të kenë vepruar ndaj viktimës duke e goditur, me pasojë shkaktimin e vdekjes. Sipas subjektit, nga hetimet ka rezultuar se viktimja

nuk kishte konflikte, nuk mbante me vete lekë, por konsumonte shumë pije alkoolike, të cilat i ka konsumuar dhe ditën e ngjarjes. Në vijim, subjekti arsyeton se viktima çalonte, pasi kishte operuar edhe një rën këmbë, fakte të cilat kanë çuar rrëzimin e tij në trotuar dhe dëmtimin, mundësi e cila saktësohet në aktin mjekoligjor. Nuk rezulton që ndaj këtij vendimi të jetë bërë ankim nga familjarët e viktimës, pavarësisht njoftimit të vendimit.

56. Nga analizimi i fakteve të mësipërme, Komisioni çmon se subjekti ka kryer veprimet e nevojshme hetimore për sqarimin e mekanizmit të ngjarjes, duke urdhëruar kryerjen e dy akteve të ekspertimit mjekoligjor dhe problematikat e konstatuara në rezultatet e hetimit kanë të bëjnë me vlerësimin e provave, rrethana që lidhen me korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, të cilat sipas pikës 4 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2017 nuk janë në kompetencën e organeve të rivlerësimit.

57. Në përfundim, Komisioni vlerëson se nuk konstatohen problematika që kanë lidhje me procesin e rivlerësimit të aftësive profesionale, parashikuar nga neni 73 i ligjit nr. 96/2016.

58. Në lidhje me denoncimin anonim nr. * prot., datë 25.1.2021,** në të cilin akuzohet subjekti për paaftësi në ndjekjen e çështjes penale me të pandehur shtetasin A. F., Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime për konstatimin se: (i) *Subjekti në vendimin e datës 31.12.2015 për marrjen të pandehur të shtetasit A. F. për veprat penale “Vrasja me dashje” dhe “Kanosja”, parashikuar nga nenet 76, 84 të Kodit Penal, nuk ka vlerësuar rrethanën_cilësuese që viktima ishte i mitur sipas parashikimeve të nenit 79 të Kodit Penal;* (ii) *Subjekti nëpërmjet cilësimit juridik të veprës penale, sipas nenit 76 dhe jo sipas nenit 79, shkronja “a” e Kodit Penal, ka favorizuar të pandehurin në caktimin e masës së dënimit.*

59. Në përgjigje të rezultateve të hetimit²⁶², subjekti shpjegon se konstatimi i Komisionit është i drejtë, pasi ngjarja ka ndodhur midis dy personave të mitur dhe ky gabim nuk është konstatuar as nga eprorët e saj dhe as nga gjykata e shkallës së parë, që shqyrtoi çështjen në themel. Më tej, sqaron se, pavarësisht këtij gabimi, nuk e pranon konstatimin në lidhje me favorizimin e autorit të mitur, pasi neni 76 i Kodit Penal parashikon si masë dënimit me burgim nga 10-20 vjet dhe ajo ka kërkuar maksimumin, 20 vjet burgim. Po të krahasohet me nenin 79, shkronja “a” e Kodit Penal, vijon shpjegimin subjekti, që parashikon dënimin nga 20 vjet gjer në burgim të përjetshëm, referuar rastit konkret kur subjekti i veprës penale është i mitur, dënimi i tij do të ishte nga 20 deri 25 vjet burgim, por që nuk mund të shkohej në maksimum dhe përsëri do të kishim të njëjtin dënim.

Gjithashtu, shpjegon se është vetë organi procedues që pas dhënies së vendimit të gjykatës ka konstatuar këtë parregullsi dhe ka paraqitur ankim, i cili fatmirësisht është pranuar nga Gjykata e Lartë dhe çështja është kthyer për rigjykim, ku në rigjykim, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, do të jetë ajo si prokurore në përfaqësimin e akuzës, duke e formuluar atë sipas nenit 79, shkronja “a” e Kodit Penal, pasi titullari i institucionit e ka caktuar përsëri në rigjykimin e kësaj çështjeje penale.

Analiza e Komisionit

60. Nga shqyrtimi i akteve të dosjes penale, rezulton se në datën 1.10.2015, në fshatin ***, Korçë, ka ndodhur një grindje midis shtetasve A. F. dhe R. K., të dy të mitur, të cilët po luanin me lojëra *playstation*. Në një moment, shtetasi R. K. i ka marrë levën e lojës shtetasit A. F. dhe,

²⁶² Email datë 15.7.2024.

gjatë debatit, shtetasi A. F. i ka thënë shtetasit R. K. “*Pse ma more levën gjithë presion*”. Më pas kanë ndërhyrë shokët dhe nuk i kanë lënë të vazhdonte grindja mes tyre. Shtetasi R. K., së bashku me shokët e tij, kanë dalë jashtë lokalit dhe kanë shkuar tek një ndërtesë afër qendrës së fshatit. Pak më vonë, shtetasi A. F. ka shkuar tek vendi ku ndodhej viktimja dhe e ka goditur me thikë shtetasin R. K.. Gjithashtu, shtetasi A. F. i kishte thënë shtetasit A. P., kur ky i fundit po mundohej t’i ndante “*Ik më lësho, se do të të çaj dhe ty*”, duke i treguar thikën në dorë. Më pas, shtetasi A. F. është larguar nga vendi i ngjarjes, kurse të pranishmit e tjerë e kanë çuar të dëmtuarin në spital, por ai kishte ndërruar jetë. Gjatë kontrollit të policisë, shtetasi A. F. është gjendur i fshehur në lokalit të shtetasit L. K. dhe, me gjithë orientimin e tij, nuk është bërë e mundur gjetja e armës së ftohtë me të cilën është bërë vrasja.

61. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë me vendimin e datës 5.10.2015 ka vendosur pranimin e kërkesës së subjektit për vleftësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit “Arresti në burg”. Në përfundim të hetimeve, subjekti me vendimin e datës 31.12.2015 ka vendosur marrjen të pandehur të shtetasit A. F., duke e akuzuar për veprat penale “Vrasja me dashje” dhe “Kanosja”, të parashikuara nga nenet 76 dhe 84 të Kodit Penal dhe dërgimin e çështjes për gjykim.

61.1 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë me vendimin nr. ***, datë 4.2.2016, ka vendosur deklarinimin fajtor të të pandehurit për veprat penale të parashikuara nga nenet 76 dhe 84 të Kodit Penal dhe, pas zbritjes së masës së dënimit me 1/3 për shkak të gjykimit të shkurtuar, duke e dënuar përfundimisht me 6 vite burgim. Në fund të vendimit është bërë shënimi se vendimi ka marrë formë të prerë në datën 15.2.2016. Kundër vendimit të gjykatës në datën 17.3.2016 ka bërë ankim babai i viktimës, i cili ka pretenduar se gjykimi është zhvilluar në kundërshtim me ligjin, pasi nga ana e prokurorisë duhet ngritur akuza në bazë të nenit 79, shkronja “a” e Kodit Penal, “Vrasja për shkak të cilësive të veçanta të viktimës”. Gjithashtu, rezulton se ankim ndaj vendimit të mësipërm ka paraqitur edhe drejtuesi i prokurorisë, me arsyetimin se si organi procedues, ashtu edhe gjykata kanë gabuar në kualifikimin e veprës penale për të cilën është akuzuar i pandehuri, pasi sipas tij viktimja ishte i mitur dhe, në këto kushte, kjo vepër penale, ndonëse është kryer nga një i mitur, duhet të ishte kualifikuar sipas veprës penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, e parashikuar nga neni 79, shkronja “a” e Kodit Penal.

61.2 Gjykata e Apelit Korçë me vendimin nr. ***, datë 10.11.2016, ka vendosur mospranimin e ankimit të organit të akuzës, me arsyetimin se është paraqitur jashtë afatit ligjor dhe mospranimin e ankimit të shtetasit M. K. si të bërë nga një person i palegjitimuar. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit ka bërë rekurs në Gjykatën e Lartë Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Korçë. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë²⁶³ me vendimin nr. ***, datë 7.7.2022, ka vendosur prishjen e vendimit të mësipërm të Gjykatës së Apelit Korçë dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në të njëjtën gjykatë.

61.3 Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm²⁶⁴ me vendimin e datës 30.10.2023 ka vendosur “Prishjen e vendimit nr. ***, datë 4.2.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe kthimin e akteve për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, me tjetër trup gjykues”, me arsyetimin se në kushtet kur organi i akuzës ka kërkuar ndryshimin e cilësimit ligjor të veprës penale, duke kërkuar që i pandehuri të gjykohet për veprën penale të parashikuar nga neni 79, shkronja “a” e Kodit Penal dhe cilësimi

²⁶³ Shkresë nr. *** prot., datë 28.3.2024, e Gjykatës së Lartë.

²⁶⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 9.5.2024.

ligjor është më i rëndë se ai i sjellë për gjykim për shkak të llojit të dënimit që parashikon, ky cilësim i saktë i faktit penal duhet të gjykohet me rregullat që parashikon ligji procedural mbi akuzat e reja dhe të pandehurit duhet t'i ofrohet mundësia e ushtrimit të të drejtës së mbrojtjes në mënyrë efektive. Referuar vendimit të mësipërm të Gjykatës së Apelit, i pandehuri gjatë kohës që zhvillohej gjykimi ishte liruar nga vuajtja e dënimit me burg dhe nuk gjendej.

62. Referuar fakteve të mësipërme, Komisioni arsyeton se në kreun II të Kodit Penal janë parashikuar veprat penale kundër personit, krimet kundër jetës, të cilat kanë për objekt marrëdhënien juridike posaçërisht të mbrojtur nga ligji penal, që ka të bëjë me jetën si një e drejtë natyrore dhe themelore, nga e cila rrjedhin të gjitha të drejtat e personit. Në seksionin I të këtij kreu janë përfshirë krimet kundër jetës të kryera me dashje, ku ndërmjet të tjerave, në nenin 79 parashikohet “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”. Në thelb kemi të bëjmë me veprën penale të vrasjes me dashje, ku përveç dashjes së pasojës, bëjnë pjesë dhe rrethanat cilësuese të parashikuara në mënyrë të shprehur nga neni 79²⁶⁵ i Kodit Penal. Vrasja e cilësuar sipas nenit 79, shkronja “a” e Kodit Penal, kërkon që viktima e veprës penale të ketë një rrethanë të posaçme cilësuese, që e dallon nga subjekti pasiv i përgjithshëm, të jetë i mitur që nuk ka mbushur moshën 18 vjeç. Në vijim të këtij arsytimi, vërehet se cilësimi i veprës penale sipas nenit 79 ka lidhje me cilësitë e viktimës dhe jo të autorit të saj, i cili mund të jetë madhor apo i mitur. Fakti që autori është i mitur, është rrethanë që vlerësohet në caktimin e dënimit ndaj tij dhe jo në cilësimin e veprës penale. Gjithashtu, rezulton se masa e dënimit e parashikuar për kryerjen e veprës penale “Vrasja me dashje” ndryshon me masën e dënimit që parashikohet për kryerjen e veprës penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, pasi në rastin e parë neni 76 i Kodit Penal parashikon dënimin e autorit me burgim nga 10 gjer në 20 vjet, ndërsa në rastin e dytë dënimin me burgim jo më pak se 20 vjet ose me burgim të përjetshëm.

63. Nga shqyrtimi i akteve të dosjes penale konstatohet se sipas printimit të datës 10.1.2015, nga sistemi elektronik i regjistrimit të gjendjes civile të familjes së shtetasit M. K., viktima R. K. ishte i datëlindjes 26.4.1998, dhe në kohën kur ka ndodhur ngjarja nuk kishte mbushur moshën 18 vjeç (ishte 17 vjeç). Gjithashtu, rezulton se dhe autori i veprës penale në kohën kur ka ndodhur ngjarja ka qenë i mitur (i datëlindjes 8.10.1999).

64. Sa më sipër, Komisioni çmon se subjekti në marrjen e vendimit të datës 31.12.2015 për marrjen të pandehur të shtetasit A. F. për veprat penale “Vrasja me dashje” dhe “Kanosja”, të parashikuara nga nenet 76 dhe 84 të Kodit Penal, nuk ka vlerësuar rrethanën cilësuese se viktima ishte i mitur sipas parashikimeve të nenit 79 të Kodit Penal, duke kërkuar dënim më të butë për të pandehurin, rrethanë e cila ka sjellë si pasojë lirimin e tij gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor, e më pas mosgjetej e tij duke iu shmangur drejtësisë.

65. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në aftësinë e prokurores për të interpretuar ligjin në raport me faktet dhe dokumentet e administruara në dosjen penale, kriter që parashikohet në pikën 2 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.

²⁶⁵ Kodi Penal, neni 79: “Vrasja me dashje e kryer: a) ndaj të miturit; b) ndaj personit me mangësi fizike ose psikike, të sëmurë rëndë ose shtatzënë, kur cilësitë e viktimës janë të dukshme ose të njohura; c) shfuqizuar; ç) ndaj kallëzuesit, dëshmitarit, të dëmtuarit ose palëve të tjera ndërgjyqëse; d) më shumë se një herë; dh) kundër dy ose më shumë personave; e) në mënyrë të tillë që i shkakton mundime të veçanta viktimës; ë) në mënyrë të rrezikshme për jetën e shumë personave, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm”.

KONSTATIME TË TJERA

66. Komisioni u njoh nëpërmjet mediave elektronike²⁶⁶ lidhur me çështjen penale në ngarkim të shtetasit O. I. për dhunimin e gruas shtatzënë dhe administroi nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë²⁶⁷ procedimin penal nr. ***, viti 2012, dhe i kërkoi subjektit shpjegime për konstatimin se: (i) *Subjekti në ndjekjen e procedimit penal nr. *** të vitit 2012 nuk ka kryer veprimet e nevojshme hetimore, pasi nuk ka urdhëruar kryerjen e aktit shtesë të ekspertimit mjekoligjor për të vërtetuar faktin nëse ndërprerja e shtatzënisë e të dëmtuarës ka ardhur si pasojë e dëmtimeve të pësuarra nga veprimet e dhunshme të të pandehurit;* (ii) *Subjekti ka favorizuar të pandehurin në caktimin e një mase dënimi më të butë nga gjykata, pasi: (a) nuk ka kryer veprimet hetimore për vërtetimin e faktit nëse ndërprerja e shtatzënisë e të dëmtuarës ka ardhur si pasojë e veprimeve të dhunshme të pandehurit; (b) nuk ka parashtruar përpara gjykatës faktin që veprat penale të konsumuara nga i pandehuri janë kryer në rrethana rënduese, pasi e dëmtuara ka qenë shtatzënë.*

67. Në përgjigje të rezultateve të hetimit²⁶⁸, subjekti jep këto shpjegime: *Lidhur me mosrealizimin e aktit mjekoligjor shtesë të viktimës për vërtetimin e shkaqeve të ndërprerjes së shtatzënisë, shpjegon se ky konstatim nuk qëndron, për këto arsye: (i) kanë kaluar 3 javë nga ngjarja deri në momentin e ndërprerjes së shtatzënisë, çka presupozon se nuk ekziston asnjë lidhje mes dhunës së ushtruar nga i pandehuri ndaj viktimës dhe ndërprerjes së shtatzënisë; (ii) nga materialet e dosjes rezulton se para ngjarjes viktimja ka pasur një shtatzëni të shoqëruar me infeksione, të cilat e kanë detyruar të marrë trajtim mjekësor për to dhe kjo logjikisht të çon në konkluzionin e mungesës së lidhjes ndërmjet ndërprerjes së shtatzënisë dhe ngjarjes së dhunshme; (iii) edhe sikur të ekzistonte ndonjë lidhje mes ngjarjeve, përsëri nuk ndryshonte kualifikimi i veprës penale dhe njëkohësisht kjo ndërprerje shtatzënie i është ekspozuar gjykatës si rrethanë dhe është pranuar nga gjykata.*

Lidhur me konstatimin se ka favorizuar të pandehurin, subjekti shpjegon se ky konstatim është i gabuar dhe i pavërtetë, pasi në konkluzionet përfundimtare të miratuara edhe nga drejtuesi i prokurorisë e të dorëzuara në gjykatë, ka kërkuar 5 vite burgim për të dyja veprat penale të parashikuara nga nenet 88/1 dhe 130/a/1 të Kodit Penal, ndërkohë që gjykata ka arsyetuar se dënimi i kërkuar nga prokuroria konsiderohet i rëndë dhe ka ulur dënimin me 3 vjet e 6 muaj për të dyja veprat penale, dhe në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale e ka dënuar përfundimisht të pandehurin me 2 vjet e 4 muaj burgim. Pra, sipas vendimit të gjykatës, shpjegon subjekti, dënimi i kërkuar prej saj me 5 vjet burgim është vlerësuar i ashpër e, për pasojë, konstatimi i Komisionit nuk bazohet as në shifra matematikore dhe as në arsyetimin e vendimit të gjykatës.

Analiza e Komisionit

68. Nga shqyrtimi i akteve të dosjes penale, rezulton se shtetasi O. I. dhe shtetasja R. I. janë bashkëshortë. Nga martesja e tyre kanë një fëmijë të mitur. Marrëdhëniet midis dy bashkëshortëve kanë qenë përgjithësisht të mira, me përjashtim të mosmarrëveshjeve midis R. dhe prindërve të të pandehurit, pasi R. nuk donte të jetonte së bashku me ta. Në vitin 2012, pas kthimit nga Italia, R. nuk ka pranuar të shkojë në familjen e bashkëshortit, por ka shkuar në shtëpinë e prindërve të saj, ndërsa fëmija ka qëndruar me bashkëshortin dhe prindërit e tij. Në

²⁶⁶ https://www.standard.al/***/dhunoi-gruan-shtatzene-ne-muajin-e-5-te-denohet-vetem-2-4-vjet-burg/

²⁶⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 12.3.2024.

²⁶⁸ Email datë 15.7.2024.

datën 12.12.2012, shtetasi O. I. ka shkuar për të biseduar me R., si dhe kanë diskutuar për të shkuar në konsultore, me qëllim që R. të bënte një analizë mjekësore, pasi ishte shtatzënë dhe ka rezultuar se kishte infeksion. Gjatë debatit, i pandehuri i është drejtuar R. me fjalët “do të vras”, “do të mbys” etj., ka marrë një dru tek soba e zjarrit dhe e ka goditur në pjesë të ndryshme të trupit dhe në kokë. Nga goditjet, R. është gjakosur dhe është rrëzuar në dysheme. Në ato momente ka ardhur nëna e R., shtetasja F. B., e cila sapo ka parë vajzën të shtrirë dhe të gjakosur, ka shtyrë të pandehurin, por ai ka reaguar duke e goditur edhe atë. Nëna e viktimës ka dalë menjëherë nga dhoma dhe ka njoftuar policinë. Autori nuk ka tentuar të largohet nga vendi i ngjarjes dhe, pasi kanë shkuar punonjësit e policisë, e kanë shoqëruar në komisariat, kurse e dëmtuara është çuar në spital për të marrë ndihmë mjekësore.

69. Sipas aktit të ekspertimit mjekoligjor të datës 13.12.2012, shtetasës R. I. i janë konstatuar dëmtime në kokë, pjesën e qafës, krahërorit, nga prapa, hematoma në kapakët e syve e të shpërndara në trup, dëmtime që janë karakterizuar të rënda dhe të rrezikshme për jetën në momentin e ngjarjes. Ndërsa sipas aktit të ekspertimit mjekoligjor të shtetasës F. B., dëmtimet që ajo ka pësuar hyjnë në kategorinë e atyre që kanë shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë deri në 9 ditë. Gjithashtu, rezulton se të afërmit e të pandehurit (motra dhe nëna e tij) kanë deklaruar se i pandehuri nuk vuante nga ndonjë çrregullim mendor. Më pas rezulton se sipas deklarimeve të datës 10.1.2013 të shtetasve F. B. dhe R. I. ka rezultuar se kjo e fundit në datën 4.1.2013 ka dështuar, pasi ishte me dhimbje të forta barku dhe me plasje ujërash.

70. Me vendimin e datës 7.2.2013 subjekti ka marrë të pandehur shtetasin O. I., duke e akuzuar për veprat penale “Plagosja e rëndë” dhe “Dhuna në familje”, të parashikuara nga nenet 88/1 e 130/a, paragrafi 1 i Kodit Penal. Në parashtrimet e datës 8.4.2013 drejtuar gjykatës, subjekti ka kërkuar deklarinimin fajtor të të pandehurit për veprat penale të parashikuara nga neni 88, paragrafi 1, dhe neni 130/a, paragrafi 1 i Kodit Penal dhe pas bashkimit të dënimeve ka kërkuar dënimin përfundimisht me 5 vite burgim. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë me vendimin nr. ***, datë 29.4.2013, ka vendosur deklarinimin fajtor të të pandehurit për kryerjen e veprës penale të mësipërme dhe, pas bashkimit të dënimeve e pasi i ka ulur 1/3 e dënimit për shkak të gjykimit të shkurtuar, e ka dënuar përfundimisht me 2 vjet e 4 muaj burgim. Kundër vendimit ka paraqitur ankim i pandehuri, i cili në seancën gjyqësore të datës 10.7.2013 përpara Gjykatës së Apelit e ka tërhequr atë e, për pasojë, Gjykata e Apelit Korçë me vendimin nr. ***²⁶⁹, datë 10.7.2013, ka vendosur mospranimin e ankimit për shkak të heqjes dorë nga ankimi.

71. Referuar fakteve të mësipërme, rezulton se shtetasja R. I. në momentin kur ka ndodhur ngjarja ka qenë në muajin e pestë të shtatzënisë dhe kjo gjë dihej nga autori i ngjarjes. Gjithashtu, përpara mbylljes së hetimeve paraprake dhe marrjes si të pandehur të shtetasit O. I., e dëmtuara ka deklaruar se në datën 4.1.2013 ka dështuar, pasi kishte dhimbje të forta barku dhe plasje ujërash. Sa më sipër, në vijim të ndjekjes logjike të hetimit, nuk rezulton që subjekti të ketë urdhëruar kryerjen e aktit të ekspertimit mjekoligjor shtesë, për të vërtetuar faktin nëse ndërprerja e shtatzënisë ka ardhur si pasojë e dëmtimeve të pësuar nga veprimet e dhunshme të të pandehurit, por e ka parashtruar këtë fakt vetëm në diskutimin përfundimtar përpara gjykatës. Shpjegimet e dhëna nga subjekti në përgjigje të rezultateve të hetimit nuk përfshihen në njohuritë juridike, por bazohen në hamendësime jashtë dijenisë objektive dhe funksionale të saj, për sqarimin e të cilave është i nevojshëm mendimi i ekspertëve të fushës mjekoligjore.

²⁶⁹ Të administruar nga sistemi gjykata.gov.al/

72. Lidhur me konstatimin e rezultateve të hetimit se *subjekti ka favorizuar të pandehurin në caktimin e një mase dënimi më të butë nga gjykata*, Komisioni, duke marrë në konsideratë shpjegimet e subjektit, rrethanat e çështjes dhe mungesën e indicieve për favorizimin e të pandehurit, çmon se subjekti ka dhënë shpjegime të mjaftueshme për kundërshtimin e rezultatit të hetimit.

73. **Në përfundim**, Komisioni vlerëson se subjekti ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, duke u bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj dhe për të interpretuar ligjin, kritere që parashikohen në pikën 2 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.

Përfundimet e Komisionit në lidhje me rivlerësimin e aftësive profesionale

74. Pavarësisht sa më sipër, në raport me të gjitha çështjet e analizuara, Komisioni, duke marrë në konsideratë numrin e çështjeve të analizuara në raport me çështjet e ndjekura nga subjekti i rivlerësimit për periudhën 8.10.2013 – 8.10.2016 (gjithsej 584 çështje penale), faktin se nuk konstatohen raste të gjykimeve me gabime thelbësore dhe serioze, bazuar edhe në parimin e proporcionalitetit, vlerëson se konstatimet e pasqyruara në kriterin e rivlerësimit të aftësive profesionale nuk plotësojnë kushtin e parashikuar nga pika 4 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, që subjekti i rivlerësimit të konsiderohet “i papërshtatshëm”.

75. Në përfundim, trupi gjykues i Komisionit, në vlerësimin tërësor të kriterit të rivlerësimit të aftësive profesionale, vlerëson se subjekti i rivlerësimit Irena Çunoti është “e aftë”, pasi ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve dhe është efiçente në masë të pranueshme, sipas parashikimeve të shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në provat që disponon për vlerësimin e pasurisë, vlerësimin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe në bindjen e brendshme, vendosi që subjekti i rivlerësimit Irena Çunoti, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, të konfirmohet në detyrë.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 58 dhe pikën 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Irena Çunoti, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore, si dhe

publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 18.7.2024.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Genta TAFA (BUNGO)

Kryesuese

Etleda ÇIFTJA

Relatore

Roland ILIA

Anëtar

Sekretare gjyqësore
Resilda Bilaj